

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXVIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 47

EDI SHUKRIU

HYJNESH A DARDANE
DEA DARDANICAE

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXXXVIII
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
BOOK 47

EDI SHUKRIU

DARDANIAN GODDESS

DEA DARDANICAE

Approved for publication at the meeting of the Section of Social Sciences,
held on 29th October 2014, after review by
academician Pajazit Nushi and correspondent member Jusuf Bajraktari.

Editor: Academician Mark Krasniqi, Secretary of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXVIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 47

EDI SHUKRIU

HYJNESH A DARDANE

DEA DARDANICAE

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 29 tetor 2014, në bazë të recensioneve të
akademik Pajazit Nushit dhe anëtar korrespondent Jusuf Bajraktarit.

Redaktor: Akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Copyright © ASHAK

Përmbajtja

| | |
|-------------------------------|----|
| Hyrje | 7 |
| Territori dardan | 9 |
| Dardanët dhe prejardhja | 15 |

I. MONUMENTET VOTIVE PËRKUSHTUAR HYJNESHËS

| | |
|---|----|
| DARDANE | 19 |
| 1. Hyjnesha dardane me dy labirinte nga Smira | 24 |
| 2. Hyjnesha dardane me edh nga Romula Malva | 30 |
| 3. Hyjnesha dardane me enë bollëku nga Romula Malva | 36 |
| 4. Hyjnesha dardane nga Gllamniku 1 | 38 |
| 5. Hyjnesha dardane nga Gllamniku 2 | 41 |
| 6. Hyjnesha dardane nga Mediana | 43 |
| 7. Hyjnesha dardane nga Branetiçi i Poshtëm | 46 |
| 8. Hyjnesha dardane nga Kamenica | 50 |
| 9. Dardanicæ sacrum nga Banja e Kurshumlisë | 51 |
| 10. Monumenti i hyjneshës në Kishën e Lypjanit | 52 |
| 11. Monedha me figurë hyjneshe dhe mbishkrim dardanici 1 | 54 |
| 12. Monedha me figurë hyjneshe dhe mbishkrim dardanici 2 | 57 |
| 13. Monedha me mbishkrim dardanici dhe roma dhe me figurë hyjneshe | 59 |
| 14. Busti i hyjneshës dardane nga Banja e Kllokotit | 62 |
| 15. Shtatorja nga Theranda | 64 |

II. SIMBOLET NË MONUMENTET E HYJNESHËS DARDANE

| | |
|-------------------------------------|----|
| 71 | |
| 1. Edhi | 72 |
| 2. Dielli | 77 |
| 3. Hëna | 81 |
| 4. Sëpata - sëpata dytehtëshe | 81 |
| 5. Viçi | 83 |
| 6. Kënduesi | 84 |
| 7. Altari | 85 |
| 8. Derri faran | 86 |
| 9. Kalliri i grurit | 88 |
| 10. Lerthi | 88 |
| 11. Spiralja | 90 |
| 12. Hardhia e rrushit | 91 |

| | |
|--|-----|
| 13. Shporta e bollëkut | 93 |
| 14. Svastika (kryqi i thyer) | 94 |
| 15. Qesja | 95 |
| 16. Kurora murale | 96 |
| 17. Nyja | 97 |
| 18. Labirinti | 98 |
| | |
| III. FUNKSIONET E HYJNESHËS DARDANE | 107 |
| | |
| IV. ZHVILLIMI I BESIMIT DARDAN SIPAS MONUMENTEVE TË HYJNESHËS DARDANE | 115 |
| 1. Faza parahistorike | 117 |
| 2. Faza antike: politeizmi (IV p.e.r. - IV) | 121 |
| 3. Faza e antikës së vonë: monoteizmi | 122 |
| | |
| V. FUQIZIMI I BESIMIT NË HYJNESHËN DARDANE NË PERIUDHËN ROMAKE | 125 |
| | |
| VI. QIELLVROJTUESIT DARDANË DHE OBSERVATORI PARAHISTORIK | 131 |
| | |
| VII. KOZMOLOGJIA – KOZMOGONIA DARDANE | 137 |
| 1. Labirinti rrethor i Smirës | 143 |
| 2. Labirinti i Gamzigradit | 147 |
| 3. Monumenti mortar i Dardanës | 151 |
| 4. Arti parahistorik shkëmbor i Vlashnjës | 158 |
| 5. Hyjnesha në fron | 164 |
| | |
| ÇËSHTJE PËR HULUMTIM TË MËTEJMEË | 167 |
| 1. Koncepti i treshit | 168 |
| | |
| PËRFUNDIME MBI HYJNESHËN DARDANE | 171 |
| | |
| Summary | 175 |
| | |
| Bibliografia | 181 |

Hyrje

Studimi trajton prezencën dhe funksionet e shumta të Hyjneshës Dardane (Dea Dardanica), një nga hyjnitë më të adhuruara të panteonit dardan. Njohja fillestare me Hyjneshën Dardane ishte në vitin 1972, pas botimit të dy monumenteve të saja në Rumani dhe që nga ai vit e kërkoja dhe në territorin dardan. Studimin më thelbësor e nisa nga viti 1988, pas zbulimit të monumentit të saj në Smirë të Vitisë (Kosovë). Informatën mbi gjetjen e disa monumenteve epigrafike në Smirë e ofroi një student i mjekësisë, i cili e vizitonte ekspozitën me fotografi *Shasi mesjetar* në *Koleksionin Arkeologjik* të Fakultetit Filozofik (Universiteti i Prishtinës, 1988).¹ Ekspozita tërhiqte vëmendjen, si edhe të tjerat, dhe po aq mundësonte marrjen e informatave të reja mbi gjetjet arkeologjike.

Ishte 17 janari i vitit 1988, kur u nisa me tre studentë të historisë për në Smirë. Dita ishte me shumë acar dhe nisi e përfundoi me mjegull të dendur. Smirasit e pritën me ngazëllim arritjen tonë, veçanërisht kur në mesin e grumbujve të gurëve të rrënuar të xhamisë së vjetër evidencvoja monumente epigrafike të shkruara në gjuhën latine. Oborri ishte i mbërthyer me mori gurësh dhe të ecje nëpër ta, e të merre shënime, nuk ishte e lehtë.

Ishte gati rastësi gjetja e monumentit përkushtuar Hyjneshës Dardane në kohën kur evidencimi i monumenteve përfundoi. Një bllok i mbuluar me llaç qëndronte në skutën midis këndit jugperëndimor të xhamisë së re dhe deriçkës së ngelur të oborrit të xhamisë së vjetër. I mbuluar në të katër anët me llaç ngjyrë hiri, dukej si një gur i madh katërkëndësh, i cili dikur ishte një pjesë e vockël e mureve të xhamisë. Mbase dhe nuk do të ma tërhiqte vëmendjen sikur një pikëz e mermerit të bardhë të mos ishte kasnec i një zbulimi të ri. Dalta u soll shpejt e në “çekan” u shndërrua guri i parë pranë. Nisa ta largoja me kujdes llaçin nga masa katërkëndëshe. Së pari doli pjesa e parme e kapitelit, korniza e fushës së mbishkrimit, pastaj me radhë shkronjat D, E, A, E.

I është përkushtuar ndonjë hyjneshe të periudhës romake. Do të ishte mrekulli sikur në vazhdim ta kishte shkronjën D! - urova zëshëm dhe gëzimi ishte i natyrshëm, kur nisi të dukej D-ja, pastaj shkronjat A, R, D... Përkushtimi doli i tëri: DEA DARD. Asokohe nuk ishte me rëndësi a ishte

¹ Koleksioni, i vendosur në sallën e mësimit nr. 1, u paramendua që një ditë të shndërrohej në Muze të Universitetit të Prishtinës.

kjo hyjneshtë e Dardanisë apo e dardanëve, me rëndësi ishte se për herë të parë në trevat dardane zbulohet një monument që i përkushtohet, drejtpërdrejt, kësaj hyjneshe!

I gdhendur në të katër anët, i panjohur si i tillë në Kosovë, monumenti solli dhe befasi të tjera. Pos dy mbishkrimeve të njëjta në anët e kundërta, përmbante dhe dy labirinte, njërin rrethor dhe tjetrin në trajtë katërkëndëshi. Përderisa ky i fundit ishte i njohur nga territori grek, labirinti rrethor i qarkut të mbyllur ishte i panjohur, tejet kompleks dhe domethënës dhe dukej si gjë e pamundur të ishte pjesë e traditës dardane.

Labirinti rrethor i Smirës ishte nxitje e vazhdueshme për studimin e monumenteve përkushtuar hyjneshtë të lidhur me dardanët dhe të simboleve që ato i bartin. Simbolet e saja nisnin nga paraqitja e edhit e deri te labirintet e antikës, duke përfshirë edhe kënduesin, viçin, derrin faran, diellin, kallirin e grurit, lërthin, hardhinë e rrushit, shportën e bollëkut, sëpatën, qesen, diademën e kurorën e qytetit, altarin, svastikën, nyjën profilaktike, labirintin katërkëndësh dhe, mbi të gjitha, labirintin rrethor të qarkut të mbyllur. Të gjitha këto simbole flasin edhe për jetëgjatësinë e besimit në fuqitë hyjnore të kësaj hyjneshe të veçantë.

Labirinti rrethor mund të shihet edhe si kasnec i ekzistencës në po këtë trajtë edhe të tempujve që i janë përkushtuar Hyjneshtë Dardane, të vendosura gjysmë apo plotësisht nën dhe, ashtu siç janë zbuluar në Maltë. Ky shpreh dukshëm një nivel të lartë të zhvillimit religjioz-filozofik të dardanëve edhe para pushtimeve romake, andaj është rast që sërish të falënderohen smirasit, të cilët nuk lejuan që të zhdukej ky thesar unik. Falënderimi i takon dhe dr. Christina Stribulescut, e cila i siguroi fotot kualitative të monumenteve të Rumanisë.² Merita kanë të gjithë që ndihmuan në forma të ndryshme që të dilte në dritë ky studim dhe, sidomos, prindërit, Gita dhe Muhamedi, bashkë me vajzën time Erletën, të cilët i pata gjithherë mbështetje.

Shpresoj se ky studim do të hapë shtigje të reja në labirintin shumëdimensional shkencor dhe për këtë i jam mirënjohëse Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, e cila e mundësoi publikimin e tij.

Edi Shukriu

² Departamenti i Arkeologjisë, Muzeu i Historisë Nacionale në Bukuresht (Rumani). Mëtimi për t'i siguruar fotot më kualitative zgjati vite të tëra. Dy u siguruan falë z. Baki Imerit, por mjerisht u konfiskuan në kufi nga policia serbe, bashkë me materialet e tjera të prof. Fehmi Aganit (1997). Disa vjet më vonë z. Bashkim Kyçyku e dërgoi foton digjitale të përfytyrimit të hyjneshtë, por kjo "iku" në adresë të gabuar.

Territori dardan

Prezantimi i Hyjneshës Dardane shtron nevojën për paraqitjen e shkurtër të hapësirës ku lindi dhe u zhvillua besimi për këtë hyjneshë dhe për shtrirjen territoriale të dardanëve në kohë të ndryshme. Territori i saj parahistorik kufizohej në lindje me lumin Astibo, i cili e ndante nga Peonia (Harta 1). Kjo mbështetet më së shumti në të dhënën për Aristonin, djalin e mbretit peon Audoleonit, i cili e kaloi lumin me not dhe doli në Dardani në momentin e kurorëzimit të tij për mbret, kur u sulmua nga maqedonasit (285/4 p. e. r.).³

Kufiri verior i Dardanisë parahistorike nuk është mjaft i qartë. Ky kalonte rrjedhës së Ibrit dhe pastaj në drejtim të Nishavës, për ta pasur kufi lindor Moravën Jugore. Ky kufi përfshinte edhe hapësirat e bregut të majtë të lumit dhe mbase shkonte jo larg malit Hem.⁴ Kufirin jugperëndimor e përbënin rrëzat jugore të maleve Sharr, ndërsa kufirin perëndimor rrjedha e sipërme e Drinit të Bardhë.⁵

Krijimi dhe fuqizimi i shtetit dardan nga shek. IV p. e. r. mundësoi zgjerimin e territorit, fillimisht në drejtim të jugperëndimit, duke marrë kontrollin mbi territorin e taulantëve⁶ dhe hapësirën deri te Gostivari i sotëm (Harta 2). Mohimi i përfshirjes së hapësirës së Tetovës dhe të Gostivarit në Dardani nga A. Moscy, me arsyetimin se në to janë gjetur shumë mbishkrime në gjuhën greke,⁷ nuk duket shumë bindës, aq më tepër se edhe në hapësirën e Shkupit janë gjetur të tilla dhe në asnjë rast nuk i mohohet përfshirja në kuadër të Dardanisë.

Kufijtë e shtetit dardan përfshinin edhe territoret veriore dhe verilindore të Dardanisë, hapësirat përgjatë luginës së Moravës dhe Nishavës, duke u shtrirë në territoret e autariatëve dhe të tribalëve dhe duke zënë edhe prapavijën e Nishit me Aleksincin dhe Knjazhevcin (Serbi), si pikat më veriore të kufirit. Më pas, zgjerimi u bë në drejtim të

³ Polyæn, *Strategemata* IV 12 3.

⁴ Haemus: Stara Planina. Shukriu, E. (1996) *Dardania paraurbane*, Dukagjini, Pejë, f. 14.

⁵ Shih për këtë: Mócsy, A. (1974) *Pannonia and Upper Moesia: a history of the middle Danube provinces of the Roman Empire*, Routledge and Kegan Paul, Boston, Fig. 6.

⁶ Wilkes, J. (1992) *The Illyriens*, Blackwell, Oxford /Cambridge, p. 146.

⁷ Moscy, A. (1970) *Romanisation und Gesellschaft der römischen Provinz Moesia Superior*, Akadémiai Kiadó, Budapest, pp. 9 - 17.

juglindjes dhe në gjirin e shtetit dardan u përfshi gati e gjithë Peonia.⁸

Përfshirja e territoreve të Peonisë i bëri dardanët fqinjë të drejtpërdrejtë me Maqedoninë dhe për këtë u bë shkak i konflikteve të vazhdueshme midis tyre. Bylazora, dikur qytet peon, u bë pikë ndarëse midis Dardanisë dhe Maqedonisë.⁹ Andaj, tek nga viti 345 p. e. r. dolën në dritë dëshmitë e para të shkruara për historinë politike të Dardanisë,¹⁰ gjë që lidhet me hyrjen e Dardanisë në sferën e interesit të Maqedonisë dhe të interesimit të shkrimtarëve antikë për të.

Shteti dardan kishte fron të trashëguar dhe ushtri, zhvilloi diplomaci dhe lidhi aleanca. Aleancë bëri edhe me romakët, po aq kundërshtarë të Maqedonisë, por as këtyre nuk ngurroi t'ua kthente armët. Kështu, Dardania iu rezistoi pushtimeve romake, por, më pas, ngeli në gjysmëvarësi nën provincën romake të Maqedonisë. Në vitin 44 (sipas disave në vitin 15) e bënë pjesë të provincës së Mezisë (Moesia), ndërsa në vitin 86, pas ndarjes së Mezisë, i takoi provincës Mezia e Epërme (Moesia Superior. Harta 3).

Dardanët nuk u pajtuan për shumë kohë me okupimin romak dhe as me vendosjen e tyre në kufijtë e imponuar, gjë që u shpreh me veprimet e pareshtura të latronëve - cubave dardanë (*latrones dardanici*). Në vitin 279 u krijua provinca romake e Dardanisë (Harta 4), kufijtë e së cilës ishin po ata të shtetit të dikurshëm dardan, pos pjesës verilindore, e cila iu nda provincës Dacia Ripensis, të formuar më parë.¹¹

Studiuesit pajtohen se entiteti i krijuar dhe ruajtja e veçorive etnike dardane gjatë sundimit romak, kishin rol vendimtar për t'u krijuar njësia e veçantë juridiko-administrative e Dardanisë. Më pas, Dardania u bë pjesë e prefekturës së Ilirikut dhe në vitin 379, bashkë me Maqedoninë, e përbënte Ilirikun Lindor.

Në vitin 395, pas ndarjes së Perandorisë romake në atë Perëndimore dhe Lindore, i takoi kësaj të dytës Nga viti 437 ishte pjesë e Ilirikut dhe i takoi Perandorisë Lindore, për të ngelur nën perandorinë bizantine pas reformave të Justinianit, perandorit bizantin (shek. VI).

⁸ Pjesa perëndimore e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.


⁹ Velesi i sotëm në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

¹⁰ Mbishkrimi nga Oleveni: Cabane, P. (1988) Les Illyriens, de Bardylis à Genthios, IVE au IIe siècle avant J.-C., SEDES, Paris. p. 50, f.n. 80, 81.

¹¹ Papazoglu, F. (1969) Srednjebalkanska plemena u predrimsko doba, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosnje i Hercegovine, Sarajevo, p. 151.




Harta 1: Kufijtë e Dardanisë parahistorike



Harta 2: Kufijtë e shtetit dardan



Harta 3: Dardania në kuadër të provincës Mezia e Epërme



Harta 4: Provinca romake e Dardanisë

Dardanët dhe prejardhja

Me çështjen e dardanëve dhe të prejardhjes së tyre janë marrë studiues të ndryshëm, sidomos me lidhjet e tyre me dardanët e Azisë së Vogël. Këto lidhje janë dëshmuar që herët, por për drejtimin dhe kohën e lëvizjes së tyre ka ende diskutime dhe këto mbështeten kryesisht në burimet e shkruara antike. Kështu, autori antik, Diodori, shkruan se Dardani sundonte mbi shumë fise në Azi dhe se:

*...i ka vendosur edhe dardanët që janë nga ana tjetër e Trakisë.*¹²

Solini, autor tjetër antik, i lidh dardanët me prejardhje trojane:

*...Dardanët janë njerëz të gjinisë trojane, të cilët u bënë barbarë në doke...*¹³

Mendime të njëjta mbështet dhe J. Wilkes, i cili, ndonëse nuk e trajton kohën e degëzimit të tyre, i sheh dardanët europianë si një degë e retarduar e dardanëve trojanë.¹⁴

Mendim tjetër ka shprehur V. Thrämer, i cili thotë se lëvizjet e dardanëve shkonin nga perëndimi në lindje dhe se në kuadër të dyndjeve dorike apo egjeane (XIII-XII) *...një pjesë e këtyre dardanëve u nda dhe kaloi te frigët në Azinë e Vogël, së bashku me mezët dhe frigët.*¹⁵ Për këto lëvizje W. Leaf thotë se frigët dhe akejtë zbritën në jugperëndim nga veriu i rrafshit të Danubit, ndërsa dardanët, themeluesit e Trojës, u drejtuan nga juglindja.¹⁶

Janë dhënë dhe mendime të tjera lidhur me lëvizjet e dardanëve, gjë që nuk është temë e këtij studimi. Por, duhet thënë se konfuzionet e krijuara mbi drejtimet e lëvizjeve, lindje - perëndim apo perëndim -

¹² Diodorus Bibliotheca historica V 48.

¹³ *...hominess Troiana prosphia in mores barbaros efferati*: Solinus II, 51 D 2.

¹⁴ Wilkes, J. (1992) f. 145.

¹⁵ Thrämer, V. (1901) Pauly's Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft anianos, Band IV 2, Stuttgart, 2177.

¹⁶ Leaf, W. (1915) Homer and History, Macmillan and Co., London, p. 72.

lindje, mund ta gjejmë shpjegimin në faktin se janë zhvilluar që të dyja, por në periudha kohore të ndryshme. Në kuadër të zbërthimit të kësaj çështjeje duhet nisur kryesisht me valët e dyndjeve indoeuropiane të epokës eneolitike të drejtimit lindje – perëndim dhe ato të drejtimit veri - jug nga mijëvjeçari II p. e. r., të quajtura dyndjet e akejve, si dhe ato nga shek. XII p. K, të njohura si *dyndjet dorike* apo *dyndjet egjeane*.

Mbështetur në njohuritë e deritashme arkeologjike, dardanët ishin banorë të hershëm të Europës Juglindore, rrënjët e të cilëve gjenden në gërshetimin e substratit neolitik dhe të adstratit eneolitik indoeuropian, për ta nisur konsolidimin gjatë proceseve integruese të epokës së bronzit. Relacionet me dardanët e Trojës ngelin ende të paqarta, sidomos nga aspekti arkeologjik, për shkak të mungesës së njohurive të nevojshme për epokën e bronzit në Kosovë dhe rrethin e saj dhe të pamundësisë që këto të krahasohen me kulturën trojane të epokës së bronzit, kur supozohet zhvillimi i Trojës dhe i kulturës së saj.¹⁷

Dardanët europianë duken me kulturë të identifikuar nga shek. VIII p.e.r., kaluan fazën paraurbane (VI - IV) dhe krijuan shtetin e tyre nga shek. IV p.e.r., i cili u zhvillua deri te pushtimet romake.¹⁸

Kontaktet parahistorike dardane me botën mesdhetare ishin të hershme, gjykuar sipas importeve mikenase të epokës së bronzit nga Qëndresani (Gllareva). Nga shek. VII p.e.r. u krijuan lidhjet më intensive tregtare, siç dëshmojnë amforat e Hiosit, enët me mbishkrime arkaike greke apo monedhat e Tasosit, të zbuluara në Kosovë.¹⁹ Këto lidhje morën hov gjatë shek. VI p.e.r., gjykuar nga importet e shumta, vazot me figura të zeza nga Banja e Pejës apo Menada e Prizrenit (Fot. 1) dhe ajo e Tetovës.²⁰

Nga mesi i shek. V p.e.r. importi në Dardani u zvogëluar, dhe kjo ishte një prej shkaqeve të rritjes së prodhimit të zejtarëve dardanë, të organizimit më të ngritur shoqëror dhe me këtë edhe të përparimit të botës shpirtërore dhe religjioze dardane.²¹

¹⁷ Shih: Blegen, C. (1963) Troy and the Trojans, Thames and Hudson, London.

¹⁸ Shukriu, E. (2004) Kosova antike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Lumi, Prishtinë, ff. 47 - 54; ff. 68 - 89.

¹⁹ Shukriu, E. (1996) ff. 87 - 95.

²⁰ Shukriu, E. (1996) f. 57, T. XVII, 1.

²¹ Shukriu, E. (1996) f. 54 e tutje.



Foto 1: Menada e Prizrenit (British Museum, Londër)

I. MONUMENTET VOTIVE PËRKUSHTUAR HYJNESHËS DARDANE

Studimi i kushtuar Hyjneshës Dardane shpalos të dhënat e deritanishme mbi këtë hyjneshë, sjell analiza të llojllojshme dhe hap shtigje për studime më të thelluara dhe më komplekse mbi besimin dardan, qasjen e tyre ndaj jetës, vdekjes dhe jetës së përtejme, si dhe paraqitjen e elementeve mbi kozmologjinë dhe kozmogoninë dardane. Studimi mund të shihet si një konstrukt fillestar, i bazuar në evidenca dokumentuese në këtë fazë të studimit.

Mbi besimin dhe hyjnitë e panteonit dardan është ditur shumë pak, pasi që burimet antike dhe as ato më të vonat nuk kanë lënë shënime të nevojshme. Ç'është e vërteta, madje as për besimin dhe ritualet greke nuk ka të dhëna të besueshme para autorëve antikë si Straboni, Pausania dhe Plutarku. Përderisa autorët e mëvonshëm huazonin të dhëna nga Hesiodi dhe poetët e kohës, të dhënat mbi kultet greke janë ruajtur vetëm nga të dhënat e historianëve lokalë të shek. IV p.e.r.²²

Njohuri mbi hyjnitë dardane janë fituar pas gjetjeve të monumenteve epigrafike në hapësira dhe kohë të ndryshme. Falë këtyre monumenteve, u bënë të njohura hyjnitë dardane si Hyjnesha Dardane apo hyjnitë Andin, Ata dhe Tato.²³

Numri i hyjnive të panteonit dardan dhe interpretimi romak i hyjnive vendëse është ende jo aq i njohur. Se ka mjaft të tilla në Dardani e gjetiu, e dëshmon në veçanti monumenti epigrafik përkushtuar Jupiterit, i zbuluar në Smirë, në vitin 1988. Në të përfaqësuesi i tribës së njohur romake, Quirinia, ka potencuar se monumentin ia ngrit Jupiterit të tij dhe jo atij vendës. Andaj, në monument është shënuar formula e dedikimit: IOMN (Iovi Optimo Maximo Noster).²⁴

Me këtë rast Hyjnesha Dardane do të trajtohet në veçanti, me

²² Dietrich, B. (1986) *Tradition in Greek Religion*, Walter de Gruyter & Co, Berlin and New York, p. XI.

²³ Suić, M. (1960) *Ilirski Deus Patrius*, Starinar XI, Beograd, p. 93.

²⁴ Shukriu, E. (2001) *Dea e Dardanisë dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira*, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, ff. 17 - 37. Formula e zakonshme përkushtimore në monumentet epigrafike është: IOM.

vendgjetjet dhe tekstet e plota të monumenteve, me kohën e ngritjes së tyre, me prejardhjen e dedikantëve, me simbolet e shumta dhe me funksionet e hyjnesës që këto i paralajmërojnë.

Interesimi për Hyjneshën Dardane u rrit dukshëm pas zbulimit të monumentit të Smirës, e cila mundësoi lidhshmërinë edhe me relikte të tjera dhe që shiheshin në lidhje me hyjnitë jovendëse, siç ishin shtatorja e Medianës apo monedhat me mbishkrim *dardanici*.

Një prej sfidave rreth çështjeve që trajtohen në këtë studim ishte numri jo shumë i madh i monumenteve përkatëse. Shpjegimi për këtë mungesë mund të gjendet te moszbulimi i tyre dhe se ato presin në nëntokën dardane apo gjetiu. Shpjegimi tjetër lidhet me trajtimin e tyre në dru, në lëkurë apo në ndonjë material tjetër, i cili nuk i rezistoi kalimit të kohës. Këtë të dytën e mbështet e dhëna se edhe te dardanët, si edhe tek ilirët e tjerë, ka dominuar tradita e drugdhendjes dhe se druri, siç pohojnë dhe autorë të ndryshëm, ishte materiali më i preferuar për trajtësime plastike dhe artistike.²⁵

Analiza e monumenteve gurore ilire, të krijuara para dhe pas pushtimeve romake, ka dëshmuar se veprimi teknik mbi monumentet gurore është përcjellë nga teknika e përpunimit të drurit, siç shihet edhe nga monumentet e zbuluara në territorin dardan. Druri u ka shërbyer dardanëve edhe si material për të lënë shenja të jetës dhe të vdekjes, ashtu siç u ka shërbyer për ta shprehur botën e tyre shpirtërore në përgjithësi. Trajtimet në dru e shpjegojnë mospraninë e shumë monumenteve të shekujve IV-I, si edhe të atyre të mëhershme.

Zbulimi i labirintit rrethor me qark të mbyllur i Smirës ishte një kasnec rreth të panjohurave mbi dardanët, andaj dhe nxiti nevojën për hulumtime të mëtejme lidhur me prejardhjen e tij, kërkimin e kuptimit të labirinteve dhe të arsyeve për krijimin e tyre dhe, natyrisht, edhe të

²⁵ Sergejevski, D. (1965) *Umjetnost Ilira*, Iz problematike ilirske umjetnosti, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosnje i Hercegovine, Godišnjak III/1, Sarajevo 1965, pp. 120-121; Stipčević, A. (1974) Kultni simboli kod ilira, Centar za Balkanološka ispitivanja 10, Sarajevo f. 217; Gabričević, B. (1987) Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta, Književni krug, Split, p. 24; Rendić-Miočević, D. (1989) *Problemi romanizacije Ilira s osobitim obzirom na kultove i onomastiku*, Simpozium o Ilirima u antičko doba, Sarajevo, p. 437.

botëkuptimeve kozmologjike dhe të botëkuptimeve kozmogonike të dardanëve. Kështu, studimi solli nga nëntoka e Kosovës, ku labirinti i Hyjneshës Dardane mbijetoi për shumë shekuj, deri tek hapësirat qiellore dhe përfytyrimet parahistorike dhe antike për të.

Monumentet votive përkushtuar Hyjneshës Dardane (Deae Dardanicae) vijnë si shprehje e zhvillimit të besimit dardan që nga fazat parahistorike. Këto sot gjenden në numër më të madh, madje jo vetëm në territoret e dikurshme dardane (Fot. 28). Pos monumenteve më të hershme nga Romula Malva e Rumanisë (Monum. 2, 3. Fot. 9, 11)²⁶ dhe Kamenica (Serbi),²⁷ këtyre iu shtuan dhe monumenti votiv nga Smira e Vitisë (Kosovë, Fot. 3)²⁸ dhe dy nga Gllamniku pranë Podujevës (Kosovë. Fot. 14, 15).²⁹

Me Hyjneshën Dardane lidhen dhe monumente të tjera, siç janë shtatorja nga Mediana e Nishit (Serbi, Fot. 16),³⁰ patela nga Branetiçi i Poshtëm (Serbi, Fot. 17), Busti i Hyjneshës Dardane nga Banja e Kllokotit (Kosovë. Fot. 26), monedhat me figurë hyjneshe dhe me mbishkrim *dardanici* (Fot. 20, 22-25).³¹ Këtij grupi duhet shtuar dhe monumentin votiv nga Banja e Kurshumlisë (Serbi)³² dhe

²⁶ Tudor D. - Vladescu C. (1972) *Dardanii la Romula Malva*, Apulum X, Alba Julia 1972, ff. 183 - 190; Tudor, D. (1978) *Recentele săpături arheologice-romane de pe valea Oltulin Inferior*, Apulum, 11, p. 369, Fot. 102, 103.

²⁷ Dušanić, S. (1976) *Novi Antinojev natpis i Metalla municipii Dardanorum*, Živa Antika XXI/I, Skopje, pp. 56 - 157, nr. 167.

²⁸ Shukriu E. (1989a) *Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare XIV, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, ff. 15 - 21.

²⁹ Dobruna-Salihu, E. (2012) *Votivna ara Deae Dardanicae i beneficiarna postaja iz Vendenisa*, Vjesnik Arheološkog Muzeja u Zagrebu LXV, Zagreb, pp. 217 - 224, p. 832.

³⁰ Vulić, N. (1948) *Antički spomenici naše zemlje*, Spomenik 98, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd, nr. 237; Nenadović, A. (1961) *Raniji rimski nalasci u Nišu i njegovoj blizoj okolini*, Limes u Jugoslaviji I, Arheološko društvo Jugoslavije, Beograd. p. 169; Picard, Ch. (1953) *Obeservation archeologique en Yougoslavie*, Comptes rendu de l'Academie des Inscriptions et Belles-Lettres 98, pp. 70 - 95; Petrović, P. (1976)) Niš u antičko doba, Gradina, Niš, p. 148; Jovanović, A. (1980) *Prilog proučavanju skulptura sa Medijane*, Niški Zbornik 9, Niš, pp. 53 - 59.

³¹ Mirdita, Z. (1981a) *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Rilindja, Prishtinë, f. 252, nr. 239; Vulić, N. (1948) f. 221.

³² Mirdita, Z. (1981a) p. 247, nr. 208; Vulić, N. (1931) *Antički spomenici naše zemlje*, Spomenik Kraljevske Akademije Nauka 71, Beograd, p. 98.

monumentin në kishën paleokristiane të Shën Florit dhe Laurit në Lypjan (Kosovë) apo edhe shtatoren nga Theranda (Suhareka, Kosovë. Fot. 27). Vlera e të gjitha gjetjeve arkeologjike me përkushtim Hyjneshës Dardane rritet edhe më kur kihet parasysh se deri më sot nuk është ndeshur asnjëherë emri i kësaj hyjneshe te autorët antikë dhe se nuk është ditur për besimin në të.

Të dhënat e para mbi ekzistencën e Hyjneshës Dardane janë fituar nga zbulimet e monumenteve epigrafike në Rumani, ndërsa zbulimi i monumentit epigrafik në Smirë me dy labirinte dhe dy tekste identike, ofroi të dhëna për të konstatuar se kjo hyjneshë ishte ndër hyjnitë më të adhuruara dhe se kishte kryepozitë në panteonin dardan.³³

Gjatë procesit të studimit kishte dhe sfida të ndryshme dhe në mesin e të tyre më kryesoret ishin: 1. pamjaftueshmëria e të dhënave të ofruara nga autorët antikë, 2. mungesa e objekteve relevante të periudhës pararomake dhe 3. numri i vogël i monumenteve epigrafike të periudhës romake me përkushtim hyjnine vendëse.

Përderisa autorët antikë nuk trajtojnë fare çështjet e besimit te dardanët, ka tejet pak materiale arkeologjike të periudhës pararomake, të cilat do ta mundësonin krijimin e një pasqyre më reale të zhvillimit të besimit dardan pararomak. Mungesa e monumenteve të periudhës pararomake lidhet kryesisht me moszbulimin e materialeve arkeologjike të shekujve IV-I, si dhe me traditën e drugdhendjes, e cila u përcoll në mermer apo në gur pas pushtimeve romake. Si pasojë, emrat e hyjnine vendës u njohën vetëm nga monumentet gurore të periudhës romake.

Sfidë të veçantë paraqiti dhe fakti se gjatë sundimit romak hyjnitë vendëse duken me emra të perëndive të huaj në interpretimin e tyre romak (interpretatio romana) apo vetëm si Dea dhe Deus, andaj dhe identifikimi i tyre bëhet shumë më i vështirë.

³³ Shukriu, E. (2004) ff. 9 - 32; Shukriu, E. (2001) *Dea e Dardanisë dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira*, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, ff. 17 - 37; Shukriu, E. (1989a) ff. 15 - 21.



Foto 2: Monumentet e Hyjneshës Dardane

1. Hyjnesha dardane me dy labirinte nga Smira

Monumenti votiv me përkushtim Hyjneshës Dardane u zbulua në Smirë të Vitisë, në janar të vitit 1988 (Fot. 3).³⁴ Ky është ndër monumentet më të vlefshme epigrafike të gjetura deri më sot në Kosovë, për shkak të teonomisë që e sjell, paraqitjes unike të labirintit rrethor, paraqitjes së labirintit katërkëndësh dhe të arkitekturës katërfaqësore të saj, e cila duket për herë të parë në territorin e Kosovës.

Monumenti është punuar me mjeshtëri në mermer të bardhë, të përshkuar me ngjyrë të përhimë dhe është skalitur në katër faqe. Dimensionet e monumentit janë 78 x 36 x 37cm. Në monument gjenden dy fusha të mbishkrimit (teksti 1, 2. Fot. 4) dhe dy fusha simbolike-ornamentale, të cilat përbëjnë labirintin rrethor dhe atë katërkëndësh.

Fushat e mbishkrimeve dhe të simboleve kanë korniza të theksuara, me dimensione 34,5 x 22,5 cm. Kapiteli i monumentit është i dëmtuar, ndërsa bazamenti mungon tërësisht. Në pjesën e poshtme të kapitelit duken gjurmët e zbukurimit me gjethe të lerthit, ndërsa nën to një brez me vija reliefore. Në pjesën e epërme kapiteli kishte edhe elemente të tjera, por këto nuk mund të definohen për shkak të dëmtimeve.

Teksti 1:

DEAE DARD / ARTORIVS / HERACLI / TVS SPEC / LEG
III FL / VSLM / GENTIANO ET BASSO

³⁴ Në Smirë u zbuluan disa monumente epigrafike, pas rrënimit të xhamisë së vjetër. Këto u sollën nga smirasit në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe u vendosën në *Koleksionin arkeologjik*, që planifikohej të shndërrohej në Muze të Universitetit të Prishtinës.

Leximi i tekstit:

Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tus spec(ulator) /
leg(ionis) III Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) /
Gentiano et Basso.

Teksti 2:

DEAE / DARD / ARTORIVS / HERA... / TV...

Leximi i tekstit:

Deae Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tu[s spec(ulator) /
leg(ionis) III Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) /
Gentiano et Basso]

Sipas palës konsulare monumenti datohet në vitin 211.³⁵



Foto 3: Monumenti i Hyjneshës Dardane, Smirë

³⁵ Shukriu, E. (2001) ff. 17 - 37.



Foto 4: Tekstet identike me përkushtim Hyjneshës Dardane, Smirë



Foto 5: Labirinti rrethor i qarkut të mbyllur, Smirë



Foto 6: Labirinti katërkëndësh, Smirë (Viz. Marigona Ademi)




Foto 7: Gjysmësfera qendrore e labirintit rrethor, Smirë

Dedikanti i monumentit mban emrin Artorius Heraclitus dhe e ka funksionin e vëzhguesit (speculator) në Legjionin IV të Flavëve. Emri Artorius është nomen joperandorak gentil, i përhapur në Itali, Afrikë, Galinë jugore dhe Dalmaci.³⁶ Ky nomen, i paidentifikuar deri më tash në pjesën qendrore të Europës Juglindore, duket për herë të parë në monumentin votiv të Smirës.

³⁶ Alföldy, G. (1969) Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatia, Winter, Heidelberg, f. 62.

Kognomen Heraclitus konsiderohet me prejardhje greke dhe është identifikuar edhe në arën përkushtuar Asklepit, Telesforit dhe Higisë, të gjetur në Prizren.³⁷ Meqë dedikanti i monumentit ishte spekulator dhe kjo pozitë fitohej duke kaluar nga pozita e beneficiarit,³⁸ supozohet se në afërsi ka ekzistuar dhe një stacion beneficuar, nën komandën e Legjionit IV të Flavëve. Ky mund të jetë dhe *statio Lab(utza)*, i identifikuar nga monumenti tjetër i Smirës dhe që supozoj të jetë lokaliteti i gjerë me toponimin *Gradina* në Gushicë, pranë Smirës.³⁹

Vëmendje të veçantë meriton labirinti rrethor, i cili prezanton simbolin autokton dhe, në të njëjtën kohë, është një ndihmesë e madhe për t'i kuptuar të gjitha funksionet e mundshme të Hyjneshës Dardane. Labirinti katërkëndësh është një simbol jodardan dhe në këtë rast shihet si përsëritje e kuptimit të labirintit rrethor dhe si përforsim i domethënies së tij dhe të funksioneve të vetë hyjneshës.

Labirinti rrethor përbëhet nga një kompozicion më i gjerë, i cili e ndërlihd labirintin me hardhinë e rrushit, lerthin dhe nyjën profilaktike. Vetë labirinti është paraqitur në pjesën qendrore të kompozicionit. Nga hapësirat që ndërlihdhen me njëra-tjetrën formohen gjashtë (6) kryqe të thyera apo svastika, prezenca e të cilave ka kuptim të shumëfishtë.

Tri svastika të labirintit kanë drejtim të akrepave të orës (lindje – perëndim) dhe simbolizojnë lindjen, ndërsa tri svastikat e tjera kanë drejtim të kundërt të akrepave të orës (perëndim – lindje) dhe simbolizojnë vdekjen, rrjedhimisht ringjalljen (Fot. 46). Gërshetimi i këtyre svastikave vë në pah ciklin e përhershëm të lindjes, të vdekjes dhe të ringjalljes.

Në qendër të labirintit gjendet një gjysmësferë e theksuar, e cila është ndarë në tri hapësira të vogla përmes tri gjysmëharqeve. Cepat janë vendosur në drejtim të nën-kompozicioneve që i formojnë svastikat. Hyrja në vetë qendër gjendet vetëm nga cepi lindor, ndërsa hyrje nga dy cepat e tjerë nuk ka (Fot. 7).

Mbi labirint është vendosur kalaveshi i rrushit, në anën e djathtë, dhe gjethi i hardhisë në anën e majtë. Hardhia ndërlihdet me një rrip gjysmëharkor me degën e lerthit, gjethet e së cilës janë vënë në fund të fushës kompozicionale.

³⁷ Šašel, A. - Šašel, J. (1986) *Inscriptiones latinae quae in Iugoslavia inter annos MCMII et MCMXL repertae et editae sunt*, Situla 25, Ljubljana, p. 261.

³⁸ Oliva, P. (1959) *Pannonie a počátky krize rimskeho imperia*, Nakladatelství Československe Akademie Ved, Praha, p. 282.

³⁹ Shukriu, E. (2002) ff. 23 - 30.

Dy degë të lerthit bashkohen përmes një nyje të theksuar, të njohur si një profilaktike. Edhe përpunimit të saj i është kushtuar një kujdes i posaçëm, mbase se ajo mbron hyrjen në labirint, përkatësisht hyrjen e imagjinuar në ciklin e jetës.

Duke mbajtur parasysh se labirinti - pallati i sëpatës dyteheshe, rrjedhimisht labrisi simbolizon diellin, simbolet e paraqitura në faqet anësore të monumentit të Hyjneshës Dardane nga Smira përputhen plotësisht në simbolizmin e tyre. Kështu, këto ofrojnë paraqitjen autoktone të labirintit rrethor, në njërën anë, dhe paraqitjen jovendëse të labirintit katërkëndësh, në anën tjetër. Ky gërshetim i labirinteve, me dukje të ndryshme por me kuptim të njëjtë, mund të lidhet me prejardhjen helene të dedikantit, ushtar-vëzhgues i Legjionit IV të Flavëve, i cili shërbeu në Dardani.

Ndonëse labirinti rrethor është dhënë në trajtë dydimensionale, këtë duhet parë si sferë të plotë, e cila është gjithëherë në rrotullim e sipër, bashkë me elementet dhe hapësirat, të cilat gjenden në brendinë e saj. Rezulton të jetë kjo dhe një piramidë, si qasje për ta arritur diellin e pamposhtur, njohuritë sublime dhe përjetësinë.

Në përgjithësi, paraqitja e labirintit të qarkut të mbyllur dhe i gjithë monumenti shprehin një kompleks teogonik, filozofik dhe kozmogonik dardan. Ky labirint është paraqitja e parë e këtij lloji dhe është unik, pa analogji të imazhit dhe të polisemantikës së veçantë që e sjell. Janë këto arsye që labirinti rrethor i Smirës të njihet me emrin *Labirinti dardan*.




Foto 8: Labirinti dardan i qarkut të mbyllur, Smirë

2. Hyjnesha dardane me edh nga Romula Malva

Monumenti epigrafik me edh përkushtuar Hyjneshës Dardane u zbulua në Romula Malva të Oltenisë (Reshca, Rumani), në vitin 1968.⁴⁰ Ky monument votiv është i pari i zbuluar me përkushtim kësaj hyjneshe. Veçanti e tij, pos të tjerash, është se monumenti përmban përfytyrimin figurativ të hyjneshës (Fot. 10). Përfytyrimi i prezantuar e bëri të mundur edhe krahasimin dhe evidencimin e ngjashmërive me figurat e hyjneshës në objektet e tjera, të cilat nuk kanë mbishkrime.

Monumenti është punuar në mermer, në relief të thellë. Elementet në të janë të theksuara dhe kanë trajtim paksa të vrazhdë, gjë që është karakteristike e kulturës provinciale romake. Mungon pjesa e djathtë e monumentit, përfshirë dhe gjysmën e poshtme të dorës së hyjneshës. Dimensionet e monumentit janë 44 x 27 x 4cm.

Kornizat e monumentit janë të theksuara dhe pjesa e epërme ka trajtë gjysmëharkore. Figura e hyjneshës me edh në dorë zë gjithë sipërfaqen brenda këtyre kornizave. Në anën e majtë të pjesës së poshtme gjendet figura e kënduesit, i cili është vendosur mbi altar.

Formula e përkushtimit gjendet te korniza e epërme dhe nga kjo janë ruajtur shkronjat ...RDANICE. Emrat e dedikantëve, me funksionet e tyre, janë shënuar në pjesën e poshtme të kornizës. Lartësia e shkronjave është 0,8 - 1,5 cm.

Teksti i epërm:

...RDANICE

Teksti poshtëm:

...US DEC COL ET EL /...L EX VOTO POSUERUNT

⁴⁰ Tudor, D. – Vladescu, C. (1972) pp. 183 - 190.

Leximi i tekstit:

[Deae Da]rdanic[a]e / [...]us dec(urio) col(oniae) et [Aur]el(ius)
/ [... dec co]l(oniae) ex voto posuerunt.

Emri i dedikantëve nuk është ruajtur, pos prapashtesës -US të emrit të parë dhe të shkronjave EL të emrit të dytë, që mundëson leximin e emrit të dytë si Aurelius.⁴¹ Monumenti u ngrit në gjysmën e parë të shekullit III,⁴² nga dy dekurionë të kolonisë romake Alba Iulia, që të dy me prejardhje nga Dardania.



*Foto 9: Mbishkrimi i epërm dhe i poshtëm
i monumentit Romula Malva 1*

⁴¹ Tudor, D.-Vladescu, C. (1972) Fig. 1.

⁴² Tudor, D.-Vladescu, C. (1972) ff. 183 - 190; Tudor, D. (1978) p. 369, Fot. 102; Gage, J.- Leglay, M.-Pflaum, H.-Wuilleumier P. (1972) L'annee epigraphique, Presses Universitaires de France, Paris, pp. 138 - 139.



Foto 10a: Monument i Hyjneshës Dardane, Romula Malva 1



*Foto 10b: Monument i Hyjneshës Dardane, Romula Malva I
(Viz. Marigona Ademi)*

Figura e hyjneshës në pozitë frontale e zë gjithë sipërfaqen e monumentit. Në kornizën e epërme, mbi kokë të hyjneshës, gjendet elementi konik në trajtë gjysmëhëne (semilunare). Hyjnesha ka të veshur një tunikë të gjatë (hiton) dhe dy tunika të shkurtra (himation), të cilat kanë palë të shumta.

Hyjnesha mban mbi kokë shaminë që i bie mbi shpatulla. Ka frizurë me flokë të përdredhur, të ndarë në mes dhe që kthehen prapa në nivelin e veshëve. Frizurë të ngjashme ka edhe koka e paraqitur në kapitelin e monumentit Gllamnik 1 me përkushtim Hyjneshës Dardane, por kjo nuk mban shami (Fot. 14).

Në dorën e majtë, te gjoksi, hyjnesha mban një edh.⁴³ Me dorën e djathtë duket se mbante skeptrin, siç supozojnë dhe D. Tudor dhe C. Vladescu⁴⁴, gjë që mund të përkojë me pozitën e saj udhëheqëse.

Figura e hyjneshës, pos edhit, përcillet edhe me figurën e kënduesit (Fot. 32). Kënduesi qëndron i vendosur mbi altar, pranë këmbës së majtë të hyjneshës dhe është i kthyer në të majtë dhe jo në drejtim të saj. Prezenca e kënduesit, pos lidhshmërisë me kultin e diellit, lidhet dhe me kultin e të vdekurve dhe me këtë rast rrit numrin e funksioneve të vetë hyjneshës dhe e lidh këtë me aspektet e jetës së tejboshme. Me këto aspekte lidhet dhe koka e derrit, që duket se është vendosur në pjesën e poshtme të këmbës së majtë të shtatores nga Mediana (Fot. 16).

Sipas studiuesve D. Tudor dhe C. Vladescu hyjnesha prezanton një hyj sinkretik, që e personifikon Dardaninë dhe mban elemente të gërshetuara të natyrës, të pëlleshmërisë dhe ato ktonike.⁴⁵ Qëndrimi se hyjnesha personifikon Dardaninë, do të dukej më i sigurtë sikur në formulën e përkushtimit të mos ishte prezente shkronja C: ...RDANICE. Prezenca e shkronjës C në formulën e përkushtimit bën që teksti të lexohet **(da)rdanic(a)e**: e dardanëve (dardane) dhe jo **(da)rdaniae**: e Dardanisë. Mungesa e shkronjës A (dardanicae) mund të shpjegohet me përdorimin e gjuhës vulgare latine dhe jo të mungesës së hapësirës për të.

Duke pasur parasysh shkronjën C, mund të thuhet se ky është i vetmi monument që sjell në përfundim se është fjala për një hyjneshë dardane dhe jo për një hyjni që lidhet vetëm me territorin, siç është përfunduar më parë.

Natyrisht, hyjnesha ka mundur ta personifikojë territorin e Dardanisë

⁴³ I. Popović mendon se hyjnesha mbante një viç: Popović, I. (2008) *Dea Dardanica iz Medijane i srodni spomenici iz Balkanskih provincija carstva*, Niš i Vizantija VI, Verlag: Kulturni Centar, Niš, p. 33.

⁴⁴ Tudor, D. - Vladescu, C. (1972) pp. 183 - 190.

⁴⁵ Tudor, D. – Vladescu, C. (1972) p. 188. Shih dhe: Popović I. (2008) p. 33.

në fazat e mëhershme, por më pas ajo u bë një hyj më gjithëpërfshirës, madje dhe suprem. Këtë e dëshmojnë labirintet në monumentin epigrafik të saj të Smirës, sidomos labirinti rrethor, si paraqitje e përfytyrimit dardan të ciklit të jetës dhe të universit, e që lidhet me Hyjneshën Dardane.

Është e rëndësishme të ceket se figura e hyjneshës nga Romula Malva ka ngjashmëri me shtatoren e Medianës (Monum. 6. Fot. 53), gjithnjë duke pasur parasysh se disa atribute ndryshojnë dhe se kjo e dyta ka teknikë të një niveli më të lartë të përpunimit dhe se është kohësisht më e vonë për rreth dy shekuj.

Zbulimi i dy monumenteve në Romula Malva dhe emrat e dedikantëve me prejardhje dardane bënë të supozojmë se në afërsi ka mundur të ekzistonte dhe një tempull i kultit të Hyjneshës Dardane. Kjo lidhet edhe me faktin se një numër i konsiderueshëm i dardanëve kanë vepruar te xeheroret e Oltenisë.



*Foto 11: Shamia mbi kokën e Hyjneshës Dardane, Romula Malva 1
(Viz. M. Ademi)*

3. Hyjnesha dardane me enë bollëku nga Romula Malva

Monumenti me enë të bollëkut përkushtuar Hyjneshës Dardane u zbulua në municipiumin Romula Malva të Oltenisë (fshati Reshca, Rumani), në vitin 1968.⁴⁶ Ngjashëm me monumentin me edh (Monum. 2. Fot. 10), është monument relievor, i punuar në mermer (Fot. 12, 13). Mungon tërësisht pjesa e epërme dhe e djathtë e monumentit. Dimensionet e ruajtura janë 19 x 15 x 3 cm.⁴⁷

Monumenti ka korniza të theksuara dhe sipërfaqen brenda tyre e zë figura e hyjneshës me qëndrim të drejtë. Nga e gjithë figura është ruajtur vetëm një pjesë e veshjes me shumë palë. Pranë këmbës së majtë të hyjneshës gjendet ena në trajtë krateri, e mbushur me fruta. Hyjnesha, si edhe në monumentin me edh, ka të veshur një fustan të gjatë (hiton) dhe dy tunika të shkurtra mbi të (himation).

Teksti i mbishkrimit gjendet në pjesën e poshtme të kornizës, me lartësi të shkronjave prej 1,3cm. Monumenti është datuar në gjysmën e parë të shekullit III.⁴⁸

Teksti:

...VRDARDAN / ...MPOSVI

Leximi i tekstit:

[...A]ur (elius) Dardan / [us votu]m posui (Fot. 13)⁴⁹

Kognomen Dardanus, të cilin e mban dedikanti i monumentit, dhe krahasimi me monumentin e hyjneshës, e cila mban edhin (Monum. 2), sjellin në përfundim se monumenti është ngritur nga një person me prejardhje dardane. D. Tudor dhe C. Vladescu nxorën përfundimin se monumenti i përkushtohet një hyjneshe të fertilitetit dhe të vegetacionit.⁵⁰

⁴⁶ Tudor, D. - Vladescu, C. (1972) pp. 183 - 190.

⁴⁷ Tudor, D. - Vladescu, C. (1972) f. 188; Gage, J. - Leglay, M. - Pflaum, H. - Wuilleumier, P. (1972) p. 139.

⁴⁸ Tudor, D.-Vladescu, C. (1972) pp. 183 - 190; Tudor, D. (1978) f. 369, Fot. 102; Gage, J.-Leglay, M.-Pflaum, H.-Wuilleumier, P. (1972) pp. 138 - 139.

⁴⁹ Tudor, D.-Vladescu, C. (1972) p. 188; Gage, J.-Leglay, M.-Pflaum, H. - Wuilleumier, P. (1972) p. 139.

⁵⁰ Tudor, D.-Vladescu, C. (1972) pp. 186 - 187.

Vendi i njëjtë i zbulimit në Romula Malva, dedikanti me kognomen Dardanus dhe ngjashmëritë në veshje dhe me teknikën e punimit të relievit të hyjneshës me edh, sjellin në përfundim se është fjala për të njëjtën hyjneshë, Hyjneshën Dardane (Dea Dardanicae). Gjetja e dy monumenteve në të njëjtin vend sjell dhe supozimin se në afërsi ka ekzistuar edhe një tempull i kultit të kësaj hyjneshe.




Foto 12: Mbishkrimi i poshtëm i monumentit Romula Malva 2



Foto 13: Monumenti i Hyjneshës Dardane, Romula Malva 2

4. Hyjnesha dardane nga Gllamniku 1

Monumenti epigrafik i përkushtuar Hyjneshës Dardane u gjet në Gllamnuk të Podujevës (Kosovë), në vitin 2003 (Fot. 14).⁵¹ Ky është monumenti i dytë me përkushtim bërë kësaj hyjneshe nga Gllamnuku, pas atij të zbuluar në vitin 1992.

Hapësira e Gllamnikut konsiderohet si pozicion i vendbanimit të periudhës romake me emrin Vendenis, i cili gjendej në rrugën Lissus – Naissus. Në të u zbulua edhe mozaiku i dyshemesë me Orfeun të rrethuar me botën shtazore dhe bimore, pos vendbanimit më të gjerë të periudhës romake dhe nekropolit.⁵²

Monumenti është krijuar nga një bllok mermeri, i përpunuar vetëm në pjesën e parme. Është dëmtuar nga gjysma e fushës së mbishkrimit dhe është ruajtur me dimensione 60 x 40 x 26cm.

Kapiteli (46 x 33cm) ka profilizim të shumëfishtë dhe është zbukuruar me akrotere në trajtë të gjysmë-palmetave të stilizuara, me nga një gjeth palme. Në mes gjendet koka e femrës. Femra, e cila e ka kokën paksa të kthyer në të djathtë, ka flokë të shkurtër, të ndarë në mes dhe me kaçurrela, të cilat i bien në të dy anët e fytyrës.

Në fushën e paprofilizuar është skalitur mbishkrimi, nga i cili janë ruajtur vetëm katër rreshtat e parë. Shkronjat kanë gjatësi të njëjtë dhe këto në tre rreshtat e anës së djathtë nuk janë shumë të qarta, përderisa në rreshtin e fundit nuk ekzistojnë. Pos kognomenit, teksti ka shkurtesa, serife horizontale dhe vertikale dhe nuk ka ligatura dhe as shenja të interpunksionit. Monumenti u takon shekujve II - III.

Teksti:

DEAE DARD / M AVR VALE / RIANVS / BF COS / LEG IIII FL

⁵¹ Dobruna-Salihu, E. (2012) pp. 217 - 224. Monumenti gjendet në Muzeun e Kosovës.

⁵² Shukriu, E. (1986) *Mozaiku i Orfeut*, Gjurmime Albanologjike 15, Instituti Albanologjik, Prishtinë, ff. 15 - 21.

Leximi i tekstit:

Deae Dard(anicae) / M(arcus) Aur(elius) Vale(rianus) /b(ene)
f(iciarius) c(on)s(ularis) / leg(ionis) IIII Fl[aviae]

Kapitel me kokë të ngjashme femre nuk duket si motiv në monumentet votive, andaj E. Dobruna-Salihi e sheh me të drejtë si motiv të lidhur me Hyjneshën Dardane, aq më tepër se trajtë të ngjashme të frizurës nën shami ka edhe hyjnesha nga Romula Malva 1 (Monum. 2. Fot. 10).

Dedikanti i cili mban formulën *tria nomina*, është Marcus Aurelius Valerianus, beneficiar konzular i Legjionit IV të Flavëve (Legio IV Flavia). Ky legjion, bashkë me Legjionin VII të kludijve (Legio VII Claudia) ishte i stacionuar në Dardani, përkatësisht në gjithë provincën e Mezisë së Epërme.⁵³

Kognomeni Valerianus ka prejardhje latine⁵⁴ dhe në Dardani paraqitet disa herë, ndërsa në Kosovë duket në monumentet e Batushës dhe të Soçanicës.⁵⁵ I shfaqur si gentilic i përhapur në Dardani, sipas mendimit të drejtë të Z. Mirdita dhe E. Dobruna-Salihi duket se është fjala për një individ vendës.⁵⁶

Aurelius është gentilic perandorak, i cili paraqitet më shpesh në Dardaninë veriore⁵⁷ dhe në Kosovë, duket kryesisht në territorin e Ulpianës.⁵⁸ Z. Mirdita dhe E. Dobruna-Salihi mendojnë se bartësit e këtij gentilici, përkundër emrit latin, kanë etnitet vendor, si rezultat i fitimit të së drejtës qytetare romake përmes *Constitutio Antoniana*.⁵⁹

⁵³ Mirković, M. (1968) Rimski gradovi na Dunavu u Gornjoj Meziji, Arheološko društvo Jugoslavije, Beograd, p. 27; Mirković, M. - Dušanić, S. (1976) Inscriptions de la Mesie superieure, l'Université de Beograd, Beograd, pp. 27 - 30.

⁵⁴ Cajanto, I. (1965) *The Latin Cognomina*, Societas Scientiarum Fennica. Commentationes Humanarum Litterarum XXXVI 2, Helsinki, p. 157.

⁵⁵ Mirdita, Z. (1981a) f. 252, kat. nr. 241; 267, kat. nr. 336.

⁵⁶ Mirdita, Z. (1981b) Onomastika dardane, Rilindja, Prishtinë, ff. 58 - 59; Dobruna-Salihi, E. (2012) f. 219.

⁵⁷ Petrović, P. (1976) f. 141; Petrović, P. (1975) pp. 145 - 146.

⁵⁸ Mirdita, Z. (1981a) f. 251, nr. 237, ff. 252 - 255, nr. 243.

⁵⁹ Dobruna-Salihi, E. (2012) p. 219; Mirdita, Z. (1981) ff. 58 - 59.



*Foto 14: Monumenti i Hyjneshës Dardane nga Gllamniku I
(Viz. A. Morina)*

5. Hyjnesha dardane nga Gllamniku 2

Monumenti epigrafik i përkushtuar Hyjneshës Dardane u gjet në Gllamnuk të Podujevës (Kosovë), në vitin 1992 (Fot. 15).⁶⁰ Në Gllamnuk janë zbuluar më parë vendbanimi i periudhës romake, nekropoli, si dhe mozaiku i Orfeut me shtazë.⁶¹ Në të ubifikohet vendbanimi i periudhës romake Vendenis, i cili gjendej në rrugën Lissus – Naissus (Lezhë - Nish).

Monumenti është trajtuar në bllok mermeri dhe nga ai janë ruajtur vetëm kapiteli, formula e përkushtimit dhe fundi i rreshtit të parë të fushës së mbishkrimit.

Kapiteli ka profilizim me disa rende dhe është dekoruar vetëm në anën e parme.⁶² Në pjesën e majtë të kapitelit është ruajtur akroteri i relievuar në trajtë gjysmë palmete të stilizuar, e vendosur mbi dekorimin vezak. Para akroterit gjenden tri spirale, nga të cilat ajo qendrore dhe e epërme kanë drejtim perëndim - lindje (vdekja - ringjallja), ndërsa e vogla lindje – perëndim (lindja).

Spiralet më të vogla drejtimesh të kundërta janë vendosur në një degë, e cila duket përcillet nga ana e djathtë e monumentit. Kështu, ndonëse dekorimi i anës së djathtë është dëmtuar, mund të konstatohet, siç ka shkruar dhe E. Dobruna-Salihu, se edhe në anën e djathtë të monumentit gjendeshin motive identike. Dekorimi i ruajtur i kapitelit lejon supozimin se spiralja e madhe dyshe, e vendosur në mes, ishte motivi kryesor dhe se mbi të shtrihej dega me nga katër spirale.

Formula e përkushtimit, DEAE DARD, është skalitur në pjesën e epërme të trupit të monumentit, ndërsa nën të gjendet fusha e mbishkrimit, e vendosur në kornizë të profilizuar dhe të thelluar. Monumenti datohet në shekujt II - III.

Teksti:

DEAE DARD /...VI NV /RVS

⁶⁰ Dobruna-Salihu E. (2005) Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake 1,2, Instituti Albanologjik, Prishtinë, f. 832, T. 163, Fig. 304.

⁶¹ Shukriu, E. (1986) ff. 15 - 21.

⁶² Dobruna-Salihu E. (2005) f. 832, f. 354. Fig. 304.

Leximi i tekstit:

Deae dard(anicae) / [.....] vi(?) nv(?) / [.....]rus / [.....]



*Foto 15: Monumenti i Hyjneshës Dardane nga Gllamniku 2
(Viz. A. Morina)*

6. Hyjnesha dardane nga Mediana

Shtatorja e Hyjneshës Dardane është zbuluar në vendbanimin antik Mediana afër Nishit (Serbi), në vitin 1933 (Fot. 16).⁶³ Është punuar në mermer të bardhë dhe ka lartësi të ruajtur prej 1,34m. Hyjnesha ka të veshur një tunikë të gjatë (hiton) dhe një tunikë të shkurtër mbi të (himation). Koka e hyjneshës, ndonëse mungon, ka qenë e mbuluar me një shami, siç tregojnë gjurmët e ruajtura në shpatullat dhe shpinën e shtatores.⁶⁴

Figura duket në lëvizje, me peshë të trupit mbi këmbën e majtë dhe me këmbë të djathtë paksa të lakuar. Në dorën e djathtë hyjnesha mban një viç te gjoksi, ndërsa në dorën e majtë, të lëshuar poshtë, qesen (marsupium). Pranë këmbës së majtë gjendet koka e derrit faran (derr për damaz), ndërsa mbi kokën e tij gjendet sëpata dytehëshe (labris).

Shtatorja përkon me stilin e veçantë të antikës së vonë, të krijuar rreth vitit 320. Kjo paraqitje e femrës me pozitë tradicionale dhe veshje të madonës romake është skemë e njohur, e cila u krijua sipas modelit të hyjneshave të veshura në *peplos* të periudhës së vonë helenistike.⁶⁵ Por, veshja e hyjneshës nga Mediana dallon nga ato të periudhës helenistike, pasi që është trajtuar në mënyrë lineare dhe jo me palë ritmike, gjë që i jep shtatores më shumë paraqitje dydimensionale.⁶⁶

Ndryshe nga përcaktimi më i lehtë kohor i shtatores nga Mediana, atributet e ndryshme prezente në të e bëjnë të vështirë përcaktimin e emrit të hyjneshës së paraqitur. Madje këtotribute duken veç e veç tek hyjnitë e caktuara, por asnjëherë bashkë, si në rastin e hyjneshës nga Mediana.

Viçi, simbol i pëlleshmërisë dhe i mirëqenies, ishte atribut qendror i taurobolisë në kultin e Kibelës, në kultin e Mitrës dhe atë të Jupiter Dolihenit dhe po ashtu konsiderohej edhe si nismëtar i kozmogonisë, pasi që mendohej sa nga gjaku u tij nis jeta e re.

Labrisi paraqitet edhe në kultin e Kibelës, si edhe viçi, por skema ikonografike e Kibelës ndryshon. Kibela paraqitet gjithëherë e ulur, kryesisht midis dy luanëve, bashkë me instrumentet e kultit të saj, timpanën e paterën, të cilat mungojnë në shtatoren e Medianës. Viçi dhe labrisi shfaqen edhe në

⁶³ Vulić, N. (1931); Picard, Ch. (1953); Nenadović, A. (1961); Petrović, P. (1976); Jovanović, A. (1980) pp. 53 – 60; Srejić, D. - Cermanović-Kuzmanović, A. (1987) f. 134, nr. 58; Popović, I. (2008).

⁶⁴ Popović, I. (2008) p. 31.

⁶⁵ Srejić, D. - Cermanović-Kuzmanović, A. (1987) Rimska skulptura u Srbiji, Galerija Srpske Akademije Nauka i Umetnosti, Beograd, p. 134, nr. 58; Popović, I. (2008) p. 31.

⁶⁶ Srejić, D. - Cermanović-Kuzmanović, A. (1987) p. 134, nr. 58.

kultin e Jupiter Dolihenit, por edhe në këtë rast me paraqitje tjetër ikonografike. Derri faran nga shtatorja e Medianës është simbol përcjellës edhe i Dianës, por asnjëherë nuk paraqitet bashkë me labrisin dhe vëçin. Qesja (marsupium), si simbol i mëvonshëm i mirëqenies dhe si materializim i pronës së njeriut, është atribut përcjellës i Merkurit dhe i gjysmëhyjnës Ubiritasit, por as këta nuk i kanë simbolet e tjera që i bart shtatorja e Medianës.

Duke pasur parasysh se simbolet që i bartin hyjnitë e ndryshme janë dhe përcaktues të funksioneve të tyre dhe identifikohen lehtë, në rastin e shtatores nga Mediana simbolet janë interpretuar në mënyra të ndryshme. Kështu, përderisa N. Vuliq e përshkruan monumentin si një shtatore femre, pa përcaktim kronologjik dhe attribute religjioze,⁶⁷ Ch. Picard, duke e parë si hyj sinkretik, e sheh si një interpretim autokton të Kibelës, hyjnisë supreme të Azisë së Vogël.⁶⁸ A. Nenadović e sheh si Dianë, hyjneshtë të gjuetisë,⁶⁹ ndërsa P. Petrović si personifikim i një hyjnie autoktone të tokës dhe të gjuetisë, me funksione të Kibelës dhe të Dianës.⁷⁰

Vetëm A. Jovanović, në një studim më të gjatë, e pa shtatoren nga Mediana si personifikim të Dardanisë, duke i parë atributet si shenja me kuptim të caktuar dhe jo si simbole universale.⁷¹ Ndonëse janë shfaqur mendime të ndryshme për shtatoren e Medianës dhe hyjneshtën që e përfaqëson, të gjithë studiuesit pajtohen me mendimin se është fjala për një interpretim autokton dhe se hyjnesha e paraqitur kishte më shumë funksione.

Kur dimë se territori ku është zbuluar shtatorja ishte pjesë e Dardanisë, pas analizës së monumenteve të tjera dhe njohjes së funksioneve të shumëfishta të hyjneshtës dardane, mund të përfundohet se shtatorja nga Mediana prezanton Hyjneshtën Dardane dhe me të edhe vetë territorin e Dardanisë. Fakti se ikonografia e shtatores nga Mediana përputhet deri në një shkallë me atë nga Romula Malva dhe se në këtë të dytën qëndron përkushtimi Hyjneshtës Dardane (Deae dardanae), dhe jo Deas së Dardanisë (Deae Dardaniae), e përforcon këtë qëndrim.

Paraqitja e shtatores lidhet me lulëzimin e Medianës në kohën e sundimit të perandorit Konstantini i Madh, i cili ishte dardan dhe tek i cili duhet të kishte pasur ndikim besimi në hyjneshtën e vendlindjes së tij. Shtatorja përcjell konceptin e ikonografisë së Romula Malvës (Fot. 10, 11) dhe të Brantiqit të Poshtëm (Fot. 17), gjë që tregon se është fjala për një koncept të standardizuar dhe të njohur për dardanët, jashtë traditës romake të kohës.

⁶⁷ Vulić, N. (1931) nr. 237.

⁶⁸ Picard, Ch. (1953) pp. 70 - 95.

⁶⁹ Nenadović, A. (1961) p. 169.

⁷⁰ Petrović, P. (1976) p. 148.

⁷¹ Jovanović, A. (1976) *Neki aspekti problema skupnog nalaza skulptura sa Medijane kod Niša*, Starinar XXIV-XXV, Beograd, pp. 54 - 55.



Foto 16: Shtatorja e Hyjneshës Dardane, Medianë (I. Popović 2008)

7. Hyjnesha dardane nga Branetiqi i Poshtëm

Paraqitja figurative e Hyjneshës Dardane me shtazë në dorë gjendet në dorëzën e paterës prej argjendi, të zbuluar në Branetiq të Poshtëm, rrëzë maleve të Rudnikut (Serbi. Fot. 17, 18). Patera u gjet bashkë me enë të tjera prej argjendi, diku kah mesi i shek. XX.⁷²

Mjeshtri i patelës u ka kushtuar kujdes të madh detajeve të shumta, të cilat flasin me një gjuhë të veçantë për ta përcjellë mesazhin në kohë. Megjithëkëtë, teknika e përpunimit nuk duket të jetë e nivelit tejet të lartë, ndërsa vetëm koka e hyjneshës ofron përshtypje të trajtimit pak sa rustik.

Hyjnesha është paraqitur deri në bel, me një fustan me duar të gjata dhe me shumë rrudha. Në lakesën e dorës së majtë mban shtazën e mbështetur në gjoks, ndërsa shuplakën e ka të lirë dhe gishtërinjtë e drejtuar lart. Në dorën e djathtë, të lëshuar poshtë nga bërryli, mban kallirin e grurit. I. Ivanović mendon se ajo mban edhe një shami,⁷³ por kjo nuk duket e besueshme, pasi që aty shtrihen bishtat e kallirit të grurit.

Mbi kokën e hyjneshës është vendosur kurora murale (corona muralis) në trajtë katërkëndëshi, me katër nivele dhe katër rreshta (16 katrorë). Hyjnesha ka flokë paksa të valëzuar dhe të ndarë në mes. Duket se flokët janë kapur nga prapa, pasi që pas nivelit të veshëve kthehen prapa në trajtë harkore (Fot. 48). Nën kallirin e grurit gjendet shtaza në lëvizje dhe nën të sëpata dhe altari (Fot. 38).

Patera është datuar në fund të shek. II dhe në gjysmën e parë të shek. III, në bazë të trajtës së paterës dhe frizurës së figurës së hyjneshës.⁷⁴

Shtaza në kraharorin e hyjneshës krijon dilema nga fakti se natyra e shtazës nuk është mjaft e qartë. Kështu, nuk mund të përcaktohet me shumë siguri se çfarë mban hyjnesha: edh, qengj apo viç. Zbërthimi mund të shihet tek figura e madhe e shtazës nën hyjneshën, e cila duhet të jetë në lidhshmëri me shtazën e vogël, të cilën e mban hyjnesha. Nëse kihet parasysh se shtaza e madhe ka brirë të gjatë dhe të theksuar, atëherë duhet llogaritur më shumë në paraqitjen e cjamin dhe më pak të dashit, ndërsa për kaun nuk duket se mund të bëhet fjalë.

⁷² Popović, I. (2008) pp. 34 – 35, Fot. 4.

⁷³ Popović, I. (2008) p. 35.

⁷⁴ Popović, I. (2008) p. 35.

Hyjnesha është parë si hy sinkretik me veti të Magna Mater, Terra Mater apo dhe si Epona. Kjo e fundit nuk mund të qëndrojë, pasi që hyjnesha nuk mban në gjoks një kalë të vogël, siç e mban Epona kelte.⁷⁵

Ikonografia e hyjneshës nga Romula Malva (Fot. 10) dhe e asaj nga Mediana (Fot. 16), me fustan të valëzuar dhe me shtazë te gjoksi, sugjerojnë se edhe me këtë rast është fjala për Hyjneshën Dardane. Mbajtja e kallirit të grurit si simbol i mirëqenies ka të njëjtin kuptim si qesja (marsupium) në shtatoren e Medianës, siç konkludon dhe I. Popović.⁷⁶

Kurora në kokën e hyjneshës është atribut vetëm i hyjneshave universale, ndërsa në antikën e vonë edhe personifikim i qyteteve dhe i rajoneve.⁷⁷ Duke u bazuar në këtë të dytën dhe pasi që është gjetur në rajon xehetar, si edhe monumentet e Romula Malvës dhe të Medianës, edhe kjo hyjneshe u pa në të kaluarën si Hyjneshe e Dardanisë⁷⁸ dhe jo si Hyjneshe Dardane.



Foto 17: Patela nga Branetiçi i Poshtëm (I. Popović 2008)

⁷⁵ Green, M. (1989) *Symbol and Image in Celtic Religious Art*, Routledge, London and New York.

⁷⁶ Popović, I. (2008) p. 35.

⁷⁷ Alföldi, G. (1963) pp. 149 - 150.

⁷⁸ Popović, I. (2008) p. 35.

Ikonografia e përgjithshme e dorëzës së patelës përmban edhe elemente anësore, të cilat, në bazë të njohurive të deritashme, nuk janë trajtuar ende. Janë këto motivet e vendosura në të dy anët e hyjneshës, në pjesën e epërme të dorëzës e që ngjajnë në motivet e palloit, si dhe në ato në fund të dorëzës, të cilat shtrihen deri te nisma e buzëve të enës. Në të dy rastet paraqiten simbolet e diellit të bëra me rathë koncentrikë dhe pikë në mes apo me gjashtë pika të vendosura në trajtë rrethi me pikë në mes. Këto gjenden në të dy anët e kalimit nga dorëza në buzët e patelës. Simbolet e diellit me trajta të ndryshme ndër lidhen njëra me tjetrën.

Disa simbole rrethore kanë edhe “bishtin” e zgjatur dhe këto, bashkë me të tjerat, kërkojnë zbërthime më të detajizuara, pasi që jo rastësisht mjeshtri i ka vendosur si të tilla në vende të caktuara. Këto mund të jenë paraqitje të cikleve të diellit, nëse jo edhe të kalendarit vjetor.



Foto 18: Hyjnesha Dardane nga Branetiqi i Poshtëm

Është me rëndësi të ceket se dorëza e paterës sjell konceptin e treshit përmes ndarjes ikonografike në tri zona. Zonën e parë dhe më të gjatë e zë figura e hyjneshës, që duket të jetë në sferën qiellore. Kalliri i grurit e bën ndarjen e zonës së parë të sferës qiellore nga e dyta, ku gjendet figura e shtazës në lëvizje. Nën këmbët e shtazës gjendet një vijë, e cila e ndan zonën e dytë tokësore me të tretën, të nëndheshmen. Në zonën e tretë janë vendosur sëpata dhe altari. Kështu, skema ikonografike përmban ndarjen e botës qiellore dhe tokësore përmes kallirit të gurit, si dhe të botës tokësore dhe të nëndheshme përmes një vije të theksuar.

Konceptin e treshit e përmbajnë edhe simbolet anësore të ikonografisë së patelës, në pjesën e epërme të dorëzës dhe në ato në fund të dorëzës, te nisma e buzëve. Koncepti te nisma e buzëve nis me diellin e trajtësuar përmes pikave, që si duket lidhet me zonën tre të nëntokës dhe që me një vijë ndahet nga dielli me rathë koncentrikë dhe me bisht që përfundon me rreth. Ky simbol ndahet përmes një vije të lakuar të vogël nga simboli tjetër, i cili është një rreth vogël me vijë të zgjatur. I gjithë kompozicioni mund të shihet edhe si ndërlidhje me shtazën e flijuar hyjnisë, gjakun e derdhur dhe ciklin e përhershëm të ringjalljes.

Shumëtrajshmëria e simboleve anësore dhe e gjithë ikonografia shtrojnë para studiuesve nevojën për analiza të mëtejme. Në kuadër të kësaj duhen analizuar dhe trajtat e ndryshme të simboleve të anës së djathtë dhe të majtë të buzëve të patelës. Kjo shtrohet si nevojë edhe pasi që rrethi koncentrik në anën e djathtë e ka në mes një sferë të relievuar, ndërsa simboli në anën e majtë këtë nuk e ka. Kjo nuk është bërë rastësisht, përkundrazi. E trajtuar në detajet më të imëta përcjell mesazhet e qarta të mjeshtrit mbi botëkuptimet dardane, të cilat duhet të zërthehen.

Patela e Branetiçit të Poshtëm është gjithsesi një objekt me vlera të jashtëzakonshme dhe zbërthimi i mëtejme i simboleve që i bart është i domosdoshëm. Me të dëshmohet edhe një nivel i përparuar kulturor dhe ekonomik i popullatës dhe, mbi të gjitha, i gjithë kompleksiteti i botëkuptimeve të kohës mbi jetën dhe përjetësinë, si dhe kozmogoninë dardane (Shih kapitullin VII).

8. Hyjnesha dardane nga Kamenica

Monumenti votiv me përkushtim për Hyjneshën Dardane është zbuluar në lokalitetin Kamenica, i cili gjendet në rajonin xehetar të Runikut (Serbi), jo larg Branetiçit të Poshtëm.⁷⁹

Monumenti është zhdukur, por kanë ngelur shënimet vijuese:

Teksti:

[...] DARD S

Leximi i tekstit:

[Deae] dard(anicae) s[ac](rum)

Është supozuar se monumenti është ngritur nga një i liruar perandorak dhe se i takon vitit 140.⁸⁰

Mbështetur në të dhënat të cilat i ofrojnë monumentet 1-7, hapësira e dëmtuar e formulës së përkushtimit përmbante dhe tekstin e përkushtimit DEAE, siç konstaton dhe S. Dušanić.⁸¹

⁷⁹ Dušanić, S. (1976) pp. 56 - 157, nr. 167.

⁸⁰ Dušanić, S. (1976) p. 157; Popović, I. (2008) p. 36.

⁸¹ S. Dušanić e lexon: [Deae] Dard(anicae) s[ac](rum); Dušanić, S. (1976) p. 157.

9. Dardanicae sacrum nga Banja e Kurshumlisë

Në Banjë të Kurshumlisë është zbuluar monumenti votiv me formulë të shkurtuar të përkushtimit: *Dar sacrum*.

Teksti:

DAR SAC / PHILOXENVVS AUG / N SER VILIC / STAT AQUAR
BASSIANAE / TEMPLUM EX VOTO / A SOLO RESTITIUT / V
LS / ...G. SENEC ET AEMILIANO COS

Leximi i tekstit:

Dar(danicae) sac(rum) / Philoxenus Aug(ustorum) / n(ostrorum) ser(vus)
vilic(us) / stat(ionis) Aquar(um) Bassianae / templum ex voto / a solo restituit /
v(otum) l(ibens) s(olvit) / ...G. Senec(ione) et Aemiliano co(n)s(ulibus).⁸²

Monumenti datohet në vitin 206, sipas palës konsulare G. Senecione dhe Aemiliano.

Duke e interpretuar formulën e përkushtimit të dhënë si shkurtesë, Z. Mirdita dhe N. Vulić e shohin si përkushtim për hyjneshën e Dardanisë (*Dardaniae sacrum*).⁸³ Shkurtesa DAR... e formulës së përkushtimit shtron çështjen e interpretimit të saj, sepse mund të lexohet si *dar(danicae)* dhe si *dar(daniae)*. Në këtë drejtim shtrohet pyetja se a i është përkushtuar monumenti Dardanisë si territor: *Dardaniae sacrum* apo i është përkushtuar Hyjneshës Dardane: *Deae Dardanicae*. Monumenti ka mundur t'i përkushtohet vetëm Dardanisë si territor, por kjo nuk duket e arsyeshme, aq më tepër që në afërsi gjendej edhe tempulli, siç paralajmëron mbishkrimi, andaj mendoj se në këtë rast më shumë qëndron kjo e dyta.

Mosparaqitja e termit DEAE mund të shpjegohet me mungesën e hapësirës në monument dhe me faktin se Hyjneshja Dardane ishte e njohur për të gjithë.

Sipas tekstit të mbishkrimit monumenti votiv i është ofruar tempullit të banjës termale, që do të thotë se në Aquarum Bassianae (Banjë e Kurshumlisë) gjendej dhe një tempull i përkushtuar Hyjneshës Dardane. Monumenti, si dhe tempulli, e provojnë lidhshmërinë me hyjneshën, si dhe me funksionet e hyjnës së burimeve dhe të ujërave termale.

⁸² Z. Mirdita e lexon si Dard(aniae) sac(rum): Mirdita, Z. (1981a) f. 252.

⁸³ Mirdita, Z. (1981a) f. 252, nr. 239; Vulić, N. (1931) nr. 221.

10. Monumenti i hyjneshës në Kishën e Lypjanit

Në kishën e hershme të Lypjanit është zbuluar një fragment monumenti votiv,⁸⁴ i cili duket t'i jetë përkushtuar Hyjneshës Dardane. Ky gjendet në përdorimin e tij sekondar, ndërsa te hyrja e kishës janë prezente gjurmët e bazamentit më të vjetër të periudhës romake të kishës paleokristiane të Shën Florit dhe të Shën Laurit (Fot. 19).

Teksti:

DEAE.../ C OPPIVS / C FILIVS V P

Leximi i tekstit:

Deae [dardanicae?] / C(aius) Oppius / C(ai) filius v(otum) p(osuit).

Monumenti është datuar në shekullin III.⁸⁵

Nga teksti i dëmtuar ka ngelur vetëm formula e përkushtimit: *Deae*, pa emër të hyjneshës, dhe emri i dedikantit, *Caius Oppius*. Mungesa e emrit të hyjneshës e bëri studiuesin e saj Z. Mirdita të supozonte se monumenti i është përkushtuar hyjneshës Junona ose Dianës.⁸⁶

Kur kihet parasysh se në hapësirën e dëmtuar të formulës së përkushtimit ka vend dhe për disa shkronja të tjera dhe përmes analizës së monumenteve përkatëse nxirret përfundimi se monumenti i është përkushtuar Hyjneshës Dardane. Pos kësaj, përfundimi nxirret dhe nga fakti i paraqitjes së hyjnive vendëse nga shekulli III me emrat e tyre dhe jo më me interpretim romak, nga fakti se monumenti është ngritur në shekullin III dhe nga paraqitja e shpeshtuar e monumenteve përkushtuar Hyjneshës Dardane në këtë kohë.

⁸⁴ Mirdita, Z. (1981) f. 254, nr. 250.

⁸⁵ Z. Mirdita e lexon v(ivo) p(osuit): Mirdita, Z. (1981) f. 254.

⁸⁶ Mirdita, Z. (1981a) f. 254.




Foto 19: Kisha e Lypjanit (Kosovë)

11. Monedha me figurë hyjneshe dhe mbishkrim dardanici 1

Monedha me figurë hyjneshe dhe me mbishkrim *dardanici* është zbuluar në lokalitetin e periudhës romake të Soçanicës (Fot. 20). Lokaliteti është i njohur me emrin Municipium DD, sipas mbishkrimit të zbuluar në të.⁸⁷

Monedha është emituar në vitet 98-100, kur perandori romak, Trajani, fitoi titullin Germanicus, dhe ka përmbajtte vijuese:

Avers: IMP. CAES. NERVA TRAIAN. AVG. GERM. Busti me kurorë, i kthyer në të djathtë.

Revers: DARDANICI. Figurë femre që mban kallirin e grurit me dorën e djathtë dhe me të majtën cepin e tunikës së gjatë (hitonit).⁸⁸

Monedha është me interes për shqyrtimin e dukjes së Hyjneshës Dardane në monumente të ndryshme, pasi që në reversin e tyre është paraqitur figura e një hyjneshe, më parë të panjohur.

Figura femërore, e cila duket edhe në averset e monedhave të tjera, u pa vetëm nga ana e H. Cohen si hyjneshë e Dardanisë.

Studiuesit e tjerë e panë si hyjneshë prejardhesh të ndryshme, duke u nisur nga Rah, Annona, Abundatia e deri tek Cerera. Mëdyshjet e studiuesve duken të arsyeshme, pasi që hyjnesha në reversin e monedhave ka simbole dhe paraqitje jo të zakonshme në krahasim me hyjneshat me të cilat u identifikua.

Hyjnesha u pa si Cerera romake dhe Demetra helene, pasi që këto paraqiten me kallirin e grurit, ngjashëm si te hyjnesha e monedhës. Por, duhet cekur se pozita e dy të parave, përfshirë edhe ato të duarve dhe të attributeve që i mbajnë, ndryshojnë. Përderisa Demetra paraqitet e ulur, Cerera mban kallirin e grurit me dorën e majtë dhe të ngritur lart, ndërsa dhe me dorën e djathtë mban një

⁸⁷ Čerškov, E. (1970) Municipium DD kod Sočanice, Arheološko Društvo Jugoslavije, Priština - Beograd.

⁸⁸ Cohen, H. (1882) Description Historique des Monnaies Frapees sous l'Empire Romain II 2, Rollin & Feuarent, Paris, p. 32, nr. 138.

skeptër. Hyjnesha në reversin me mbishkrim *dardanici* mban kallirin e grurit me dorën e djathtë, jo me të majtën si Cerera, dhe këtë e ka të lëshuar poshtë dhe jo lart si Cerera (Fot. 21).

H. Cohen, duke i trajtuar monedhat me mbishkrim *dardanici*, e konsideroi hyjneshën e panjohur si Dea e Dardanisë, duke e parë si personifikim të Dardanisë,⁸⁹ ndërsa A. Jovanović këtë mundësi e hedh poshtë, duke thënë se në monedhat e minierave nuk janë gjetur dëshmi me aluzione gjeografike.⁹⁰ Kundërshtimi i A. Jovanović, i cili mbështetet në të dhënën se nuk ekzistojnë monedha me aluzione gjeografike, e përforcon mendimin se në revers është paraqitur Hyjnesha Dardane dhe jo ajo e Dardanisë, si hyj i territorit. Në këtë drejtim, mendimi i H. Cohen del më afër të vërtetës, duke e konsideruar hyjneshën e reverseve si Dea e Dardanisë. Por, mendoj se me këtë rast është fjala për Hyjneshë Dardane (Dea Dardanae), e cila nuk është vetëm personifikim i territorit të Dardanisë, por ngërthen edhe funksione më gjithëpërfshirëse hyjnore.



Foto 20: Monedhë e perandorit Trajan me mbishkrim *dardanici*

⁸⁹ Cohen, H. (1882) p. 32.

⁹⁰ Jovanović, A. (1980) p. 57.



Foto 21a: Hyjnesha Cerera
(www.crystalinks.com)



Foto 21b: Hyjnesha Dardane
(Viz. F. Isufi - Koja)

Dukja e monedhës, si edhe e të tjerave, lidhet me pasurinë minerale të rajonit të Municipium DD dhe me aktivitetet me vlera të mëdha xehetare në to. Andaj, është konstatuar se rajoni xehetar i Dardanisë është krijuar shumë herët dhe se qendra administrative e saj gjendej te Soçanica e sotme (Kosovë): *Municipium D Dardanorum*.⁹¹

Aktivitetet xehetare dardane janë njohur edhe më herët dhe po ashtu është e njohur se xehetarët dardanë vepronin edhe në rajone të tjera, siç është rasti me xeheroret e Dakisë së periudhës romake. Siç mund të konstatohet nga monumentet epigrafike, vendosja e dardanëve në Daki u bë pas rënies së Dakisë nën sundimin romak dhe të krijimit të provincës romake të Dakisë.⁹²

⁹¹ Čerškov, E. (1970); Dušanić, S. (1971) pp. 241 - 261.

⁹² Tudor, D.-Vlădescu, C. (1972) p. 189; Protase, D. (1978) pp. 127 - 135.

12. Monedha me figurë hyjneshe dhe mbishkrim dardanici 2

Monedha me mbishkrim *dardanici* dhe me figurë hyjneshe është zbuluar në Soçanicë, lokalitet i periudhës romake (Fot. 22). Sipas mbishkrimit të zbuluar, lokaliteti njihet me emrin Municipium DD dhe gjendej tek Soçanica (Kosovë).⁹³ Monedha ka përmbajtur vijuese:

Avers: IMP. CAES. NERVA TRAIAN. AVG.

Revers: DARDANICI. Figurë femre e kthyer në të djathtë, në dorën e djathtë mban kallirin e grurit, me të majtën cepin e tunikës së gjatë (hiton).⁹⁴

Monedha është krijuar para vitit 98, nga fakti se perandori Trajan është vetëm *augustus* dhe nuk i ka titujt e tjerë si GERM apo GERM DAC, të cilat i fitoi pas pushtimeve të territoreve të reja, siç ishte, për shembull, Dacia.

Si dhe monedha paraprake, pos mbishkrimit që mban, është me interes për shkak të paraqitjes së figurës së hyjneshës në revers. Për analizën e monedhës dhe të paraqitjes së hyjneshës në revers vlen teksti paraprak.

⁹³ Čerškov, E. (1970).

⁹⁴ Mattingly, H. (1966) *Coins of the Roman Empire in the British Museum*, Vol. III: Nerva to Hadrian, The Trustees of the British Museum, London, nr. 234; Zmajčić, B. (1964) pp. 1-9; Simić, V. - Vasić, M. (1977) *La monnaie des mines romaines de l'Illyrie*, Revue numismatique XIX, Société Française de Numismatique, Paris, pp. 56 - 57; Jovanović, A. (1980) p. 57; Peja, F. (2000) *Contribution à l'étude des monnaies des "metalla Dardanica"*, Staatliche Museen zu Berlin, Berlin, pp. 607 - 609.



*Foto 22: Monedha e Trajanit me figurë hyjneshe dhe me mbishkrim: **dardanici***

13. Monedha me mbishkrim dardanici dhe roma dhe me figurë hyjneshe

Në Muzeu Britanik të Londrës gjenden tri monedha me paraqitjen e hyjneshës dhe me mbishkrim *dardanici* në revers, ndërsa në avers gjendet koka e femrës me përkrenare dhe mbishkrimi *Roma* (Fot. 23-25). Si monedha të Dardanisë këto janë botuar nga H. Mattingly.⁹⁵

Monedhat e kanë të ngjashme paraqitjen e hyjneshës në revers dhe mbishkrimin *dardanici*, si edhe monedhat paraprake. Por këto dallojnë për nga aversi, se në to është paraqitur koka e femrës me përkrenare (hyjnesha *Roma*) dhe mbishkrimin *ROMA* dhe jo busti i perandorit Trajan dhe as mbishkrimi me emrin e tij.

Monedha 1

Avers: RO MA. Busti i Romës me helmetë (Fot. 23).

Revers: D ARDA NICI. Figurë femre e kthyer në të djathtë, në dorën e djathtë mban kallirin e grurit, dora e majtë e lëshuar poshtë, e paqartë çfarë mban me të.



Foto 23: Monedha 1 me mbishkrim *Roma* dhe *dardanici*

⁹⁵ Mattingly, H. (1966) p. 534, T. 98, Fig. 9 - 11.

Monedha 2

Avers: RO MA. Busti i Romës me helmetë.

Revers: DA RDA NICI. Figurë femre e kthyer në të djathtë, në dorën e djathtë mban kallirin e grurit, dora e majtë e lëshuar poshtë (e paqartë çfarë mban në të. Fot. 24).



Foto 24: Monedha 2 me mbishkrim Roma dhe dardanici

Monedha 3

Avers: RO MA. Busti i Romës me helmetë.

Revers: DA RDA NICI. Figurë femre e kthyer në të djathtë, në dorën e djathtë mban kallirin e grurit, dora e majtë e lakuar, por e paqartë çfarë mban në të (Fot. 25).

Monedhat nga Muzeu Britanik janë farkime të veçanta dhe këto shtrojnë nevojën për studime të mëtejme, si dhe për paraqitjen e hyjneshës në to, e cila e paraqet Hyjneshën Dardane.



Foto 25: Monedha 3 me mbishkrim **Roma** dhe **dardanici**

14. Busti i hyjneshës dardane nga Banja e Klllokotit

Në Banjë të Klllokotit (Kosovë) është zbuluar busti i një gruaje, i skalitur në mermer, i cili u bë i njohur me emrin *Busti i Gruas nga Klllokoti* (Fot. 26).

Busti u gjet në lokalitetin me toponimin *Banjë e Klllokotit* te Banja e Klllokotit, i cili njihet si vendbanim më i madh i periudhës romake. Zbulimi i monumenteve të Smirës dhe i lokalitetit *Gradina* tek Gushica, po ashtu vendbanim i gjerë i periudhës romake, dëshmojnë për një jetë mjaft të zhvilluar në gjithë këtë hapësirë.



Foto 26: Busti i Hyjneshës Dardane, Banjë e Klllokotit

Busti iu takon shekujve II - III dhe në të është paraqitur një grua e cila e ka nënkresën, që ia mbulon tërësisht flokët. Mbi të mban shaminë e gjatë, që i bie çlirët mbi supe. Me këtë rast bëhet fjalë për një veshje autoktone, për dallim nga trajtimet e ndryshme të flokëve në shtatoret e mëhershme greke apo të atyre romake.

Fytyra ka trajtë vezake, sy të mëdhenj në trajtë bajameje dhe kapakë të theksuar të syve. Në sy janë vendosur si thellime edhe bebëzat, e djathta e vendosur më lart dhe e majta më poshtë. Që të dy bebëzat dhe vetë shikimi krijojnë përshtypjen që busti të ketë një dukje që është jashtë realitetit tokësor.

Përderisa bien në sy dhe vathët e mëdhenj në trajtë të kalaveshit të rrushit, gjë që nuk duket rastësi, bustin e bën të veçantë edhe qaforja me zbukurim rrethor dhe sferë të theksuar në mes, që është simbol i diskut diellor apo vet diellit. Qafore identike me varëse rrethore mban edhe *Hyjneshë në fron*, gjë që shtron çështjen e mundësisë së kontinuitet të traditës, ndonëse ka një hiatus kohor midis tyre. Në përgjithësi, busti ka ngjashmëri me figurën e Hyjneshës Dardane nga Romula Malva (Monum. 2. Fot. 9) dhe atë të Branetiçit të Ulët (Monum. 7. Fot.17).

Monumenti nuk përmban asnjë mbishkrim, gjë që është e pazakonshme. Mbishkrimi ka mundur të jetë dhe në pjesën e poshtme të monumentit, por kjo nuk është e sigurtë. Përgjigjja se kë e përfaqëson busti duket më e thjeshtë, nëse kihet parasysh paraqitja e përgjithshme e figurës së figurës, trajtimi i fytyrës dhe, në veçanti, shikimi jo real që zë sferat hyjnore. Kësaj duhet shtuar dhe faktin se Hyjneshën Dardane e njihnin të gjithë dhe se të njëjtës hapësirë i takon edhe monumenti i Smirës, i përkushtuar kësaj hyjneshe. Këto dhe imazhi që përcillet bëjnë që monumenti i njohur si *Busti i gruas nga Kllokoti* të quhet *Busti i Hyjneshës Dardane nga Kllokoti*.

15. Shtatorja nga Theranda

Shtatorja e figurës së femrës u gjet në Therandë (Suharekë), në oborrit e shtëpisë së familjes Elshani, në afërsi të xhamisë qendrore (Fot. 27).⁹⁶ Është punuar në mermer dhe i mungon koka dhe pjesa e poshtme.

Figura është e veshur me fustan, të zënë në bel me një rrip të gjerë. Mbi të është vendosur shalli i gjatë që bie çlirët mbi trup, i kapur me fibula (?). Veshja ka pak valë, ndryshe nga ato të periudhës helenistike apo romake. Karakteristikë e shtatores është qaforja me varëse në trajtë rrethi (medaljoni rrethor), e ngjashme me atë që mban dhe Hyjnesha nga Banja e Kllokotit, si dhe figura parahistorike e *Hyjneshës në fron* (Fot. 89). Ky element duket përcaktues që kjo shtatore të shihet si përfytyrim i Hyjneshës Dardane, ngjashëm me paraqitjet e tjera të saja.



Foto 27: Shtatorja e Therandës/Suharekës

⁹⁶ Monumenti është marrë nga një lokalitet antik dhe ka qëndruar një kohë të gjatë në skaj të oborrit. U evidencua nga autorja në vitin 1993.

*

Tri monumentet epigrafike të Kosovës me përkushtim të drejtpërdrejtë Hyjneshës Dardane dhe dy të mëhershmet nga Oltenia e Rumunisë, bashkë me monumentet e tjera, flasin për rolin e veçantë të kësaj hyjneshe, si dhe shpresën për zbulimin e monumenteve të tjera me të njëjtin përkushtim.

Ndërkohë pritet dhe zbulimi i tempujve të saj, pos atij që nuk është hulumtuar te Banja e Kurshumlisë. Gjatë hulumtimit të kësaj çështjeje duhet të kihet parasysh se në shumë vende tempujt në fillim gjendeshin në shpella, ndërsa më pas këto janë vendosur në vende të hapura.⁹⁷ Në kulturën minoike dhe mikenase të epokës së bronzit e deri në periudhat historike vende kulturi ishin majat e maleve dhe shpellat, ndërsa disa ishin edhe si vendvarrime, siç ishin ato në Peloponez dhe në Ujdhesat e Kikladeve.⁹⁸

Gjatë epokës së bronzit kishte edhe tempuj që nuk gjendeshin në maja, siç ishin tempujt e zbuluar nën tempullin e Apolonit dhe të Athenës Ponaia në Delf (Greqi), ndërsa tempujt e mirënjohur të Greqisë së lashtë nisin të ndërtohen nga shek. VIII p.e.r. e tutje dhe këto lidhen me prosperitetin e vendit.⁹⁹

Përcaktimi kohor i monumenteve epigrafike me përkushtim të drejtpërdrejtë Hyjneshës Dardane, zë periudhën e shek II – III. Kjo lidhet edhe me nevojën për të vënë në pah traditën autoktone, rrjedhimisht të çështjeve identitare, në prag të krijimit të Provincës së Dardanisë, si pjesë e perandorisë romake.

Funksionet e dedikantëve të cilët i ngritën monumente Hyjneshës Dardane, kanë nivele të ndryshme. Në mesin e tyre gjenden dekurionë nga Romual Malva (Monum. 2), vëzhgues ushtarakë nga Smira (Monum. 1) e deri te *servus vilicus* nga Banja e Kurshumlisë (Monum. 9). Larmia e niveleve të ndryshme të dedikantëve dëshmon se besimi në fuqitë hyjnore të kësaj hyjneshe ishte mjaft i përhapur në mesin e popullsisë vendëse.

Ngritja e monumentit votiv për këtë hyjneshë nga dy dekurionë të Romula Malvas në Rumani mund të shpjegohet me lidhshmërinë e këtyre udhëheqësve të lartë me hyjneshën e tyre (Monum. 2), si dhe e

⁹⁷ Ferguson, J. (1989) *Among the Gods: An Archaeological Exploration of Ancient Greek Religion*, Routledge, London - New York, p. 25.

⁹⁸ Dietrich, B.C. (1986) p. 24, p. 26. Jo rastësisht, tempujt më të hershëm janë quajtur *megaron*, pasi që kjo fjalë semite rrjedh nga fjala hebraishte *mecara*: shpellë. Shih për këtë: Dietrich, B.C. (1986) p. 37.

⁹⁹ Ferguson, J. (1989) pp. 25 - 29.

Aurelius Dardanus (Monum. 3). Çështja e dedikantit Artorius Heraclitus nga monumenti i Smirës kërkon shqyrtim më të thellë lidhur me prejardhjen e tij (Monum. 1). Nomen dhe kognomen i këtij dedikanti nuk del të jetë me prejardhje dardane, ndërsa paraqitja e labirintit në trajtë katërkëndëshi, pos atij rrethor, sugjeron se vëzhguesi në legjionin romak mund të mos ishte dardan dhe se gjatë shërbimit të tij në territorin dardan ishte bindur në fuqitë hyjnore të Hyjneshës Dardane.

Emri i Hyjneshës Dardane është çështje që kërkon vëmendje të veçantë, mbi të gjitha për arsye se përkatësia e saj dardane nuk vihet në dyshim, ndërsa në të gjitha mbishkrimet ajo paraqitet me emrin latin Dea. Kjo dukuri duhet sqaruar, pasi që shumë hyj kanë emra të tyre vendës, si hyji dardan Andini dhe hyjnitë e tjera ilire, si Thana, Bindî, Eia (Heia), Iria, Ica, Anzotika, Latra, Jutosika, Sentona e të tjerët,¹⁰⁰ ndërsa një pjesë kanë interpretime romake të emrave të tyre autoktonë.

Në drejtimin e cekur shtrohet pyetja me mjaft interes: kishte Dea Dardanae emër vendës apo jo? Përgjigjja për këtë duket jo shumë e komplikuar, pasi që mund të supozohet se adhuresit e saj i janë drejtuar në gjuhën e tyre dhe me emrin e saj indigjen.

Pyetja vijuese që shtrohet është: cili ishte emri i hyjneshës para dhe gjatë periudhës romake me të cilin vendësit i drejtoheshin? Përgjigjja për këtë pyetje lidhet me rëndësinë e veçantë që kishte Hyjnesha Dardane në jetën e individit dardan, si dhe të shoqërisë dardane në përgjithësi. Këtë e dëshmon edhe fakti se Hyjneshës Dardane i drejtohen dardanët që kishin marrë rrugë dhe ishin vendosur në koloninë romake të largët, ku ishin bërë udhëheqës të lartë (decurion. Monum. 2), si dhe dedikanti tjetër, me emrin Aurelius Dardanus (Monum. 3). Që të tre dedikantët e monumenteve të Romula-Malvës ishin me prejardhje nga Dardania dhe besonin fuqimisht në forcën dhe mundësitë e hyjneshës së tyre të vendlindjes.

Hyjneshës Dardane i drejtohet me gjasë edhe një i huaj, Artorius Heraclitus (Monum. 1), i cili duket se është ndikuar nga besimi i fuqishëm dardan në kohën kur shërbente si vëzhgues në Dardani, në kuadër të Legjionit IV të Flavëve. Katër dedikantët, të cilët jetuan në periudhën romake, i drejtohen hyjneshës me emrin Dea. Si duket kjo ishte e zakonshme kur ishte në pyetje gjuha e shkruar, në këtë rast latinishtja e periudhës romake, që edhe emri të shkruhej në gjuhën latine. Andaj, fakti se në monumente është shënuar me emrin *Dea*

¹⁰⁰ Stipčević, A. (1981) Kultni simboli kod ilira, Centar za Balkanološka ispitivanja 10, Sarajevo, p. 169.

tregon se është fjala për interpretimin romak të emrit epihorik.

Megjithëkëtë, ende qëndron pyetja: cili ishte emri vendës i Deas? Duket se përgjigjen duhet kërkuar në emrin që paraqitet e shkruar në gjuhën latine: *Dea*. Është ky nocion i përgjithshëm latin, i cili nënkupton një hyjni të gjinisë femërore dhe në përkthim në gjuhën shqipe do të ishte: *Hyjneshë*.

Përdorimi i nocionit të përgjithshëm për një hyjni nënkupton se ajo/ai përmbajnë elementet vijuese:

1. është tejet e/i njohur,
2. ka rëndësi të veçantë,
3. ka funksione të shumta dhe të rëndësishme,
4. ka pozitë supreme,
5. mund ta ketë lashtësinë kontinuitive nga Nëna e Madhe (Magna Mater), nëse është fjala për hyj të gjinisë femërore.

Kur kihet parasysh se Hyjnesha Dardane i përfshin të gjitha atributet e nevojshme dhe fuqinë supreme, mund të supozohet se ajo quhej me një emër të përgjithshëm, pra vetëm *Hyjneshë* - *Dea*. Me këtë nënkuptohen të gjitha, pikë së pari roli i përgjithshëm dhe funksioni suprem. Për t'u dalluar nga hyjnitë e ngjashme të vendeve të tjera, por që lidhen me territorin, hyjnesha përcaktohet si *dardane*, që nënkupton përkatësinë dardane dhe, njëkohësisht, rolin e saj të veçantë në shoqërinë dardane. Duke i mbajtur parasysh këto, duket se as që duhet kërkuar më ndonjë emër tjetër vendës për Hyjneshën Dardane, pos atij që duket qartë: Hyjnesha Dardane.

Të gjitha monumentet përkushtuar Hyjneshës Dardane të zbuluara deri më sot janë monumente gurore dhe i takojnë periudhës romake, kryesisht shekujve II - III. Monumentet votive gjithsesi janë krijuar edhe më parë, por këto duhet të kenë qenë punuar në dru apo në ndonjë material tjetër, i cili nuk i ka bërë ballë kohës.

Mund të ketë dhe objekte të punuara nga balta e pjekur, shtatore apo pllaka relievo, që mbase do të dalin në dritë një ditë. Në territorin dardan duhet pritur edhe zbulimi i tempujve përkushtuar kësaj hyjneshe, që gjithsesi do të kenë ekzistuar. Paralajmëruet për këtë është monumenti epigrafik i Banjës së Kurshumlisë (Monum. 9) dhe tempulli i Athinës (?) tek Scupi. Së paku tempujt më të hershëm do të duhej të kishin trajtë rrethore, siç paralajmërohet nga labirinti rrethor i Smirës.

Monumentet me përkushtim për Hyjneshën Dardane

| | <i>Vendgjetja</i> | <i>Monumenti</i> | <i>Viti / shekulli</i> |
|---|-------------------|------------------|------------------------|
| 1 | Smirë | mon. Epigrafik | 211 |
| 2 | Romula Malva 1 | mon. Epigrafik | gjys. p. III |
| 3 | Romula Malva 2 | mon. Epigrafik | gjys. p. III |
| 4 | Gllamnik 1 | mon. Epigrafik | II-III |
| 5 | Gllamnik 2 | mon. Epigrafik | II-III |

Monumentet lidhur me Hyjneshën Dardane

| | <i>Vendgjetja</i> | <i>Monumenti</i> | <i>Viti / shek.</i> |
|----|-----------------------------|------------------|---------------------|
| 1 | Soçanicë (Kosovë) | monedhë | II |
| 2 | Soçanicë (Kosovë) | monedhë | II |
| 3 | Soçanicë ? (Kosovë) | Monedha | II |
| 4 | Kamenicë (Serbi) | mon. epigrafik | 140 |
| 5 | Banjë e Kurshumlisë (Serbi) | mon. epigrafik | 206 |
| 6 | Smirë (Kosovë) | mon. epigrafik | 211 |
| 7 | Gllamnik 1 (Kosovë) | mon. epigrafik | II-III |
| 8 | Gllamnik 2 (Kosovë) | mon. epigrafik | II-III |
| 9 | Banjë e Kllokotit (Kosovë) | Bust | II-III |
| 10 | Therandë/ Suharekë (Kosovë) | Shtatore | II-III |
| 11 | Romula Malva 1 (Rumani) | mon. epigrafik | gj. p. III |
| 12 | Romula Malva 2 (Rumani) | mon. epigrafik | gj. p. III |
| 13 | Branetiç i Poshtëm (Serbi) | Patelë | III |
| 14 | Lypjan (Kosovë) | mon. epigrafik | III |
| 15 | Medianë (Serbi) | Shtatore | fill. IV |




Foto 24: Vendgjetjet e monumenteve të Hyjneshës Dardane

II. SIMBOLET NË MONUMENTET E HYJNESHËS DARDANE

Simbolet janë një gjuhë e veçantë, e cila përcjell mesazhe nga e kaluara dhe, si të tilla, bëhen një shteg i mundshëm për të depërtuar në botëkuptimet e zhvilluara në hapësira dhe në kohë të ndryshme. Kjo nënkupton edhe se studimi i tyre ka vlera shumëpërfshirëse, siç është studimi voluminoz mbi simbolet tek ilirët i A. Stipčević,¹⁰¹ por edhe zbërthimi i monumenteve sepulklare nga Radusha (Bosnjë dhe Hercegovinë) nga ana e B. Gabričević.¹⁰²

Simbolet paraqiten te çdo popull si krijime autoktone, si huazime apo si adaptime të huazimeve. Edhe grekët klasikë, pasi që nuk jetonin të izoluar, huazuan ide nga të gjitha llojet e burimeve që i kishin pranë dhe më larg. Po kështu, dhe hyjnitë dhe mitet e polisit grek të periudhës klasike e kanë fillin në të kaluarën parahistorike dhe besimet dhe praktikatat tradicionale vazhduan në periudhat historike.¹⁰³

Simbolet nuk janë thjesht paraqitje dhe emërtime, por në përballje me to duhet kuptuar se prapa tyre ndodhen ide, koncepte dhe këndvështrime mbi botën. Këto prekin natyrshëm edhe ndjenjat e atyre që i krijuan dhe të atyre që i trashëguan.

Në monumentet votive të Hyjneshës Dardane janë prezente simbolet e ndryshme të kultit, që nga simboli parahistorik i edhit e deri te simboli antik i qesesë. Koha kur paraqiten këto simbole dhe shumësia e tyre janë shprehje e fazave të zhvillimit të kultit të hyjneshës dhe të sublimit të funksioneve të llojllojshme, të cilat kjo i mban.

Simbolet e paraqitura në monumentet e llojshme të Hyjneshës Dardane janë:

1. edhi (Romula Malva 1, Braneti i Poshtëm),
2. cjapi (Braneti i Poshtëm),
3. dielli (Banjë e Kllokotit, Romula Malva 1),
4. hëna /gjysmëhëna (Romula Malva 1),
5. sëpata/sëpata dytehëshe (Medianë, Braneti i Poshtëm),

¹⁰¹ Stipčević, A. (1981).

¹⁰² Gabričević, B. (1987).

¹⁰³ Dietrich, B. C. (1986) p. 41.

6. viçi (Medianë),
7. kënduesi (Romula Malva 1),
8. altari (Romula Malva 1; Braneti i Poshtëm),
9. derri faran (Medianë),
10. lerthi (Smirë),
11. spiralja (Gllamnik 2),
12. kalliri i grurit (Braneti i Poshtëm, Soçanicë),
13. hardhia e rrushit (Smirë),
14. shporta e bollëkut (Romula Malva 2),
15. svastika (Smirë),
16. qesja (Medianë),
17. kurora e qytetit (Braneti i Poshtëm),
18. nyja (Smirë),
19. labirinti (Smirë).

Në kuadër të analizës së monumenteve përkushtuar Hyjneshës Dardane dhe të atyre që supozohet se janë të lidhura me të, janë konstatuar nëntëmbëdhjetë simbole të ndryshme. Zbërthimi i tyre mundëson njohjen e funksioneve të shumta të hyjneshës, që nga fazat e hershme e deri në kohën kur ajo zhvillohet në një hyj sinkretik, me funksione të shumta dhe supreme. Përmes analizës së tyre mundësohet edhe përcaktimi i rolit të Hyjneshës Dardane në shoqërinë dardane të periudhave të caktuara, si dhe përcjellja e fazave të zhvillimit të besimit dardan në përgjithësi.

Analiza e simboleve dhe i domethënies së tyre bëhet në vijim sipas hershmërisë së paraqitjeve të tyre, gjithnjë në analogji me simbolet e ngjashme, të cilat paraqiten në kohë dhe në hapësira të ndryshme deri në periudhën antike.

1. Edhi

Edhi gjendet i vendosur në kraharorin e Hyjneshës Dardane në monumentin nga Romula Malva 1 (Monum. 2. Fot. 10, 29). Gjykuar sipas shtazës më të madhe, që duket të jetë çjap, në fund të ikonografisë nga Braneti i Poshtëm, shtaza që mban hyjnesha është edh (Monum. 7. Fot. 17, 29).



Foto 29: Edhi, Romula Malva Idhe Branetiç i Poshtëm

Simbolet e edhit dhe të dhisë janë ndër më të hershmet, pasi që ishin një nga burimet e para të ekzistencës së njeriut para prodhimeve bujqësore. Dukja e tyre shpreh njëkohësisht edhe aspektin utilitar të kulteve të hershme.

Dhia ishte shenjë sumeriane e jetës dhe më pas u bë simbol i të gjitha forcave që ndihmojnë regjenerimin biologjik të natyrës. Kështu, ajo u lidh me kultin e pëlleshmërisë, fillimisht me atë të shtazëve, dhe u pa në lidhshmëri të ngushtë me kultin e Nënës së Madhe (Magna Mater). Për këtë Nëna e Madhe te popujt e Lindjes së Lashtë u quajt edhe *loze e dhisë*.¹⁰⁴

Edhi, dhia apo cjapi u flijoheshin në fillim demonëve dhe pastaj hyjnive, të cilat duhej të mëshiroheshin që natyra të jepte fruta të nevojshme për jetë. Shtazët e flijuara, përkatësisht derdhja e gjakut të tyre në dhe mendohej se sillte regjenerimin e përgjithshëm. Pjesë e ritualit ishte dhe shpërndarja e trupit të copëtuar të shtazës nëpër

¹⁰⁴ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) Rječnik simbola, Nakladni Zavod, Zagreb, p. 360.

fusha, posaçërisht të organeve regjeneruese, për të cilat mendohej se siguronin pëlleshmërinë e dëshiruar dhe të nevojshme të natyrës. Si vazhdimësi e kultit të Nënës së Madhe shihet dhe kultu kelt i Nënës Hyjneshe.¹⁰⁵

Në Iranin e lashtë hyjnesha e pëlleshmërisë paraqitet me brirë mbi kokë, ndërsa më vonë, duke dalë në trajtë cjapi, vihet në lidhje me kultin e diellit, respektivisht lidhet me hyjninë qiellore - Diellin. Në këtë mënyrë bëhej edhe lidhja e totemit me kultin e Diellit. Lidhshmëria midis kultit të pëlleshmërisë dhe kultit të Diellit, ndeshet edhe në mitologjinë helene. Në të nimfa Amaltea, e cila në fillim paraqitet si dhi, del si bijë e Heliosit (Diellit), përkatësisht si personifikim antropomorf i dhisë.¹⁰⁶

Lidhshmëritë e dhisë me kultin e Demetrës janë po aq të hershme. Mbi këtë dhe mbi prezencën e rolin e dhisë si hyjni femërore flet edhe vendosja e bririt dhe dhisë në radhën e yjeve nga Zeusi, në shenjë mirënjohjeje që e kishte ushqyer si foshnjë (Ylli Dhija me tri kecat e saj).¹⁰⁷

Më vonë, dhinë e zëvendësoi cjapi, i cili iu flijua Zeusit dhe Hermesit, por ky ngeli në lidhje të ngushtë me kultin e Demetrës dhe të Dionisit. Më pas u bë atribut i Dionisit dhe i Afërditës, si simbol i epshit dhe i pëlleshmërisë. Ishte kjo arsye që nga shekulli VIII p.e.r. Dionisi u quajt në Lesbos edhe - *kamelios*, ndërsa pjesëmarrësit kryesor të ritualeve të kultit maskoheshin si cjep.¹⁰⁸

Për rolin e hershëm dhe të rëndësishëm të dhisë/cjapit te popujt e Europës Juglindore flet prezenca e tyre në kulturën neolitike të Vinçës, në të cilën duken në trajtë terakotash apo si aplikacione enësh.¹⁰⁹

Cjapi është mjaft prezent si simbol kultu autokton në besimin ilir, i dëshmuar deri më tash kryesisht në lidhshmëri me hyjnitë Bind dhe Vidas. Cjapi paraqitet si simbol i Bindit dhe është shtazë e hershme kultu, që i flijohej këtij hyji të burimeve dhe të ujërave.

¹⁰⁵ Green, M. (1989) *Symbol and Image in Celtic Religious Art*, Routledge, London and New York, pp. 9 - 10.

¹⁰⁶ Dhama, T. (1988) *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, f. 29, f. 56.

¹⁰⁷ Dhama, T. (1988) f. 29, f. 56.

¹⁰⁸ Satiri/pani ishte përcjellës në kultin e Dionisit. Te helenët quhej *he tragoi*: cjap: Preller, L.– Robert, C. (1894) *Griechische Mythologie*, Weidmannsche Buchhandlung, Berlin, p. 380.

¹⁰⁹ Vasić, M. (1936) *Preistorijska Vinča III*, Državna štamparija Kraljevine Jugoslavije, Beograd, T. CXXX, Fig. 604 b.

Ndonëse Bindi është identifikuar shpesh me Neptunin romak, ky kishte funksion edhe pëlleshmërinë, për ç'gjë flet flijimi i cjapit dhe i gjedheve.

Cjapi është dëshmuar në aspektin arkeologjik edhe në tempullin e hyjnisë ilire Binit, në Privilice afër Bihaqit.¹¹⁰ Në monumentin votiv të tempullit të Privilices janë gdhendur tre cjep, dy gjenden në pozitë heraldike para altarit (pjesa e epërme) dhe një nën fushën mbishkrimore. Në monument është trajtuar një traditë ilire parahistorike, prezente para pushtimeve romake, që dëshmohet me emrin ilir të hyjnisë, emrin e dedikantit dhe emrin e japodëve, fisit të cilit i përkiste dedikanti.¹¹¹



*Foto 30: Cjapi dhe Silvani,
Duvanjsko - Pole (D. Rendić-Miočević 1989)*

¹¹⁰ Stipčević, A. (1981) f. 109, pp. 171 - 172.

¹¹¹ Cambi, N. (2013) *Romanization of the western Illyricum from religious point of view*, Godišnjak Centra za Balkanološka Ispitivanja 42, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosnje i Hercegovine, Sarajevo, p. 75, Fig. 6; Stipčević, A. (1981) f. 109, pp. 171 - 172.

Cjapi i është flijuar edhe Vidasit, hyjnisë ilire të pyjeve dhe të kullsave. Përderisa në kuptimin ikonografik ky nuk është dalluar nga Pani helen apo Fauni/Silvani romak, në aspektin e funksioneve ka luajtur rol më të rëndësishëm në besimin ilir,¹¹² siç është rasti edhe me Bindin në krahasim me hyjnitë e përmendura helene dhe romake. Figura e cjapit, e vendosur pranë Silvanit, u gjet i gdhendur në një shkëmb pranë lokalitetit Duvansko-Pole, territor po ashtu ilir (Fot. 24).¹¹³

Gurat e cjepeve prej bronzi duken shpesh si dhurata ktonike, siç janë ato nga varret në Trebenishtë dhe në Gjevgjeli të shekullit VI p.e.r..¹¹⁴ Periudhës urbane dardane, pra para pushtimeve romake, i takon gjetja e rastit të cjapit pranë Prizrenit (Fot. 31),¹¹⁵ ndërsa periudhës romake i takojnë ato të zbuluara në Ohër (shek. II – III) dhe Mitrovicë të Sremit (Sirmium, shek. I – II).

Respektimi i cjapit u ruajt deri vonë edhe në traditën shqiptare. Kështu, në Kanunin e Lekë Dukagjinit cjapi apo cjapi mbarsës – ugiçi, konsiderohet si shtazë e parë e çmuar, e cila nuk bën të preket. Bririn e cjapit e mbante në helmetë edhe mbreti epirot Pirro.¹¹⁶



Foto 31: Cjapi i Prizrenit (Vranjski Muzej, Serbi)

¹¹² Stipčević, A. (1981) p. 172.

¹¹³ Rendić-Miočević, D. (1967) T. LXIX.

¹¹⁴ Filov, B. (1927) Die archaische Nekropole von Trebenishte am Ochrid, Berlin und Leipzig, p. 53.

¹¹⁵ Shih: Vukanović, T. (1973) *Neolithic Terra-Cotta Cocks from Kosovo*, Vranjski Glasnik, Vranje, pp. 1 - 43, Pl. O-III; Stipčević, A. (1981) p. 125, p. 177. Dimensionet e figurës: 6,5 x 6,5 x 3cm, pesha 0.380gr.

¹¹⁶ Plutarchi, Vitae paralelae: Pyrrhus, 10; 11.

Mbështetur në analogjitë e parashtruara, edhe në kraharor të Hyjneshës Dardane (Monum. 2. Fot. 10) shpreh lidhshmërinë e ngushtë me traditën e hershme parahistorike të kultit të dhisë, të pëlleshmërisë dhe të regjenerimit të natyrës. Edhi ishte dhe shtazë flijimi në kultin e kësaj hyjneshe, siç ishte çjapi në kultin e Bindit apo të Vidasit.

2. Dielli

Simboli i Diellit paraqitet në forma të ndryshme në monumentet e Hyjneshës Dardane të Smirës (Monum. 1. Fot. 3), Banjë e Kllokotit (Monum. 13. Fot. 26) dhe Therandës/Suharekës (Monum. 14. Fot. 27). Ky paraqitet në trajtë rrethi të thjeshtë e deri te labirinti.

Rrethi apo disku paraqitet si simbol i diellit kudo dhe në çdo kohë dhe bëhet më i dukshëm, nëse shoqërohet nga rrezet.¹¹⁷ Simboli lidhet me kultin solar, i cili ishte më i rrallë gjatë epokës së neolitit. Nga fillimi i kohës së metaleve u shpeshuan paraqitjet e skematizuara të kultit të diellit, ndërsa gjatë epokës së bronzit në Europë dominoi heliolatria dhe u krijua miti mbi qerren diellore dhe Hyjin diellor. Këto u personifikuan në terakota, si figura të veçanta apo të vendosura në qerre, të cilat i drejtonin shpezët, po ashtu simbole të kultit të diellit.

Në Europën Juglindore kulti u manifestua në veçanti në kulturën e Vuçedollit (Kroaci),¹¹⁸ ndërsa ekzemplari më i njohur është Qerrja e Dupljajës (Serbi. Epoka e bronzit të mesëm. Fot. 34).¹¹⁹ Refleksion i mëvonshëm i kultit të diellit duket në plastikën e imët të epokës së hekurit, me paraqitjen e diskut diellor, të objekteve në trajtë kryqi apo të shpezëve. Objektet u vendosën në varre dhe funksioni i tyre ishte që ta ndihmonin shpirtin e të vdekurit në udhëtimin për në botën e përtejme. Të tilla janë disqet prej bronzit të varrit 3 të tumës së Shirokës (Fot. 60),¹²⁰ ato nga varret etrurë të shekujve VIII-VII, si dhe ato nga Sllovenia, Gjermania apo Franca.¹²¹

¹¹⁷ Cirlot, J. (1971) *A Dictionary of Symbols*, Philosophical Library, New York, p. 47.

¹¹⁸ Tasić, N. – Dimitrijević, S. – Jović, B. (1979) *Praistorija Jugoslavenskih Zemalja*, Sarajevo, p. 458; Stipčević, A. (1981) p. 158.

¹¹⁹ Čović, B. (1983) *Praistorija Jugoslavenskih Zemalja*, Svjetlost, Sarajevo, p. 820.

¹²⁰ N. Slavković-Djurić i quan *pulla*: Slavković-Djurić, N. (1968) *Ilirski tumuli kod S. Reke*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IX, Priština, p. 539; M. Green i sheh si *rrota*: Green, M. (1984) apo si *kopsa* në Katalog arkeologjik të Kosovës (2013) f. 145.

¹²¹ Dechelette, J. (1927) *Premier Âge du Fer ou époque du halsstatt*, Éditions Eduard Picard, Paris, pp. 287 - 292.

Monumentet më të hershme në Kosovë, që kanë si varëse të qafores simbolin e diellit, janë ai i Hyjneshtës në fron (Fot. 89), i terakotave të ulura nga lokaliteti i Bardhoshit dhe të tjerave të ngjashme.¹²² Këtij grupi do të duhej t'i takonte dhe figura e hyjnisë nga Poneshi, e cila në gjoks e ka të gdhendur diellin me gjashtë rremba. Me këtë simbol, si dhe me gojën e hapur, figura përmban elemente të panjohura dhe mjaft të rëndësishme, nëse dëshmohet autenticiteti i saj (Fot. 33).¹²³

Simbole të diellit janë dhe sëpatat, në veçanti ato dytehëshe (labris). Dy të tilla janë vendosur në varret 1 dhe 17 të Tumës 1 të Romajës (Fot. 35). Sëpata dytehëshe paraqitet edhe si varëse në Gradinën e Gadimes së Epërme,¹²⁴ ndërsa më pas duket si simbol përcjellës i Hyjneshtës nga Mediana (Fot. 16).¹²⁵

Me kultin solar lidhen pjesët e skeprtit të epokës së hekurit, të tumës II të Llashticës,¹²⁶ si dhe arkitektura e tumave ilire e dardane e epokës së hekurit, bashkë me unazat rrethore. Kontinuiteti i kultit të diellit në shekullin II duket më i qartë te peonet, fqinjë të dardanëve, si te të dhënat arkeologjike, ashtu edhe në shënimet e autorëve antikë.¹²⁷

Pllaka rrethore prej bronzi, me dukje të ngjashme si kompozicioni autokton qendror i monumentit të Hyjneshtës Dardane nga Smira, janë gjetur në Vranjë dhe në lokalitetin Maqedonci dhe këto shprehin paraqitjen e kultit post-diellor.¹²⁸

Në monumentin e Hyjneshtës Dardane nga Smira simbolet e diellit nuk janë të thjeshta (Monum. 1. Fot. 5), siç ndeshen me një apo disa rrathë në arat me përkushtim Jupiterit dhe, më rrallë, Cererës.¹²⁹

¹²² Katalog arkeologjik (2013) f. 41, Fot. 38; 40, Fot. 37; f. 45, Fot. 44.

¹²³ Dyshimi bazohet në faktin se që nga paslufta në Kosovë (1999) janë bërë shumë gërmime klandestine.

¹²⁴ Katalog arkeologjik (2013) f. 153, Fot. 202.

¹²⁵ Jovanović, A. (1980) pp. 53 – 60.

¹²⁶ Dy shpezë duket se janë vendosur në një objekt të zgjatur me protome shpezësh: Vasić, N. (1981) Gvozdeno doba V, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, Sarajevo, p. 684.

¹²⁷ Stipčević, A. (1981) f. 17, f. 33, f.n. 2.

¹²⁸ Vasić, N. (1981) p. 684, T. LXX, 10.

¹²⁹ May, J. (1939) The coinage of Damastion and the lesser Coinages of the Illyro-Paeonian Region, Oxford University Press, H. Milford, London, Fig. 501- 502, 527.




Foto 32: Disku solar në qaforet e hyjneshës nga Banja e Kllokotit dhe nga Theranda (Suhareka)



Foto 33: Terakota nga Poneshi (gjetje rasti)

Simboli i diellit nga Smira, i vendosur në qendër të labirintit rrethor, është më kompleks dhe i tejkalon suazat e prezantimit të një kulti parahistorik të Diellit, pasi që ky zë sferat e paraqitjes së vetë universit. Si shprehje e kultit parahistorik solar, në shoqërim me simbolet e tjera, monumenti shpreh njëkohësisht kompleksitetin e funksioneve të hyjneshës dhe të shkallës më të lartë të zhvillimit të besimit dardan.

Kulti i diellit mbijetoi edhe në trojet shqiptare nga fazat pagane përmes nderimit të majave të larta dhe faljeve të diellit e deri te betimet e ndryshme të popullatës, përkundër përhapjes së krishterimit dhe islamizmit: *Për atë diell! Pasha këtë diell! Për këtë rreze dielli! Për atë diell, qiell e tok'!*

Pelegrinazhe në maja, falja e diellit, ndezja e zjarreve, flijimet e shtazëve dhe lojërat e tjera ceremoniale ishin traditë në Malin Rumi (Mal i Zi. Mbi liqenin e Shkodrës) në ditën e Rushajave, Majë Pashtrikut (Kosovë), Gjallicë të Lumës, Shkëlzen të Tropojës apo Majën e Shëlbuemit afër Lezhës (Shqipëri).¹³⁰ Edhe në Marec (Kosovë) vendësit dalin natën majë kodre dhe ndezin zjarre duke pritur agimin, ndërsa të rinjtë shqiptarë të Anamalit, në Mal të Zi, bartin gurë deri në majë të malit dhe i vendosin aty që të rritet maja e malit dhe të jetë sa më afër diellit. Këto, pos veprimeve të tjera, përcillen edhe me rituale/lojëra të hedhjes së gurëve.¹³¹



Foto 34: *Qerrja e Dupljajës* (Nacionalni muzej, Beograd)

¹³⁰ Tirtja, M. (2004) Etnologjia ndër shqiptarë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, ff, 410 - 413; Për këtë shkruan dhe Franz Noptza në *Shqipëria. Pikëpamjet fetare* (46), Edith Durham apo Vaso Pasha Effendia (1935): E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët, Tiranë, 42 - 43.

¹³¹ Shukriu, E. (1989) *Kulti i Diellit te dardanët*, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Instituti Albanologjik, Prishtinë, ff. 103 - 112.

3. Hëna

Hëna si gjysmëhënë (trajtë semilunare) është paraqitur në monumentin e Romula Malvës (Fot. 9). Simboli është vendosur mbi kokën e hyjneshës, në kornizën e epërme të monumentit.

Cikli lunar mendohet të jetë cikli i parë i evidencuar nga njeriu dhe se është forma më e vjetër astrologjike e popujve të hershëm (astrologjia agrikulturore).

Simboli i hënës del si rezultat i përcjelljes së njeriut parahistorik të ciklit 13-mujor të hënës dhe të ciklit 13-mujor menstrual, cikle këto që lidhen me kultin e hershëm të Nënës së Madhe (Magna Mater).¹³² Hëna lidhet me gjininë femërore dhe mendohej të ishte mbrojtëse e femrës edhe në kultet shqiptare.¹³³

4. Sëpata - sëpata dytehëshe

Sëpata si simbol gjendet në dorëzën e paterës nga Branetiçi i Poshtëm (Fot. 18) dhe si sëpatë dytehëshe (labris) në shtatoren e Medianës (Fot. 16). Në të dy rastet simbolet janë vendosur në horizontet e poshtme: sëpata e paterës së Branetiçit të Poshtëm gjendet në anën e djathtë të altarit, ndërsa sëpata dytehëshe gjendet mbi kokën e derrit faran dhe pranë këmbës së majtë të hyjneshës. Pasi që sëpata simbolizon edhe vdekjen (të urdhëruar nga hyjnia),¹³⁴ prezenca e saj e lidh me kultin e të vdekurve.

Prezenca e labrisit shpreh lidhshmërinë e Hyjneshës Dardane me kultin e diellit, ndërsa e vendosur mbi kokën e derrit në shtatoren e Medianës, përforcon lidhshmërinë e funksioneve të hyjneshës me botën e të vdekurve, rrjedhimisht edhe me ringjalljen dhe përjetësinë.

Labrisi simbolizon Diellin dhe paraqitet edhe si atribut bashkë me të, si shprehje e karakterit dualistik të Diellit: të ndritshmërisë dhe të errësirës. Kështu, me të shprehet zgjidhja pozitive e dualitetit: dy tehet e sëpatës paraqesin idenë e materializuar të skajshmërive, të cilat i gërsheton çdo dualizëm. Si i tillë duket si instrument sakral në kulte dhe është shpesh shprehje e pushtetit suprem të hyjnive antropomorfe.

Labrisi gjendet gjatë epokës së bronzit edhe në Kretën minoike, ku

¹³² Stipčević, A. (1981) p. 101 dhe literatura.

¹³³ Tirtja, M. (2004) f. 412.

¹³⁴ Cirlot, J. (1971) p. 22.

simbolizonte ndritshmërinë.¹³⁵ Është dëshmuar në modelet e sëpatave prej bronzi të shekullit X p.e.r. dhe u është ofruar tempujve të Zeusit në Dodonë dhe në Olimpi.¹³⁶

Sëpata simbolizonte hyjnitë rrufehedhëse, zotuesit e shtrëngatave dhe zotin suprem, siç ishin Zeusi rrufehedhës, Baali oriental apo Doliheni dhe Zeusi-Hadad.¹³⁷ Si simbol gjendet edhe në duart e të ashtuquajturve *disk-njeri* (*disc-man*), figura meshkujsh të cilët pjesët vitale të trupit kishin trajtë të diskut diellor.¹³⁸ Sëpatat e shumta të epokës së vonë të bronzit në Europë mbajnë motive diellore, përfshirë edhe svastikën.

Labrisi si simbol i hyjneshës nga Mediana e vë këtë në lidhshmëri më të hershme me dardanët se nga koha e pushtimeve romake. Këtë e dëshmon prezenca e labriseve në varret e epokës së hekurit në varret 1 dhe 17 të tumës I të Romajës (Fot. 35),¹³⁹ në Shirokë¹⁴⁰ apo në Vojnik të Kumanovës.¹⁴¹ K. Kilian konsideron se këto flasin mbi lidhjet e hershme me botën helene.¹⁴²




Foto 35: Sëpatat dytehëshe nga tuma I e Romajës
(Kosovë. Romaja parahistorike 1974)

¹³⁵ Ferguson, J. (1989) p. 6.

¹³⁶ Ferguson, J. (1989) p. 26.

¹³⁷ Green, M. (1989) p. 53.

¹³⁸ Green, M. (1989) *Simbol and Image in Celtic Religious Art*, Routledge, London and New York, pp. 80 - 81, Fig. 62.

¹³⁹ Djurić, N. - Glišić, J. - Todorović, J. (1975) *Prehistorijska Romaja*, Zavod za zaštitu kulturnih spomenika i prirode – Arheološko Društvo Jugoslavije, Prizren – Beograd, p. 36, Tab. I 1, Tab. XV 2.

¹⁴⁰ Djurić, N. - Glišić, J. - Todorović, J. (1975) p. 75. Tab, XVII, Fot. 1; Stipčević, A. (1981) p. 98.

¹⁴¹ Kilian, K. (1975) *Trachtzubehör der Eisenzeit zwischen Ägäis und Adria*, De Gruyter, Berlin p. 81, T. 53, 1 - 3.

¹⁴² Kilian, K. (1970) T. 64, 6.

Paraqitjen e labrisit në epokën e hekurit duhet parë në lidhshmëri me labirintin rrethor dardan të Smirës. Është fjala për zhvillimin e konceptit të labrisit deri te labirinti dardan, i cili sjell kuptim më të thellë religjioz të njohurit sublim, të fuqisë dhe të përjetshmërisë. Mendimi i tillë mbështetet dhe në studimet e labrisit të E. Mircea, e cila e sheh labrisin si përkthim të kuptimit simbolik të labirintit.¹⁴³

5. Viçi

Simboli i viçit paraqitet në shtatoren e Medianës (Mon. 6. Fot. 16, 36). Viçi është në ndërlidhshmëri me kultin e lopës dhe të kaut, të cilat kanë prejardhje tejet të hershme. Simbolet e tyre bartin në vete parimin e pëlleshmërisë, të lidhur me kultin e hershëm të Nënës së Madhe (Magna Mater). Për shkak të brirëve të theksuar paraqiten si simbol i hënës, element ky që përshtatet me ciklin 13-mujor të hënës dhe me ciklin 13-mujor menstrual.¹⁴⁴ Kështu është bërë ndërlidhja me principin femëror që nga shoqëritë para-patriarkale. Andaj edhe hyjnesha Hator, pjesë e mitologjisë paradinastike egjiptiane, paraqitet gjithnjë me brirë.¹⁴⁵

Më pas, kau u bë shtazë shumë e adhuruar në kulturën e epokës së bronzit të Kretës. Ka mendime se edhe mbreti legjendar i Kretës, mbreti Minos, ishte në fillim ka.¹⁴⁶



Foto 36: Viçi në shtatoren e Medianës

¹⁴³ Mircea, E. (1964) *Traite d'histoire des religions*, Payot, Paris, p. 312.

¹⁴⁴ Stipčević, A. (1981) p. 101 dhe literatura.

¹⁴⁵ Oxford Guide (2003) pp. 157 - 161.

¹⁴⁶ Jaskolsky, H. (1997) *The Labyrinth, Symbols of Fear, Rebirth and Liberation*, Shambhala, Boston & London, p. 38.



Foto 37: Kënduesi, Romula Malva 2

6. Kënduesi

Kënduesi gjendet në monumentin e Romula Malvës (Fot. 9, 37). Është vendosur mbi altar në pjesën e poshtme të anës së majtë të Hyjneshës Dardane.

Kënduesi është simbol i diellit dhe si shpend i tokës lidhet edhe me simbolikën ktonike.¹⁴⁷ Te shumë popuj paraqitet edhe si apotropeion, mbrojtës i njeriut nga demonët e natës dhe nga rreziqet e tjera.¹⁴⁸ Në Ballkan është dëshmuar më shumë te ilirët e veriut, rrjedhimisht në kompleksin kulturor të Alpeve lindore, te histrët dhe japodët.¹⁴⁹

Kënduesi është prezent më shpesh në amulete (varëse prej bronzi), si mbrojtës nga fatkeqësitë e ndryshme. Është paraqitur edhe mbi urnat e pjesëve juglindore të Alpeve, te latobijtë parahistorikë. P. Petru e sheh këtë paraqitje tek ilirët si ndikim kelt, por A. Stipčević provon autoktoninë e kultit të përhapur në trojet parahistorike ilire para dyndjeve kelte. Ai e sheh simbolin e kënduesit si mbrojtje nga fatkeqësitë, nga keq, nga syri i demonët e këqij dhe në funksion të qetësisë së të vdekurve.¹⁵⁰

Figura më e hershme e kënduesit në trojet dardane është figura realiste nga Fafosi i Mitrovicës (Kosovë).¹⁵¹ Pasi që kënduesi i Fafosit i takon epokës së neolitit, mund të thuhet se kulti i kënduesit ishte prezent shumë kohë para dyndjeve kelte. Kjo tregon edhe se kultin e kënduesit nuk duhet parë vetëm me prejardhje nga Mesopotamia dhe se arriti në Greqi tek në shek. VII-VI p.e.r..

¹⁴⁷ Cirlot, J. (1971) p. 51.

¹⁴⁸ Sipas besimit të popujve të ndryshëm, këndimi në orët e hershme të mëngjesit i dëbon demonët e natës, andaj edhe vendoset në kulme të shtëpive.

¹⁴⁹ Stipčević, A. (1981) p. 66, pp. 68 - 69: Kënduesi i paraqitur me xhufkë e qerre mban në vete simbolizmin e rrugëtimit diellor.

¹⁵⁰ Stipčević, A. (1981) p. 171.

¹⁵¹ Vukanović, T. (1971) Fig. 1.

Figura e kënduesit paraqitet edhe në reverset e monedhave të shekujve V - IV të qytetit Dardanus në Trojadë,¹⁵² gjë që shtron çështjen e përhapjes së këtij kulti, si dhe përcaktimin e lidhshmërive midis dardanëve europianë dhe atyre të Trojadës.

Kënduesi nga Fafosi parahistorik dhe paraqitja e tij pranë shtatores së hyjneshës në antikë (Monum. 2), provojnë vazhdimësinë e traditës së hershme të kultit të kënduesit në trojet dardane. Këto paraqitje dëshmojnë, po ashtu, për një shtrirje më të gjerë të kultit të kënduesit tek ilirët, dhe jo vetëm tek ilirët e veriut, siç ishin latobijtë, histrët dhe japodët.

Prezenca e kënduesit pranë Hyjneshës Dardane, si edhe në rastet e tjera, shihet në funksionin e tij apotropeik, në veçanti si mbrojtës i qetësisë së të vdekurve. Në këtë rast mbase duhet pasur parasysh edhe simbolizmin e tij lidhur me rrugëtimin diellor kur krahasohet me funksionin e psikopompit mortal të hyjneshës, siç mund të përfundohet nga monumenti i Smirës.

7. Altari

Altari paraqitet si simbol në dorëzën e patelës nga Branetiqi i Poshtëm, ku gjendet si simbol i veçantë (Fot. 17, 31) dhe në monumentin e Romula Malvës 2, mbi të cilin është vendosur kënduesi (Fot. 9, 38).

Altarët konsiderohen vende ku zhvilloheshin sakrilegjet dhe ku mendohej se takoheshin njeriu dhe hyjnia. Fillimisht janë bërë prej dheu dhe më pas prej guri. Vendoseshin kryesisht para tempujve, ndërsa gjatë periudhës helenistike u zhvilluan në konstruksione të pavarura monumentale.¹⁵³



Foto 38: Altarët nga Branetiqi i Poshtëm dhe Romula Malva 2

¹⁵² Sylloge nummorum Graecorum (1945) T. 7.

¹⁵³ Ferguson, J. (1989) p. 33.

8. Derri faran

Derri faran është atribut përcjellës në shtatoren e Hyjneshës Dardane nga Mediana (Monum. 6. Fot. 16, 39).

Derri, duke qenë shtazë që lëviz shpejt dhe me cak, është konsideruar simbol i shëndetit, i përparimit dhe i fatit, por është parë dhe në lidhshmëri të ngushtë me vdekjen. Vdekja ishte ndër shqetësimet kryesore për besimet e ndryshme, andaj i kushtohej vëmendje e veçantë, sidomos nëse e rrezikonte shpirtin e njeriut, siç ishte rasti me derrin.

Derri u sakrifikohej hyjnive, duke pasur parasysh edhe se përmbante elemente demoniane. Elementet demoniane të derrit u panë edhe për shkak se është ndër shtazë të rralla, që i ha fëmijët e vet. Kjo dhe elementet e tjera bënë që derri të shihej si *shtazë e vdekjes*.¹⁵⁴



Foto 39: Derri me labrisin në shtatoren e Medianës

Në Egjiptin e lashtë, derrat ishin të lidhur me hyjin Set, rival i Hyjit të Diellit Hor. Derrat i janë sakrifikuar edhe Ozirisit gjatë festivalit vjetor të korrijes, megjithëkëtë prekja e derrit lidhej me papastërtinë dhe rojeve të derrave u ndalohej edhe hyrja në tempujt e Egjiptit të vjetër. Ndërkaq, derrat iu flijuan Ozirisit dhe Hënës një herë në vit dhe në atë kohë ngrënia e mishit të freskët të tyre,

¹⁵⁴ Graves, R. (1969) *White Goddess*, The Noonday Press, p. 210.

lejohej.¹⁵⁵ Derrat i ofroheshin edhe Dionisit, në ditën e hënës së plotë.

Derri në Europë ishte në mesin e shtazëve që u flijoheshin hyjnive në parahistori, me renditjen kohore vijuese: gjarpri, derri, demi dhe, më pas, kali.¹⁵⁶ Keltët respektonin hyjninë e derrat, të quajtur Moccus, i cili u identifikua me Merkurin në periudhën romake. Hyji kelt i detit, Manannani, mbante tufë magjike të derrave, e cila regjenerohej sa herë që hahej ndonjë prej tyre. Nga kjo është nxjerrë përfundimi se derri ishte edhe simbol i regjenerimit, siç dëshmohet edhe nga mitologjia kelte e quajtur *Banketi i Moshës i Manannanit*, në të cilin hyjnitë fitonin cilësi ripërtëritëse të derrave për të mos u plakur.

Derrat u konsideruan edhe hyjni, madje paramendohej se Ozirisi, Atisi, Adonisi, Demetra dhe vajza e saj, Persefona, kanë qenë më parë derra. E tillë konsiderohej dhe hyjnesha kelte e hardhisë së rrushit Karidven.¹⁵⁷

Sipas M. Georges, misteri i kultit të Demetrës dhe vajzës së saj, Persefonës, është mbase mbi 16.000 vjet i vjetër, andaj duket se koncepti i hyjneshës si derr ka mundur ndërkohë të zhduket në kohët historike.¹⁵⁸

Kultin e hershëm të derrat e dëshmojnë terakotat e derrat të epokës së neolitit të zbuluara afër Maratonës (Greqi), ndërsa në More (Peloponez, Greqi) dhe Kamarina të Sicilisë janë zbuluar shumë terakota që e paraqesin Demetrën me derr.¹⁵⁹

Të dhënat mitologjike thonë se Demetra i dha më pas Triptolemit njohuri mbi rritjen e grurit dhe e dërgoi ta shpërndante këtë në botë.¹⁶⁰ Sakrifikimi i derrat praktikohet edhe nga romakët e vjetër gjatë aktit më solemn të besimit romak, të njohur me emrin *suovetaurilia*.

Në territorin ilir derri faran është konstatuar nga shekulli VI p.e.r., me gjetjet në Atenicë të Čačakut (Serbi), në Zagragjë të Glasinacit (Bosnjë dhe Hercegovinë) apo në urnën e Ribičit.¹⁶¹

¹⁵⁵ Frazer, J. (1911) *The Golden Bough*, Macmillan, London, p. 548.

¹⁵⁶ Campbell, J. (1964) *Occidental Mythology*, Viking, New York, p. 154.

¹⁵⁷ Frazer, J. (1911) p. 554.

¹⁵⁸ Mylonas, G. (1961) *Eleusis and the Eleusinian Mysteries*, Princeton University Press, Princeton, p. 14.

¹⁵⁹ Ferguson, J. (1989) p. 20.

¹⁶⁰ Mylonas G. (1961) p. 14.

¹⁶¹ Djuknić, M. - Jovanović, B. (1965) *Ilirska kneževska nekropola u Atenici, Narodni muzej, Čačak*.

9. Kalliri i grurit

Kalliri i grurit paraqitet në figurën e Hyjneshës Dardane të dorëzës së patelës nga Branetiçi i Poshtëm (Monum. 7. Fot. 17). Kallirin e grurit e mban në dorën e djathtë edhe figura e hyjneshës në monedhat me mbishkrim *dardanici* (Fot. 20, 22-25).



Foto 40: Kalliri i grurit, Branetiçi i Poshtëm dhe monedha me mbishkrim *dardanici*

Kalliri i grurit del më së shpeshti si atribut përcjellës i hyjneshës Demetra. Në Eleusinë, ku Demetra kishte mbetur e maskuar deri në lirim të vajzës së saj, Persefonës, u krijua kulti i saj. Ajo ia mësoi Triptolemit të Eleuzinës njohuritë e kultivimit të grurit dhe e dërgoi jashtë që ta mësonte për këtë botën. Mendohet se misteri i kultit të Demetrës dhe i vajzës së saj daton rreth vitit 14.000 p.e.r..¹⁶²

10. Lerthi

Lerthi (lat. heder) gjendet në monumentin e Smirës dhe është pjesë përbërëse e kompozicionit me labirintin rrethor (Monum. 1. Fot. 5, 41), si dhe në fundin e kapitelit të monumentit Gllamnik 2. (Monum. 4. Fot. 15, 41).

Lerthi, bimë përherë e gjelbëruar, u bë simbol i përhapur, që simbolizonte fuqinë e përhershme bimore dhe, më vonë, qarkun e përhershëm të vdekjes dhe të lindjes, rrjedhimisht mitin e kthimit të përhershëm.

¹⁶² Mylonas, G. (1961) p. 14.



Foto 41: Lerthi dhe nyja nga Smira

Te popujt e Lindjes së Afërme lerthi i përkushtohet hyjit Atis, në të cilin u dashurua Kibela, hyjnesha agrare e tokës dhe e korrjes.¹⁶³

Lerthi, bashkë me hardhinë, ishin atribut përcjellës i Dionisit dhe i Bahut. Sipas mitologjisë, Dionisi përdorte lerthin dhe hardhinë e rrushit që t'i sillte në gjendje mistike gratë, të cilat nuk e përqafonin kultin e tij. Edhe terakotat nga Tanagra janë stolitur me gjethe lerthi dhe bathëza, për të cilat mendohej se siguronin mbrojtjen e Perëndisë.¹⁶⁴

Lerthi, si edhe hardhia e rrushit, janë simbole karakteristike të monumenteve mbivarrore dardane të periudhës romake. Të dyja bashkë ose të ndara u bënë simbole karakteristike të monumenteve sepulkrale të Dardanisë gjatë periudhës romake,¹⁶⁵ gjithsesi të trashëguara nga antika dardane nga shek. IV p.e.r., nëse jo nga periudha parahistorike.

Lerthi duket si ornament edhe në enët dardane të punuara në çark të shekujve V-IV.¹⁶⁶ Prezenca në monumentin e Hyjneshës Dardane nga Smira edhe këtë simbol e nxjerr nga rrethi i ngushtë i kultit të të vdekurve dhe e vë në funksion të rilindjes dhe të njohurit sublim.

¹⁶³ Chevalier, J.–Gheerbrant, A. (1983) p. 65.

¹⁶⁴ Chevalier, J.–Gheerbrant, A. (1983) p. 65.

¹⁶⁵ Dobruna-Salihu, E. (2005) ff. 139 - 143.

¹⁶⁶ Shukriu, E. (1996) f. 92.

11. Spiralja

Spiralja si simbol paraqitet në monumentin e Hyjneshës Dardane nga Gllamniku 2 (Monum. 5. Fot. 15, 42). Spiralet janë vendosur në kapitelin e monumentit dhe kanë drejtime të kundërta, duke simbolizuar në këtë mënyrë lindjen, vdekjen dhe ringjalljen. Dekorimi i ruajtur i kapitelit lejon supozimin se një spirale e madhe dyshe ka qëndruar në mes, si motiv kryesor, dhe mbi të gjendej dega me nga katër spirale.



Foto 42: Spiralet në kapitelin e monumentit Gllamnik 2

Spiralja, një rreth që vazhdimisht sillet rreth vetes dhe nuk përfundon, ishte simbol i hershëm shpirtëror i rritës dhe i evolucionit. Më vonë lidhet me idenë e vdekjes dhe të ringjalljes dhe, si e tillë, siç pohon dhe J. Campbell, bëhet imazh i përbashkët i pavdekshmërisë.¹⁶⁷ Duke qenë imazh skematik i evolucionit të universit, mendohet se është formë klasike e simbolizimit të orbitës së Hënës.¹⁶⁸ E përhapur kudo si simbol, gjendet edhe në tempujt megalitikë të Maltës, si spirale treshe dhe simbol para-kelt,¹⁶⁹ në vazot mikenase apo në mburojat e luftëtarëve të vazove greke.¹⁷⁰

Vetëm në territorin e Kosovës spiralja paraqitet që nga epoka e neolitit,¹⁷¹ pastaj përmes 17 spiraleve të dukshme në artin parahistorik të

¹⁶⁷ Campbell, J. (1965) *The Masks of God*, vol. 4, *Creative Mythology*, Viking, New York, f. 446.

¹⁶⁸ Cirlot, J. (1971) f. 305.

¹⁶⁹ Murphy, A. - Moore, R. (2008) *Island of the Setting Sun: In Search of Ireland's Ancient Astronomers* (2nd ed.), The Liffey Press, Dublin, pp. 168 - 169.

¹⁷⁰ Boardman, J. - Griffin, J. - Murray, O. (1988) *The Oxford History of the Greece and the Hellenistic World*, Oxford University Press, Oxford, p. 50.

¹⁷¹ Galović, R. (1959) T. 66 3, 5, 6; T. 67 1; T. 68 1, 4; *Katalog arkeologjik* (2013) f. 25, Fot. 16; 57, Fot. 60.

Vlashnjës, për t'u bërë një ndër simbolet më të shpeshta gjatë epokës së hekurit. Shfaqet sidomos në fibulat gjyslykore të vendosura në varre, traditë kjo e kulturës së Gllasinacit dhe e variantit të tij Mat - Gllasinac.¹⁷²



Foto 43: Spiralet, kupa e Runikut (mijëvjeç. VII-VI. Muzeu i Kosovës)

12. Hardhia e rrushit

Hardhia e rrushit gjendet si simbol mbi kompozicionin e labirintit rrethor të qarkut të mbyllur në monumentin nga Smira (Monum. 1. Fot. 8, 44).

Kultivimi i hardhisë së rrushit konsiderohet si një nivel më i lartë i prodhimitarisë, madje për kultivimin e tij duhet pasur përvojë të gjatë dhe dije, pos mundit fizik. Ishin këto arsye që në lashtësi shihej si pasuri më e çmueshme e njeriut. I dalë si simbol i pronës, ky simbol paraqet sigurimin e jetës dhe atë që jetën e bën të vlefshme.¹⁷³

Në religjionet e Palestinës së vjetër hardhia e rrushit ishte bimë e shenjtë, ndërsa prodhimi i saj, vera, pije hyjnore. Kështu, gjethi i hardhisë u bë simbol i jetës, ndërsa kalaveshi i rrushit, nga i cili prodhohet vera dhe që duket si gjaku, u bë simbol i ujit të jetës dhe i përjetshmërisë. Hardhia është prodhim më i vonë se gruri, i cili ishte simbol i Demetrës, hyjneshës së hershme të dheut (tokës).

Hardhia u bë simbol i Dionisit, kulti i të cilit kishte për qëllim të

¹⁷² Shukriu, E. (1996) dhe literatura.

¹⁷³ Chevalier, J. – Gheerbrant, A. (1983) p. 354.

njohurit e jetës sekrete pas vdekjes. Lidhshmëria e Dionisit me misticizmin e vdekjes, që është dhe misticizëm i rilindjes dhe i të njohurit sublim, bën që hardhia të duket shpesh edhe si simbol në monumentet mbivarrore.¹⁷⁴ Si e tillë, u bë simbol karakteristik i monumenteve mbivarrore dardane të periudhës romake, por duket i tillë ka qenë edhe para dominimit romak, por i punuar në materiale të cilat nuk i kanë rezistuar kohës.¹⁷⁵

Nga prezenca e hardhisë së rrushit në monumentet mbivarrore dardane të periudhës romake mund të nxirret përfundimi i gabuar se hardhia u soll në Dardani tek pas pushtimeve romake. Nëse kihet parasysh tradita e drugdhendjes të dardanët dhe kontaktet e tyre të hershme me botën e zhvilluar të jugut, prezencën e hardhisë të dardanët, si prodhim dhe si simbol kulti, duhet parë disa qindra vjet më parë.



Foto 44: Hardhia e rrushit mbi labirintin rrethor të Smirës

¹⁷⁴ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 354. Mbi zhvillimin e vreshtarisë në Ilirinë pararomake shkruajnë dhe Straboni (63 p.e.r. – 20) dhe Plini i Vjetër (23-79. *Naturalis historiae*).

¹⁷⁵ Shih dhe: Dobruna-Salihu, E. (2005) ff. 126 - 143.

Është konstatuar se dardanët besonin në forcën ringjallëse të hardhisë së rrushit, ndërsa për rëndësinë e saj edhe për dardanët flet fakti se kjo bimë është kultivuar tek ilirët pararomak, krahas kultivimit të saj në Helladë.¹⁷⁶ Paraqitja e kësaj bime në monumentet mbivarrore të periudhës romake e përforcon bindjen se kjo kishte rol të jashtëzakonshëm për dardanët dhe, njëkohësisht, e dëshmon mbijetesën e kulturës shpirtërore nëpër shekuj.

Hardhia e rrushit ishte e njohur te dy popujt më të hershëm të Ballkanit, ilirët dhe grekët.¹⁷⁷ Amforat e Hiosit të fazës paraurbane dardane,¹⁷⁸ duhet të jenë lajmëtare të importit të hershëm të verës, mbase dhe të prodhimit të saj në Dardani.

Hershmërinë e prezencës së hardhisë së rrushit e provon edhe prezenca e saj në monumentin nga Smira (Monum. 1), lidhur ngushtë me kultin e saj. Hardhia në këtë monument e nxjerr këtë nga sfera e ngushtë e vetë kultit të vdekurve dhe e vë në lidhje me misticizmin e rilindjes, të njohurit sublim dhe të përjetësisë.

13. Shporta e bollëkut

Shporta e bollëkut (*cornuacopiae*) gjendet në monumentin epigrafik të Romula-Malvës (Mon. 3. Fot. 12, 45). Monumenti është dëmtuar, por në pjesën e poshtme të anës së majtë të figurës së hyjneshës është ruajtur një shportë e bollëkut e mbushur me fruta.

Shporta e bollëkut është një simbol kulti më rrënjë të hershme parahistorike. Në artin paleolitik në duart e *Venerave paleolitike* kanë qenë brirët e shtazëve në vend të shportës, të cilat janë paramenduar si simbole të pëlleshmërisë. I tillë është rasti me Venerën nga shpella Laussel në Francën jugore.¹⁷⁹

Më vonë briri mbushej me fruta, duke u transformuar kështu në bririn parahistorik të bollëkut, si një burim i pashtershëm i mirëqenies, i cili lidhet me kultin e Nënës së Madhe. Sipas mitologjisë helene, nimfa Amaltea, si personifikim antropomorf i dhisë, mbushi bririn e thyer me lule dhe fruta dhe ia dha Zeusit. Zeusi, në shenjë

¹⁷⁶ Zaninović, M. (1976) *Iliri i vinova loza*, Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja, Sarajevo, XIII/11, p. 261.

¹⁷⁷ Zaninović, M. (1976) p. 261.

¹⁷⁸ Shukriu, E. (1996) f. 56.

¹⁷⁹ Waechter, J. (1976) *Man before History*, Oxford-Lausanne, p. 128. Ka interpretime se briri në duart e kësaj Venere e simbolizon hënën.

mirënjohjeje që dhia e kishte ushqyer si foshnjë, i vendosi bririn dhe dhinë në radhën e yjeve.¹⁸⁰

Shporta e mbushur me fruta duket më vonë në vend të bririt. Te keltët shporta e bollëkut u bë një prej attributeve të Hyjneshës Nehalennia, pos qenit si përcjellës i përhershëm. Shporta u bë simbol përcjellës dhe i hyjneshës Epona.¹⁸¹

Shporta e bollëkut te monumenti i Romula-Malvës (Monum. 3) duket të jetë një simbol më i avancuar dhe më i vonë. E vendosur pranë Hyjneshës Dardane, shporta me fruta simbolizon bollëkun e natyrës, pëlleshmërinë dhe mirëqenien e përgjithshme, dhe ka funksion magjiko-religjioz.



Foto 45: Shporta e bollëkut, Romula Malva 2

14. Svastika (kryqi i thyer)

Svastika (kryqi i thyer) gjendet në kompozicionin e labirintit rrethor të hyjneshës nga Smira (Monum. 1. Fot. 5, 46).

Në monumentin e Smirës janë paraqitur gjashtë (6) svastika, tri prej tyre kanë drejtim lindje–perëndim dhe tri të tjera kanë drejtim të kundërt perëndim–lindje (Fot. 5, 46). Këto janë trajtësuar përmes kombinimit të harqeve të labirintit.

Svastika paraqitet si simbol i hershëm parahistorik te shumë

¹⁸⁰ Ylli Dhia me tri kecat e saj: Dhama, T. (1988) f. 29, f. 56.

¹⁸¹ Green, M. (1989) pp. 10 - 11, fig. 2 - 5; 16, fig. 6.

popuj dhe këto gjenden edhe në shumë objekte, sidomos në reliktet e shekujve VI–V p.e.r., përfshirë dhe ato të tumës së Atenicës te Çaçaku (Serbi) dhe atë të Petrova-Cërkva te Novi - Pazari (Serbi).¹⁸²



Foto 46: Svastikat me drejtime të kundërta të labirintit rrethor, Smirë

Edhe në monumentin e Smirës svastika është simbol i rrugëtimit të diellit. Me rremat e kthyer në të djathtë dhe në të majtë ato simbolizojnë qarkun e përhershëm të qenshmërisë: lindjen, vdekjen, ringjalljen. Mbështetur në faktin se svastikat gjenden në monumentin përkushtuar Hyjneshës Dardane, kjo hyjneshë ka mbikëqyrjen në qarkun e qenshmërisë, përkatësisht në ciklin e përhershëm të jetës: lindjes, vdekjes, ringjalljes dhe përjetësisë.

15. Qesja

Qesja duket si simbol vetëm në shtatoren e Hyjneshës Dardane nga Mediana, i cili është monumeti më i vonë në mesin e monumenteve që trajtohen, pasi që i takon shekullit IV (Monum. 6. Fot. 16, 47).

Qesja, e cila simbolizon pasurinë e bollëkun, është simbol i mëvonshëm, i përhapur gjatë periudhës romake. Në rastin e shtatores nga Mediana qesja e zëvendëson shportën e bollëkut, e cila paraqitet si atribut i Hyjneshës Dardane në relievin e zbuluar në Romula Malva 1 (Monum. 3. Fot. 9, 45).

¹⁸² Djuknić, M. - Jovanović, B. (1965) pp. 8, 13, 24, T. IX, Fot. 2; T. XV, Fot. 2.



Foto 47: Qesja në shtatoren e Medianës

16. Kurora murale

Kurora murale paraqitet mbi kokën e Hyjneshës Dardane nga Branetiçi i Poshtëm (Monum. 7. Fot. 17, 48). Kurora ka trajtë katërkëndëshi, me katër nivele dhe katër rende (16 katrorë). Gjendet mbi kokën e hyjneshës, mbi flokët paksa të valëzuar dhe të ndarë në mes.

Kurora murale mbahej nga mbretëreshat e Asirisë, pastaj u bë vetëm atribut i Kibelës së Azisë së Vogël, nënës dhe hyjneshës së tokës, dhe e Tyhes helene.¹⁸³ Kurora murale e identifikonte Hyjneshën Tyhe në periudhën helenistike dhe Fortunën në atë romake.¹⁸⁴

Kurora murale u përdor gjatë periudhës romake, fillimisht si njëra ndër dekorimet më të larta ushtarake (*corona muralis*) dhe e cila realizohej për nder të ndonjë fitoreje.¹⁸⁵

Në antikën e vonë kurora murale u zhvillua në personifikim të hyjneshave mbrojtëse të qytetit apo të rajonit (kurora e qytetit).¹⁸⁶

¹⁸³ Hörig, M. (1979) Dea Syria. Studien zur religiösen Tradition der Fruchtbarkeitsgöttin in Vorderasien, Alter Orient und Altes Testament 208, Butzon und Bercker, Kevelaer, pp. 129 - 134.

¹⁸⁴ Allègre, F. (1889) Étude sur la déesse grecque Tychè, Leroux, Paris, pp. 187 - 192.

¹⁸⁵ Livius, Ab Urbe Condita, XXVI 48

¹⁸⁶ Për konceptin e zhvillimit ikonografik të hyjneshave të qytetit: Alföldi, G. (1963) pp. 149 - 150.



Foto 48: Kurora murale e Hyjneshës Dardane, Branetiç i Poshtëm



Foto 49: Kurora murale e Kibelës (tetradrhmë e Smirnës: v. 160–150)

17. Nyja

Nyja gjendet në pjesën e poshtme të kompozicionit të labirintit rrethor të Smirës. Kjo nyjë lidh dy degët e lerthit dhe është vendosur te hyrja e në rrethin qendror (Monum. 1. Fot. 3, 50).

Nyja si simbol ka kuptim mbrojtës apo apotropëik dhe është mjaft e shpeshtë. Kjo në vete bart traditat totemike dhe kultet bujqësore të epokës së neolitit dhe pastaj u konsiderua si nyje e jetës apo një labirint përmes të cilit duhet kaluar për të arritur deri në qendër, te zgjidhja dhe çlirimi.¹⁸⁷

¹⁸⁷ Chevalier, J.–Gheerbrant, A. (1983) pp. 99 - 100.



Foto 50: Nyja në labirintin rrethor të Smirës

Plini i Vjetër e quan *nodus Hercules*, duke thënë se kishte fuqi profilaktike dhe apotropeike.¹⁸⁸ Si motiv helen u shpërnda në gjithë botën greko-romake.¹⁸⁹ Simbole të nyjës janë paraqitur edhe në tri fibula të argjendta nga Gorica e Sllovenisë¹⁹⁰ dhe nga Municipium S të Plevlës në Mal të Zi.¹⁹¹

Nyja në arën e Smirës ka kuptim apotropeik dhe duket se ka edhe fuqi profilaktike. Kjo e mbron hyrjen, përkatësisht derën e jetës dhe të mistereve të jetës e të universit.

18. Labirinti

Labirinti gjendet si simbol në monumentin e Hyjneshës Dardane nga Smira. Në të janë relievuar dy labirinte, njeri në trajtë rrethi dhe i qarkut të mbyllur dhe tjetri në trajtë katërkëndëshi (Monum. 1. Fot. 3, 51).¹⁹² Ky është rast unik i paraqitjes së dy labirinteve në të njëjtin monument, gjë që e rrit edhe më vlerën e këtij monumenti të veçantë për shumë aspekte.

Labirinti trajtohet si një arkitekturë e hapësirës dhe e kohës së përfytyruar.¹⁹³ Mendohej se në qendër të labirintit arrijnë vetëm më të urtët, të cilët i përballojnë sprovat e iniciacionit (korridorët e labirintit), ku ata ndeshin ndriçimin e të njohurit sublim, fuqinë dhe përjetshmërinë.¹⁹⁴

¹⁸⁸ Naturalis historia XXVIII 63.

¹⁸⁹ Daremberg, Ch. - Saglio, E. (1877) (1877) Dictionaire des antiquités grecques et romaines IV, Hachette, Paris, pp. 87 – 88 (Nodus).

¹⁹⁰ Stipčević, A. (1981) p. 141, Tab. XXXVI, 7.

¹⁹¹ Garašanin, M. (1967) *Crna Gora u osvjet pisane istorije*, Istorija Crne Gore, Titograd, Fot. 42.

¹⁹² Lidhur me labirintin shih: Jaskolsky, H. (1997); Doob, P. (1990).

¹⁹³ Doob, P. (1990) *The Idea of the Labirint from Clasical antiquity through the Middle Ages*, Cornell University Press, Ithaca-London, p. 1.

¹⁹⁴ Mircea, E. (1964) p. 312.

Duket në pjesë të ndryshme të botës, ndërsa ai më i hershmi mendohet të jetë ai i Kretës.¹⁹⁵

Prezenca e labirintit shihet me kuptime të shumta, madje edhe kontradiktore. Kështu, përderisa labirinti i Kretës prezanton torturuese nëntokësore, ai trojan i Virgjilit shërben si metaforë e Trojës, qytet-fortifikatës perfekte.¹⁹⁶ Një qasje e tillë mund të vërehet edhe tek labirinti i Gamzigradit, ndryshe nga ai rrethor i Smirës, i cili nuk lidhet me qytetin ideal, por me një “qytetërim” gjithëpërfshirës.




Foto 51: Dy labirintet e monumentit të Hyjneshës Dardane, Smirë

Trajtat e labirinteve duken kudo, por kryesisht janë prezente në Azi dhe në Europë.¹⁹⁷ Paraqitja e tyre është më e shpeshtë në Knosos të Kretës,¹⁹⁸ në Egjipt, në Samos dhe në Itali,¹⁹⁹ si dhe në urnat e hershme etrurë në trajtë të shtëpive.²⁰⁰

¹⁹⁵ Jaskolsky, H. (1997) p. 36.

¹⁹⁶ Wright, C. (2001) *The Maze and the Labyrinth, From Classical Antiquity through the Middle Age*, Cornell University Press, Ithaca, p. 15.

¹⁹⁷ Cirlot, J. (1971) p. 317.

¹⁹⁸ Kanlif, B. (1964) *Rimsko carstvo, Narodi i civilizacije*, Beograd P.R. Doob (1990) p. 1.

¹⁹⁸ Mircea, E. (1964) p. 312.

¹⁹⁸ Kanlif, B. (1964) p. 10.

¹⁹⁹ *Enciklopedija likovne umjetnosti* 3 (1964) p. 273.

²⁰⁰ Kanlif, B. (1964) p. 11.

Simboli i labirintit vendosej në portat e qyteteve të fortifikuara dhe në maketat e shtëpive të vjetra helene, ndërsa, sipas Virgjilit, labirinti ishte i skalitur edhe në dyert e Shpellës së Sibilës në Kumë.²⁰¹ Labirintet gjenden të dizajnuara edhe në monedhat e Kretës.²⁰²

Për labirintet rrethore o eliptike sugjerohet që të interpretohen si diagrame të qiellit, përkatësisht si imazhe të dukshme të trupave qiellorë dhe mendohet se disa tempuj fillestarë kishin trajtë labirinti.²⁰³

Paraqitja e labirintit rrethor të qarkut të mbyllur të Smirës është unike edhe për nga kombinimi me hardhinë, lerthin dhe nyjën profilaktike. Rrathët koncentrikë, ndërlidhja e të cilave krijon gjashtë svastika dhe shumë hapësira të ndara, pos diellit dhe rrugëtimit të tij, paralajmërojnë hierarkinë e krijuar të religjionit dardan dhe shkallët e qenshmërisë universale.

Sfera në qendër të kompozicionit, e ndarë në tri pjesë, paraqet relacionet midis botës tokësore, të nëndheshme dhe qiellore, përkatësisht tërësinë tokë-qiell. Simbolet e tjera të të njëjtës faqe të arës, hardhia e rrushit dhe lerthi, e përforcojnë këtë relacion.



*Foto 51: Monedha me labirint e Knososit
(Kretë. shek. IV p.e.r.: C. Wright 2001)*

²⁰¹ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) p. 655.

²⁰² Wright, C. (2001) p. 9, Fig. 1 1.

²⁰³ Cirlot, J. (1971) p. 317.




Foto 53: Simbolet në labirintin rrethor të Smirës




Foto 54: Simbolet në Romula Malva I



Foto 55: Simbolet në Romula Malva 2




Foto 56: Simbolet në patelën e Branetiqit të Poshtëm




Foto 57: Simbolet në shtatoren e Medianës

Simbolet në monumentet e Hyjneshës Dardane

| | <i>Simboli</i> | <i>Vendi</i> |
|----|--------------------|-----------------------------------|
| 1 | edhi | Romula Malva 1, Branetiç |
| 2 | cjapi | Branetiç i |
| 3 | dielli | Banjë e Kllokotit, Romula Malva 1 |
| 4 | Hëna | Romula Malva 1 |
| 5 | Sëpata | Medianë, Branetiç |
| 6 | viçi | Medianë |
| 7 | Kënduesi | Romula Malva 1 |
| 8 | Altari | Romula Malva 1, Branetiç |
| 9 | Derri | Medianë |
| 10 | Lerthi | Smirë |
| 11 | Spiralja | Gllamnik 2 |
| 12 | kalliri i grurit | Branetiç, Soçanicë |
| 13 | hardhia e rrushit | Smirë |
| 14 | shporta e bollëkut | Romula Malva 2 |
| 15 | Svastika | Smirë |
| 16 | Qesja | Medianë |
| 17 | kurora e qytetit | Branetiç i Poshtëm |
| 18 | nyja profilaktike | Smirë |
| 19 | labirinti | Smirë |

III. FUNKSIONET E HYJNESHËS DARDANE

Hyjnesha Dardane ishte e panjohur për studiuesit deri në vitin 1972, andaj dhe për funksionet e saja më pas kishte hamendje të studiuesve. Prezenca e saj në panteonin dardan u bë e njohur tek pas zbulimit në Romula Malva të Oltenisë (Rumani) të dy monumenteve përkushtuar kësaj hyjneshe dhe pas analizës së funksioneve të mundshme të saj në besimin e popullatës.

Sipas mendimit të studiuesve të parë, D. Tudor dhe C. Vladescu, hyjnesha prezanton një hyj sinkretik dhe është personifikim i vetë Dardanisë. Përmes analizës së simboleve të monumenteve këta konstatuan se funksionet e hyjneshës përbëheshin nga elemente të gërshetuara të natyrës, të pëlleshmërisë dhe mbase edhe të atyre ktonike. Prezencën e hyjneshës e panë si një interpretim romak (interpretatio romana) të hyjnisë vendëse.²⁰⁴ Këtë e sugjeronte edhe vetë termi latin *Dea*, prezent në të gjitha monumentet epigrafike të zbuluara më pas.

A. Jovanović, i cili ishte i pari që solli mendimin se shtatorja e Medianës ishte në të vërtetë Hyjnesha Dardane (Monum. 6. Fot. 16) dhe këtë e pa si personifikim të provincës romake të Dardanisë.²⁰⁵ Fakti se shumë monumente epigrafike i takojnë kohës para themelimit të provincës së Dardanisë, sugjeron rikonsiderimin e këtij mendimi. Mendoj se edhe qëndrimi i I. Petrović, e cila hyjneshën e sheh si hyjneshë të atdheut dardan (*dea patriae*),²⁰⁶ duhet rikonsideruar, pasi që funksionet e saja janë shumë më gjithëpërfshirëse.

Cila ishte, në të vërtetë, Hyjnesha Dardane? Cilat ishin funksionet e saja? Cilat ishin ritualet që zhvilloheshin lidhur me të? Në cilën kohë zhvilloheshin këto rituale? Këto dhe pyetjet e tjera, qëndrojnë si sfidë para studiuesve, të cilët e trajtojnë çështjen e kësaj hyjneshe. Në kuadër të kësaj duhet të kihet parasysh dhe fazat e ndryshmeve të zhvillimit të besimit në të, duke përfshirë dhe kalimin nga format më primitive të besimit, në ato më të sofistikuar dhe të cilat ishin pasojë e klimës shoqërore dhe të klimës politike.

²⁰⁴ Tudor, D. - Vladescu, C. (1977) p. 188.

²⁰⁵ Jovanović, A. (1980) pp. 57 - 58.

²⁰⁶ Popović, I. (2008) p. 40.

Fazat e zhvillimit të besimit në fuqitë e Hyjneshës Dardane, si dhe të besimeve të tjera në periudha të caktuara, e mundëson analiza e simboleve që paraqiten në monumentet përkushtuar kësaj hyjneshe.

Hyjnesha Dardane ka funksione të shumta, varësisht nga koha kur besohet në të. Hyjnesha mban fillimisht funksionin e pëlleshmërisë, pastaj të mbrojtjes së territorit dhe të prosperitetit. Me paraqitjen e edhit në monumentin e Romula Malvës 1, ajo lidhet me fazat e mëhershme blegtorale, pasi që edhi, dhia dhe cjapi janë shprehje e kësaj baze ekonomike.

Paraqitja e kallirit të grurit e lidh me zhvillimin e mëtejshëm agrar, siç e bën dhe paraqitja e viçit. Sipas këtyre simboleve, funksioni fillestar i hyjneshës ishte ai i pëlleshmërisë. Kjo do të thotë ndërlidhje me Nënë e Madhe (Magna Mater), me të cilën lidhen dhe shumë hyjnesha të tjera, siç ishte Kibela e Anadollisë (e dëshmuar edhe me titullin Magna Mater), Nintur e Mesopotamisë, Demetra e mitologjisë të njohur si greke, Amaterasu e Japonisë, Nëna Saule e Letonisë apo Sedna e eskimëve.²⁰⁷

Hyjnesha Dardane ishte edhe mbrojtëse e territorit, andaj në këtë funksion u pa nga shumë studiues. Kështu, u pa e ngjashme në funksion me Hyjneshën histriane - liburne Eian, që duket në monumente si Histria Terra, Terra Histria apo vetëm si Histria,²⁰⁸ si dhe me hyjnitë e tjera të territorit si Dea Syria,²⁰⁹ Dii/Deae Daciarum,²¹⁰ apo Dea Brigantia.²¹¹

Hyjnesha ishte dhe mbrojtëse e rrugëve, e udhëtarëve dhe e tregtarëve, funksione këto që i kishin Hermesi i mitologjisë greke apo Merkuri i asaj romake. Simboli i përbashkët me këta ishte kënduesi (Fot. 9). Funksioni i tillë i mbrojtjes mund të konstatohet nga fakti se monumentet me përkushtim ndaj kësaj hyjneshe gjenden pranë qendrave beneficiare dhe se janë ngritur nga funksionarë ushtarakë apo administrativë.

Në kuadër të funksioneve të mbrojtjes përfshihet dhe mbrojtja e

²⁰⁷ Motz, L. (1997) *The Faces of the Goddess*, Oxford University press, New York – Oxford, p. 1.

²⁰⁸ Degrassi, A. (1970) *Culti dell' Histria preromana et romana* (Miscellanea Gregorio Novak dicata), Zagreb, pp. 161 - 167.

²⁰⁹ CIL (Corpus Inscriptionem Latinarum) III, 7864.

²¹⁰ CIL III, 966.

²¹¹ CIL VII, 200, 8075, CIL XII, 4883 e të tjera.

rajoneve xehetare. Ky funksion i mbrojtjes së arealeve xehetare nënkuptohet kur dihet se Dardania ishte një nga hapësirat më të pasura, sidomos me ar, të perandorisë romake.²¹²

Autori antik Plini i Vjetër përmend arin dardan (*aurum Dardanium*)²¹³ si dhe shkruan:

*Madje edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës (rrathë ari), të cilët vinin nga Dardania dhe për këtë quheshin dardanë.*²¹⁴

Në këtë drejtim A. Jovanović e sheh me të drejtë paraqitjen e qeses (marsupium) në shtatoren e Medianës si *mundësi e shenjës së materializuar të pasurisë së Dardanisë me ar.*²¹⁵

Sipas tekstit të mbishkrimit në monumentin votiv të Banjës së Kurshumlisë (Aquarum Bassianae), i cili i është ofruar tempullit të banjës termale, hyjnesha kishte edhe funksionet e hyjnisë së burimeve dhe të ujërave termalë (Monum. 9).

Funksionet e hyjneshtës përfshijnë edhe çështjet që kishin të bënin me botën e të vdekurve dhe të përjetësisë. Lidhshmëria e funksioneve të kësaj hyjneshe me botën e të vdekurve dhe me botën e tejpashme, dëshmohet nga prezenca e simboleve që lidhen me të: derri, sëpata dytehëshe apo kënduesi. Këto paraqiten në monumentin e Romula-Malvës 1 (Monum. 2. Fot. 9), Medianës (Monum. 6. Fot. 16) dhe të Branetiçit të Poshtëm (Monum. 7. Fot. 17).

Prezenca e sëpatës dytehëshe dhe e derrit faran në shtatoren e hyjneshtës nga Mediana e përforcojnë lidhshmërinë e Hyjneshtës Dardane me botën e nëndheshme, pos që këto e dëshmojnë edhe lidhshmërinë e saj me kultin e diellit. Në këtë drejtim është jo e rastësishme që në të gjitha monumentet këto simbole janë vendosur në pozita fikse:

1. tek apo nën këmbët e hyjneshtës;
2. në anën e majtë të hyjneshtës.

Vendosja e simboleve që lidhen me vdekjen në nivele të poshtme, në anën e majtë të hyjnisë, sjell detyrimisht supozimin se Hyjnesha Dardane mbante edhe funksionet e çështjeve që lidheshin me vdekjen dhe me botën e nëndheshme.

²¹² Rendić-Miočević D. (1990) p. 81.

²¹³ Plinius Secundus, *Naturalis Historiae* XXXI, 39.

²¹⁴ Plinius Secundus, *Naturalis Historiae* XXIII 3, 12.

²¹⁵ Jovanović, A. (1980) p. 56.

Por, Hyjnesha Dardane del nga sfera e ngushtë e kultit të të vdekurve dhe vihet në lidhje me misticizmin e ringjalljes dhe të njohurit sublim, në veçanti kur kihet parasysh kompozicioni me labirintin rrethor të monumentit nga Smira (Monum. 1, Fot. 3, 53).

Koncepti ikonografik i monumenteve të hyjneshës është çështje për trajtim të veçantë. Ky koncept ka elemente të përbashkëta, duke u nisur nga pozita e hyjneshës, veshja e saj dhe simbolet. Kështu, të gjitha paraqitjet figurative kanë pozitë frontale, kanë shtazë të vogël te gjoksi, të cilën e mbajnë me dorën e lakuar të majtë. Po ashtu, edhe veshja e hyjneshës ka elemente të përbashkëta vijuese: nënkresën (Banjë e Kllokotit), shaminë që bie mbi shpatulla (Romula Malva 1, Banjë e Kllokotit, Medianë), fustan të gjatë me shumë palë (hiton), fustan të shkurtër (himation) (Fot. 58).

Për dallim nga paraqitjet me nënkrese dhe shami, që lidhen me elemente autoktone të trashëguara deri në bashkëkohësi, disa përfytyrime të hyjneshës kanë frizura dhe këto lidhen me ndikimet e artit romak apo dhe helenistik. I tillë është prezantimi i kokës me frizurë, që duket edhe në monumentin Gllamnik 2 (Monum. 5. Fot. 59).

Përfytyrimi figurativ i Hyjneshës Dardane lidhet me forcimin e shtetit dardan dhe të pozitës së mbretit, për të përfunduar me paraqitjet abstrakte të ciklit të jetës dhe të përfytyrimit të universit përmes labirintit rrethor të qarkut të mbyllur të Smirës, si një nivel më i lartë i zhvillimit të besimit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Në nivelin e deritanishëm të njohurive nuk është e lehtë të flitet mbi ndikimet në skemën ikonografike të hyjneshës, ato greke, helenistike, romake apo dhe orientale, aq më tepër që të gjitha monumentet e zbuluara i takojnë gjysmës së shek. II dhe më tej.

Lidhur me ndikimet e mundshme në ikonografinë e Hyjneshës Dardane duhet të kihet parasysh se skema e mbajtjes së shtazës së vogël duket shpesh te shtatoret e hyjneshave me rëndësi të shekujve VI–IV. Këtë skemë e kanë Demetra, Afërdita, Hera dhe Artemida,²¹⁶ ndërsa skema e tillë nuk është prezente në traditën e artit romak.

²¹⁶ LIMC IV: Hera, no. 57, 62 (type Hera Hippias); LIMC II, Aphrodite, no. 65, 66 (type Koré); LIMC II, Artemis, no. 560-590; LIMC IV, Demeter, no. 100 - 108.




Foto 58: Koka e Hyjneshtës Dardane nga Banjë e Kllokotit e Romula Malva 1



Foto 59: Koka e femrës në kapitelin e monumentit Gllamnik 2

Në këtë shkallë të studimeve mund të konstatohet vetëm se arti dardan ndryshon në raport me artin e skulpturës perandorake dhe kultore romake. Ndikimet kanë mundur të arrijnë nga modelet e shtatoreve orientale dhe në veçanti nga ato helene, aq më tepër për shkak të lidhjeve më të hershme dardane me jugun, lidhje këto që janë intensifikuar nga shek. VI p.e.r..

Si edhe hyjnive të tjera, hyjneshtës i janë ofruar fljime, si pjesë të ritualit të përgjithshëm. Shtazët e fljuara dhe derdhja e gjakut të

tyre në dhe mendohej se siguronin pëlleshmërinë e dëshiruar dhe të nevojshme të natyrës. Këtë funksion e kishte dhe shpërndarja e trupit të copëtuar nëpër fusha, posaçërisht të organeve regjeneruese.

F. Cummont e mbështet mendimin se derdhja e gjakut te popujt e lashtësisë shihej si “karrige e jetës”.²¹⁷ Në të gjitha religjionet e botës derdhja e gjakut ishte pjesë e idesë qendrore të kozmogonive të *sakrificës paramordiale*, që nënkupton se nuk ka krijim pa sakrificë dhe as jetë pa vdekje.²¹⁸ Andaj ideja karakteristike e mitologjisë antike ishte se çdo sundim duhet t’i hapë rrugë tjetrit, siç krijonte model për qeverisjen në tokë sundimi suksesiv kozmik i Uranit, Saturnit dhe Jupiterit. Shembulli më i mirë për sundimin suksesiv janë saturnalitë e famshme të Romës antike.²¹⁹

Çfarë përmbajtjeje kishin ritualet e flijimit te dardanët dhe si zhvilloheshin këto nuk është e njohur, por është e kuptueshme se këto ishin prezente. Ajo që me siguri mund të dëshmohet është se procesit të flijimit i nënshtroheshin shtazët e vendosura në monumentet e Hyjneshës Dardane: edhi, cjapi, viçi dhe derri faran.

Lidhja e drejtpërdrejtë për shtazët e flijuara shihet përmes gjelit të vendosur mbi altar në monumentin Romula Malva 1 (Monum. 2. Fot. 9) dhe derrat faran të shtatores së Medianës (Monum. 6. Fot. 16), ndërsa mbajtja e edhit dhe e viçit në kraharor të hyjneshës paralajmëron se dhe këto ishin shtazë flijimi (Fot. 29). Objekte flijimi ishin dhe objektet e çmuara, siç ishin sëpata dytehëshe e Medianës (Monum. 6. Fot. 16) dhe sëpata e Branetiçit të Poshtëm (Monum. 7. Fot. 17).

Shkalla më e lartë e adhurimit të Hyjneshës Dardane shprehet përmes labirintit rrethor të Smirës. Në përfytyrimet e popullatës dardane duket se kjo hyjneshë i kishte të përmbledhura gati të gjitha funksionet, nga ajo e pëlleshmërisë në parahistori, deri te hyjnia i lidhur me diellin / universin dhe ciklin e përhershëm të jetës. Pra, Hyjnesha Dardane ishte bërë një hyj suprem i panteonit politeistik dardan dhe shumë e respektuar edhe gjatë periudhës së sundimit romak. Kësaj hyjneshe, për shkak të fuqisë që paramendohej ta kishte, nuk iu dha emër romak dhe nuk kishte nevojë të bëhej pre e

²¹⁷ Cummont, F. (1922) p. 51.

²¹⁸ Cirlot, J. (1971) p. 276.

²¹⁹ Cirlot, J. (1971) p. 276.

interpretimit romak të emrave të hyjnive vendës. Përkundrazi, ajo mbajti emrin e vënë shumë kohë më parë.

Monumentet e Hyjneshës Dardane i takojnë periudhës romake, por ato shprehin edhe botëkuptimet e krijuara dardane nga fazat pararomake. Të tilla janë elementet e traditës së mëhershme të dukshme në monumentet e Romula Malvës, Medianës dhe në monedhat me mbishkrim *dardanici*.²²⁰

Jashtë ndikimeve të traditave romake duhet parë dhe elementet autoktone etnologjike të Hyjneshës Dardane, si dhe mbajtjen e edhit dhe të viçit apo prezencën e derrit faran, si simbole të shoqërive bujqësore-blegtorale neolitike. E njëjta vlen dhe për sëpatën dyteheshe apo labrisin, si simbol i hyjnive qiellore rrufehedhëse²²¹ dhe prezente në territoret ilire që në mijëvjeçarin II p.e.r..

Monumentet sjellin konceptin mbi ciklin e jetës, i cili i ka rrënjë në parahistori të hershme. Ky del si rezultat i prezencës dhe i veprimtarisë së qiellvrotuesve parahistorikë dhe i atyre të periudhës antike. Njëra ndër dëshmitë e hershme mbi zhvillimin e konceptit mbi ciklin e jetës është labirinti i vendosur mbi barkun e shtatores së njohur me emrin *Hyjnesha në fron*, e zbuluar në lokalitetin *Tjerrtorja* të Prishtinës (Fot. 89).

Shtatorja e hyjneshës në fron paraqet një hyj parahistorik, që nuk është studiuar në shkallë të duhur dhe që ofron mundësi të shumta për njohjen e nivelit kulturor dhe të besimit gjatë proceseve neolitike dhe eneolitike. Hap nismëtar në këtë drejtim ka bërë M. Gimbutas, duke parashtruar edhe aspektet kozmologjike dhe kozmogonike që sjellin figurinat parahistorike të Europës, duke përfshirë dhe ato të Kosovës.²²²

Kur kihet parasysh se çdo objekt, i parë si *univers* më vete, flet për krijuesin e objektit, si dhe për rrethanat ekonomike dhe shoqërore, filozofinë e kohës dhe besimet, *Hyjnesha në fron* kërkon hulumtim të çdo simboli të gërricur në të, duke u nisur nga labirinti i gërricur në barkun e fryrë.

E parë tej imazhit arkeologjik, që do të thotë tej të dhënave

²²⁰ Shukriu, E. (1986) ff. 15 - 21.

²²¹ Green, M. (1991) p. 57, f. 65.

²²² Gimbutas, M. (1974) *The Goddesses and Gods of Old Europe*, University of California Press, pp. 99 - 111.

fillestare të teknikës dhe të dimensioneve të *Hyjneshës në fron*, labirinti i vendosur qëllimisht në barkun e saj shpreh fillimet e koncepteve mbi ciklin e jetës dhe mbase më shumë.

Hyjnesha në fron nuk është e vetme si e tillë as në Kosovë. Fakti se hyjneshat si kjo janë të ulura në fron, e dëshmon pozitën e tyre dominuese. Këto kanë më shumë funksione se shumë terakota të hyjnive të tjera që qëndrojnë në këmbë dhe, po ashtu, e kanë barkun dukshëm të fryrë. Këta të fundit nuk kanë simbol të gërricur të labirintit,²²³ andaj mendoj se mund të lidhen vetëm me funksionin e tyre të pëlleshmërisë.

Koncepti mbi ciklin e jetës, por më i zhvilluar, la gjurmë në artin parahistorik shkëmbor të hijerores së *Mrizit të Kobajës* të Vlashnjës te Prizreni (Kosovë. Fot. Në të gjenden pikturime ngjyrëkuqe të grupimeve skematike të spiraleve dhe të piktogramit të drerit, si simbol i hyjnive primare dhe kasnece të botës së nëndheshme. Pranë dhe rreth tyre banorët parahistorikë iu blatuan diellit dhe ciklit të jetës, duke zhvilluar edhe rituale të iniciacionit në hapësirën e tyre të shenjtë.²²⁴

Nivel më të lartë rreth konceptit të ciklit të jetës / përjetësisë dhe përfytyrimit dardan të universit shpreh kompozicioni me labirintin rrethor në monumentin nga Smira. Vetë labirinti është unik, për nga kompozicioni i veçantë i tij, për nga kombinimi me hardhinë, lerthin dhe nyjën profilaktike dhe si pjesë e përfytyrimit të ciklit të përhershëm të jetës.

Rrathët koncentrikë, ndërlihdja e të cilëve krijon gjashtë svastika me drejtime të kundërta dhe tri hapësira, pos simbolit të diellit dhe rrugëtimit diellor, flasin mbi shkallët universale të qenshmërisë dhe, po aq, për hierarkinë e krijuar të besimit dardan.

Sfera në qendër të kompozicionit, po ashtu, është ndarë në tri pjesë dhe, bashkë me simbolet e tjera të trinisë, paraqet relacionet midis botës tokësore, të nëndheshme dhe të asaj qiellore. E qenësishme me këtë rast është të ceket se botëkuptimet e shprehura në këtë mënyrë, sipas njohurive të deritanishme, janë krijim dardan.

²²³ Shih: Katalog arkeologjik (2013) f. 45, Fot. 44c.

²²⁴ Shukriu, E. (2010) *Spirals of the Prehistoric Open Rock Paintings from Kosova*, XV Congress of the International Union for Prehistoric and Protohistoric Sciences, Lisbon, 2006, British Archeological Reports, Oxford, pp. 59 - 62.

IV. ZHVILLIMI I BESIMIT DARDAN SIPAS MONUMENTEVE TË HYJNESHËS DARDANE

Trajtimi i çështjeve të besimit është me interes të veçantë, sepse përmes relikeve materiale shpreh botën shpirtërore, në të cilën nuk është aq lehtë të depërtohet. Në shtigjet e kërkimit ndeshen gracka të shtresimeve të ndryshme, që nga krijimet autoktone, ndikimet, gërshetimet dhe përshtatjet për nevojat vendore.

Si pasojë e gërshetimeve të ndryshme, edhe në besimin dhe mitologjinë helene, për të cilat janë bërë studime të shumta, ekzistojnë ende shumë të panjohura. Këto nisin nga prejardhja e hyjnive të shumta, madje edhe të hyjnive më të njohura si Zeusi, Athena apo Afrodita. Për zbrëthimin e nevojshëm është barrierë mungesa e studimit të thelluar të adstratit pellazgjik, duke lënë anash disa mëtime. Për të arritur sa më afër të vërtetës historike, është e nevojshme qasja shumëdisiplinare, madje mbase duke e bërë edhe deshifrimin e shkrimit Libear A., i cili ende nuk është “lexuar”, ndryshe nga shkrimi Linear B, që është konstatuar se i përket gjuhës arkaike greke.

Pse shkrimi Linear A nuk është deshifruar deri më sot? Ka të bëjë ky me pellazgët? Një nga shpjegimet mund të jetë se shkrimi Linear A ngeli i padeshifruar për shkak se studiuesit e interesuar nuk e njihnin gjuhën shqipe, atë të lashtë, njërin nga gjuhët më të vjetra europiane.

Edhe mbi besimin dardan mungojnë botime të veçanta, si dhe për besimin ilir për gjithë territorin e shtrirjes së tyre. Andaj, studimi mbi Hyjneshën Dardane mund të jetë nismë dhe ndihmesë për njohjen e besimit dardan, ilir e të popujve të rajonit.

Analiza e attributeve veç e veç dhe e kompozicioneve të paraqitura në monumentet përkushtuar Hyjneshës Dardane mundëson njohjen e funksioneve të kësaj hyjneshe në kohë të ndryshme, po aq sa mundëson edhe krijimin e një pasqyre të përgjithshme të ecejakeve të besimit dardan.

Zhvillimi i besimit në trojet dardane, duke mos qenë hapësirë e izoluar, kaloi nëpër shkallët e ngjashme si edhe te popujt e tjerë të

lashtësisë. Ky kishte karakteristika të përgjithshme të parahistorisë dhe të antikës, duke u transformuar nga animizmi e kulti i shtazëve dhe ai solar në një besim antropomorf politeist e deri tek ai monoteist.

Në përgjithësi, besimi dardan kaloi nëpër fazat vijuese:

1. Faza parahistorike:

- a. animizmi,
- b. totemizmi.

2. Faza antike:

politeizmi (IV p.e.r. - IV).

3. Faza e antikës së vonë:

monoteizmi (IV→).

1. Faza parahistorike

Besimi gjatë parahistorisë dardane përfshinte a) fazën e animizmit dhe b) fazën e totemizmit. Gjurmë të fazës së animizmit, besimit në forcat e mbinatyreshme dhe veprimet e magjisë për mëshirimin e këtyre forcave, bartin më pas simbolet përcjellëse të monumenteve të Hyjneshës Dardane: edhi, viçi dhe derri faran. Që të tri shtazët u janë flijuar këtyre forcave.

Gjurmët e fazës totemike, kur hyjnitë marrin trajtë shtazësh²²⁵ apo të trupave qiellorë, gjenden në simbolet e shtazëve që në antikë bëhen përcjellëse të hyjnine. Lidhur me këto R. Graves shkruan:

Zotat e hershëm, parahelenë, paraqiteshin në formë kafshe; qenia e tyre ishte e lidhur me pemët, bimët, ujërat, tokën erën dhe retë. Ata nuk jetonin në qiej si zotat e Olimpiti, por në tokë dhe nën të.

Në këtë drejtim duhet parë dhe shtazët që dalin si përcjellëse të Hyjneshës Dardane (edhi, viçi, derri faran). Simboli i gjarprit nuk paraqitet në mesin e attributeve të Hyjneshës Dardane, gjë që e lidh këtë kryesisht me kultin parahistorik të diellit dhe me kultin e ilirëve të veriut.

Në këtë fazë dëshmohet zhvillimi i konceptit mbi ciklin e jetës dhe të jetës së tejpasme. Kjo mund të përfundohet nga simbolet e shumta që paraqiten në enët e kultit të epokës neolitike dhe eneolitike (Fot. 43), si dhe përmes artit shkëmbor të Vlashnjës (Fot. 83 - 87).

Kujdesi ndaj të vdekurve përcillet me qartësi arkeologjike, pikësëpari përmes tumave të shumta dhe të formave të tjera të varrimit. Këto janë prova mbi besimin në përjetësi bashkë me objektet e vendosura në varre, siç është plastika e imët e epokës së hekurit me paraqitjet e diskut diellor, të rrotave (pjesë të qerres diellore) apo të shpezëve, që shihen si simbole të diellit.

Vëmendje të veçantë lidhur me kultin e diellit dhe të besimit në përjetësi paraqesin disqet prej bronzi të zbuluara në varrin 3 të tumës II të Shirokës.²²⁶ Disqet, me diametër 5.8 cm dhe 2,5 cm, kanë trajtë

²²⁵ Graves. R. (1957) p. 20.

²²⁶ Slavković-Djurić, N. (1968) p. 539, p. 544, T. II 8; T. III 1, 2.

rrethi të rregullt dhe në mes kanë në dukje një kryq, i cili simbolizon rrugëtimin e diellit. Për shkak të dukjes së tyre këto u quajtën gabimisht “pulla”, ndonëse pullat nuk ishin në funksion të veshjeve të atëhershme.

Funksioni i vërtetë i disqeve del sheshit kur kihen parasysh rrezet e dukshme të diellit, të gërricura me shumë kujdes në trajtë trekëndëshi të zgjatur në kornizat e gjera, të cilat kanë dhe nimbusin. Disqet në të vërtetë simbolizojnë vetë diellin, përmes rrezeve, dhe rrugëtimin e diellit, përmes kryqit.




Foto 60: Disqet diellore, Shirokë: Tuma 2, varri 3 (Viz. M. Ademi)²²⁷

²²⁷ Janë pronë e Muzeut të Kosovës. Janë marrë në Beograd bashkë me objekte të tjera arkeologjike gjatë luftës në Kosovë (1989) dhe ende nuk janë kthyer.

Këto disqe, duke qenë simbole të diellit, janë vendosur në varre për ta ndihmuar shpirtin e të vdekurit në udhëtimin e tij në botën e amshuar. Ndonëse edhe M. Green i quajti “rrota” këto objekte, edhe kjo studiuese e parahistorisë dhe të antikës kelte dhe europiane, i sheh si simbole të diellit.²²⁸

Disqet e Shirokës ofruan mundësi që të kuptohen edhe objektet e ngjashme nga varret e lokaliteteve të tjera dhe të cilat nuk kishin ornamente aq të qarta si në rastin e Shirokës. Të tilla disqe (pallaka rrethore), me gjysmë sferë të theksuar, ishin të pranishme dhe në varret e tumave të Përçevës, në Bergallë apo në varrin e shek. VII-VI të Brazdës në rrethin e Shkupit (Fot. 61).²²⁹ Në Gllasinac gjenden në numër më të madh dhe i takojnë fazës II të epokës së hekurit.²³⁰



*Foto 61: Disku diellor i varrit të shek. VII-VI të Brazdës
(Shkup, Maqedoni. I. Mikulčić 1982)*

Nga tuma e Shirokës zgjon vëmendje edhe objekti në trajtë kryqi i vendosur në varr dhe të cilin studiuesit e panë si varëse.²³¹ Ndonëse mund të shihet dhe si aplikacion, por ky nuk ka vrimë apo ndonjë element tjetër që mund ta klasifikonte si varëse. Është kjo

²²⁸ Green, M. (1984).

²²⁹ Klian, K. (1975) p. 95, T. 58, 59; Mikulčić, I. (1982) Skopje so okolnite tvrdini, Makedonska knjiga, Skopje. p. 24, Fot. 6.

²³⁰ Benac, A.-Čović, B. (1957) Glasinac, Zemaljski muzej, Sarajevo, p. 33.

²³¹ Slavković-Djurić, N. (1968) T. II 5.

arsye pse mendoj se edhe me këtë rast është fjala për simbolin e diellit, rrjedhimisht të rrugëtimit të përhershëm të diellit lindje – perëndim - lindje.

Trajtë kryqi ka edhe objekti nga varri i Brazdës pranë Shkupit²³² apo ai i periudhës romake nga varri nr. 6 i Nekropolit Verior të Ulpianës (3 x 3cm), që duket e mban të njëjtën simbolikë si ato të epokës së hekurit.

Objektet e cekura mund të kenë qenë dhe mjete pagese për kalim në botën tjetër, siç mendohet edhe për ato të zbuluara në varret etrure të shekujve VIII-VII apo të atyre të gjetura në Slloveni, Gjermani dhe Francë.²³³

²³² Mikulčić, I. (1982) p. 24, Fot. 6.

²³³ Dechelette, J. (1927) pp. 287 - 292.

2. Faza antike: politeizmi

(IV p.e.r. - IV)

Në fazat protoantike dhe antike të popujve të ndryshëm totemet morën trajta antropomorfe, duke u njohur në shkencë me nocionin antropomorfizmi hyjnor.²³⁴ Në këtë dritë duhet parë paraqitjen e Hyjneshës Dardane si një hyj antropomorfe, e cila në fillim kishte funksione të kufizuara, të pëlleshmërisë dhe të territorit.

Paraqitjen e Hyjneshës Dardane, si edhe të hyjnive të tjera vendëse dhe të hyjnive që dalin si *interpretatio romana*, dhe të cilat duhet lidhur me kohën e fuqizimit të dardanëve dhe me krijimin e shtetit dardan nga shek. IV p.e.r.. Kështu, politeizmi i hershëm, ku secili hyj kishte funksione të caktuara apo disa sosh, lidhet më shumë me nismën e antikës dardane. Në fund të kësaj faze paraqiten hyjnitë sinkretike, të cilat përmbledhin funksionet e disa hyjnive, siç është rasti me Hyjneshën Dardane.

Bota shpirtërore dhe religjioze dardane u zhvillua krahas zhvillimit urban dhe atij shtetëror. Përderisa kulti i diellit dhe ai i gjarprit ishin veçori të fazave paraurbane dardane, në fazën urbane u arrit sinkretizimi i kulteve dhe hyjnitë fituan trajta antropomorfe. Kështu, sipas modelit të mbretërisë, që kishte pushtetin në tokë, u krijua mbretëria qiellore dardane.

Duket se nga fundi i shekullit IV p.e.r., kur Dardania nisi rrugëtimin drejt zenitit të një shteti të fuqishëm, Hyjnesha Dardane u bë edhe simbol dhe mbrojtëse e Dardanisë, ndonëse si e tillë mund të shihet dhe më parë. Tempujt e saj ende nuk janë zbuluar, si edhe shumë objekte të kësaj periudhe, pos atij të supozuar nga Banja e Kurshumlisë.

Në kuadër të kërkimit të tempujve përkushtuar Hyjneshës Dardane duhet rikujtuar se në Gradishtë të Studençanit, afër Shkupit, është zbuluar tempulli i shek. V p.e.r., për të cilin mendohet se i është përkushtuar variantit lokal të Hyjneshës Athina. Ngjashëm me shtatoren nga Mediana, të cilës shkencëtarë të ndryshëm i jepnin emra të tjerë, duke mos e njohur hyjneshën vendëse, ka mundësi që ky tempull të lidhet me Hyjneshën Dardane.

²³⁴ Deri në shekullin VI p.e.r. romakët nuk kishin zhvilluar hyjni antropomorfe: Leeming, D. (2010) *The Creation Myths of the World, An Encyclopedia, Part II* (sec. edit.), ABC-CLIO, Santa Barbara-Denver-Oxford, p. 231.

3. Faza e antikës së vonë: monoteizmi

Funksionet e shumta që shihen përmes simboleve të Hyjneshës Dardane dhe paraqitja e labirintit të Smirës, jep të kuptohet se besimi politeistik dardan, i ruajtur deri në shekullin III, krijoi baza dhe hapi shtigje për fazën e re të monoteizmit gjithëpërfshirës. Kështu, politeizmi, të cilit i parapriu henoteizmi, gradualisht kaloi në monoteizëm. Ky transformim ishte në harmoni me lëvizjet drejt trajtave të qeverisjes së centralizuar dhe despotike.

Analiza e funksioneve të Hyjneshës Dardane sjell në përfundim se kjo ishte sa hyjneshtë e pëlleshmërisë dhe e territorit, aq edhe psikopomp mortal dhe hierofont iniciacistik. Më vonë ajo u zhvillua në një hyj me funksione të ringjalljes së përgjithshme dhe të përjetshmërisë.

Atributet dhe funksionet e shumta të identifikuara të Hyjneshës Dardane, numri i monumenteve që i janë përkushtuar dhe në veçanti prezenca e labirinteve, si pasqyrë e ciklit të jetës dhe të universit, e vënë këtë hyjneshtë në pozitën supreme të panteonit dardan.

Pozita supreme e Hyjneshës Dardane shtron edhe çështjen e rolit fundamental të femrës në shoqërinë dardane, përkatësisht të rëndësisë së parimit femëror në këtë shoqëri, për ç'gjë nuk ka burime të shkruara.

Parimi femëror, si vazhdimësi e kultit të Nënës së Madhe (Magna Mater), nuk është dukuri e panjohur në shoqëritë antike. Dion Kasi dhe Cezari flasin për prezencën e poliandrisë në Britani,²³⁵ gjë që flet për rolin udhëheqës të gruas në shoqërinë antike britanike. Rolin udhëheqës të gruas në shoqërinë kelte e ka konstatuar studiuesja M. Green, e cila shkruan se hyjneshat kelte Nehalennia dhe Epona përfshinin shumë aspekte të jetës: lindjen, zhvillimin, pëlleshmërinë, regjenerimin, mbrojtjen nga demonët e deri te fati i njerëzimit pas vdekjes.²³⁶

Në Istri të Ilirisë, ku deri vonë janë ruajtur traditat e hershme, është evidencuar se dominojnë hyjneshat.²³⁷ Traditat e hershme janë

²³⁵ Dio Cassius, LXXVI 2; Caesar, De Bello Gallico V, 14.

²³⁶ Green, M. (1989) p. 9.

²³⁷ Girardi-Jurkić, V. (2005) Duhovna kultura antičke Istre I, Školska knjiga, Zagreb.

ruajtur deri vonë edhe te shqiptarët përmes kultit të Nënës së Vatrës apo Nënës së Zjarrit. Këtë M. Tirtja e lidh me kultin e të parës së gjinisë, përkatësisht me zotëruesen kryesore të vatrës familjare të periudhave para-monogame. Ky kult shpjegohet si mbeturinë e kultit të nënës, i cili më pas u lidh me Hestinë te grekët dhe me Vestën te romakët.²³⁸

Fuqinë e shumë aspekteve të jetës, siç pasqyrohet sidomos nga monumenti epigrafik i Smirës, e kishte edhe Hyjnesha Dardane (Monum. 1. Fot. 8). Andaj, ajo duhet parë si hyj i lindjes, i pëlleshmërisë dhe i regjenerimit, përfshirë dhe mbrojtjen nga demonët dhe jetën pas vdekjes. Si e tillë, Hyjnesha Dardane përmbledh në vete përmbajtje teogjenike, ktonike, kozmogonike dhe kozmologjike.

Çështje që eventualisht mund të duket e diskutueshme është fakti se Hyjnesha Dardane trajtohet si hyjneshë e diellit dhe se gjendej në krye të panteonit dardan, ndonëse është e gjinisë femërore. Përgjigjja e thjeshtë lidhur me këtë është se raste të tilla ka në shumë kultura të tjera. Kështu, hyjnesha Amaterasu ishte hyjni e diellit në Japoni apo Arina në besimin hetit (Fot. 96).²³⁹ Studimet bashkëkohore po ashtu provojnë se hyjni-femër të diellit kishte edhe në Britani dhe Irlandë, si dhe në kulturat europiane të lashtësisë.²⁴⁰ Shembull i tillë është dhe Nëna Saule e Letonisë, e cila ishte hyjni e diellit.²⁴¹

Studimet e mëtejme duhet të thellojnë njohuritë mbi Hyjneshën Dardane, duke u nisur nga emri i saj, rrjedhimisht a kishte emër të veçantë apo njihej vetëm me emrin *Hyjneshë*. Mbështetur në monumentet epigrafike të hyjneshës, përkushtimi në gjuhën latine *Dea* del si përkthim nga gjuha origjinale e popullatës vendëse. Kështu duket se vepruan dedikantët e monumenteve nga Romula Malva dhe ushtaraku grek në shërbim romak të monumentit nga Smira, duke e përkthyer emrin në latinishte dhe duke e vendosur atë në monumentet e tyre: *Dea*.

Ndërkohë duhet gjetur përgjigje edhe për vendin e hyjnive të tjera në panteonin dardan, përfshirë edhe të tillët që paraqiten në interpretimin e tyre romak. Pozitë të veçantë kishte hyjnia Andin, për

²³⁸ Tirtja, M. (2004) ff. 415 - 416.

²³⁹ Leeming, D. (2005) p. 187.

²⁴⁰ Straffon, C. (1997) *The Earth Goddess: Celtic and pagan legacy of the landscape*, Blandford, London; McGrath, S. (1997) *The Sun Goddess: myth, legend and history*, Blandford, London; Pollack, R. (1997) *The Body of the Goddess: sacred wisdom in myth, landscape and culture*, University of Virginia.

²⁴¹ Motz, L. (1997) p. 1.

funksionet e të cilit nuk ka të dhëna të sigurta, ndërsa hyjnia Tato lidhet me kultin e kalit apo me kultin e kalorësit.

Pa marrë parasysh funksionet e hyjnive me prejardhje dardane, duket se në fazat e mëpasme të zhvillimit, në kohën kur nisnin të sublimohen funksionet e hyjnive, Andini, Tato e hyjtë e tjerë. i subordinoheshin Hyjneshës Dardane.

Për rëndësinë dhe rolin e hyjnive dardanë flet fakti se atyre u ngritën monumente edhe të huajt që shërbyen në Dardani, nëse emrat e paraqitur në monumente tregojnë përkatësinë e vërtetë etnike të dedikantëve. Kështu, monumentin e Hyjneshës Dardane nga Smira e ngriti dedikanti me prejardhje greke dhe dedikanti me prejardhje romake atë të Hyjnisë Andin nga monumenti i Kaçanikut. Sërish duhet thënë se Constitutio Romana dhe fitimi i të drejtës qytetare romake e vë në dyshim prejardhjen e tyre të vërtetë.




Fig. 39.

DEO ANDINO SACRUM. TIBERIVS CLAVDIVS CERTVS
BENEFICIARIUS CONSULARIS LEGIONIS VII CLAVDICE, VOTUM
SOLVIT LIBENS MERITO. CLEMENTE ET PRISCO (CONSULIBUS).³

Foto 62: Monument për kushtuar hyjit Andin (Artur Evans)²⁴²

²⁴² Evans, A. (1884) Antiquarian research in Illyricum, Part III-IV, Wesminster. p. 74.

V. FUQIZIMI I BESIMIT NË HYJNESHËN DARDANE NË PERIU DHËN ROMA KE

Përfshirja e Dardanisë në kuadër të administrimit perandorak romak për disa shekuj solli ndryshime të shumta, duke përfshirë edhe kulturën. Kjo kulturë u njoh në historiografi si kulturë provinciale romake, në të cilën secila provincë romake kishte karakteristikat e veta. Territori Dardan ishte një nga hapësirat ku depërtoi kultura romake, por e cila nuk u përfshi plotësisht nga romanizimi. Kjo nuk u arrit plotësisht as me përvetësimin e tokave të popullatës dardane dhe të formimit të tokave shtetërore (ager publici) dhe tokat municipale (ager municipi) apo të pronave perandorake të revireve xehetare (procuratores metallorum Augusti) dhe të pronave municipale mbi xehet.²⁴³

Mungesa e romanizimit të plotë përgjithësisht shpjegohet me faktin se romakët ishin të interesuar për eksplotimin e pasurive natyrore, me këtë rast dardane, dhe jo për asimilimin e popujve të nënshtruar. Andaj, ndonëse kultura romake ndikoi dukshëm në kulturën autoktone, tradita e lashtë dhe rezistenca e gjatë e dardanëve bënë që këta t'i shmangen romanizimit të plotë dhe, njëkohësisht, të përvetësojnë elemente të shumta të kulturës romake.

Për Hyjneshën Dardane, hyjnitë Andin apo Tato nuk flet asnjë burim i shkruar antik, përkundër faktit se besimi në ta duhet të ketë qenë mjaft i fuqishëm. Kjo mungesë mund të shpjegohet me faktin se autorët antikë, kryesisht me prejardhje greke dhe romake, ofronin shënime vetëm sa u përket interesave të shteteve ku shërbenin dhe më pak merreshin me organizimin shoqëror të të tjerëve dhe aq më pak me besimet dhe ritualet kultore të tyre. Andaj, falë gjetjeve të monumenteve epigrafike dolën në shesh shumë hyjni vendëse, në mesin e tyre edhe Hyjnesha Dardane.

Elementet autoktone të periudhës romake shprehen më së shumti në monumentet relievoe, ato mortore dhe të kultit. Këto monumente prej mermeri apo guri i karakterizon paraqitja skematike

²⁴³ Čerškov, E. (1969) Rimljani na Kosovu i Metohiji, Arheološko Društvo Jugoslavije, Beograd.

dydimensionale, e njohur nga periudha më e hershme përmes monumentit mortor nga Dardana (Kamenica. Fot. 76) apo monumentet nga Rumania (Monum. 2, 3).

Aristokracia vendore, duke mos lënë mënjatë traditën, kultivoi elemente autoktone edhe në monumentet tridimensionale. Këto shprehen në shtatoren e Medianës (Monum. 7), në bustin nga Banja e Klllokotit (Monum. 14),²⁴⁴ dhe në shtatoren nga Theranda / Suhareka (Monum. 15).

Ngjashëm me rajonet e tjera, elementet autoktone shprehen më shumë te veshjet e femrave, të cilat nuk iu nënshtuan plotësisht romanizimit. Versionet e veshjeve të tilla, siç kanë konstatuar edhe studiuesit e tjerë, mbijetuan në veshjet e Kosovës dhe të Shqipërisë Veriore.²⁴⁵

Monumentet epigrafike të periudhës së sundimit romak, kryesisht ato votive (ara) dhe mbivarrore (stella), kanë veçori arkitektonike dhe stilistike që shfaqen si shprehje e shpirtit dhe e kreativitetit dardan, andaj dhe janë quajtur *dardane* (Fot. 93).²⁴⁶ Këto veçohen me edikulë relievo, ku është paraqitur i ndjeri apo të ndjerët me veshje dardane. Mbi edikulë është vendosur shpesh edhe boça e pishës, simbol i ngadhënjimit të jetës mbi vdekjen.

Në fund të stellave gjendet një enë, kryesisht në trajtë kantarosi. Nga kantarosi, i cili në botën antike simbolizonte burimin e jetës, mbijnë hardhia e rrushit (lat. *vitis vinifera*) dhe dega e lerthit (lat. *hedera*), të cilat në vazhdimësi ishin simbole të ringjalljes. Fusha e mbishkrimit është e thelluar, e profilizuar shumëfish dhe e kurorëzuar me motiv vezak apo atë të litarit të stilizuar.

Kultivimi i traditës shpirtërore dhe materiale dardane gjatë periudhës së sundimit romak u shpreh edhe në mënyrën e varrimit. Kështu, më se katër shekuj pas lënies së varrimit në tuma, ngritja e sërishme e tumave u ringjall në shekujt II-III. Të tilla janë varret tumulare në lokalitetet *Cernica* dhe *Arat e Çerkezit*, që të dyja pranë Ulpianës antike (Kosovë),²⁴⁷ si dhe tuma e Komoranit të Drenicës (Kosovë).²⁴⁸

²⁴⁴ Për shkak të mungesës së mbishkrimit u quajt më parë *Busti i gruas nga Klllokoti*.

²⁴⁵ Wilkes, J. (1992) p. 229.

²⁴⁶ Papazoglu, F. (1969) p. 156.

²⁴⁷ Srejić, D. (1986) p. 179 - 187. Përkatësinë thrakase e vë në dyshim edhe vetë autori.

²⁴⁸ Hulumtimet e Muzeut të Kosovës (1975). I udhëhoqi autorja.

Subjektiviteti i hershëm i Dardanisë pararomake, lulëzimi kulturor dhe tradita e krijuar e entitetit dardan, paralajmërojnë pranimin e manifestimeve të jashtme të kulturës romake, ndërsa vetëm studimet më të thella do të mundësojnë të kuptohet se në çfarë mase ajo ka arritur të depërtojë në qenien dardane.²⁴⁹

Gjatë periudhës romake u zhvillua edhe një lëvizje e kulteve dhe e hyjnive të ndryshme, të cilat kryesisht përmes ushtarëve, tregtarëve dhe përcjellësve të tyre arritën në Dardani nga pjesë të ndryshme të perandorisë së gjerë romake. Të tillë ishin hyjnitë romake Jupiteri, Minerva, Furtuna (mbrojtëse e familjes së furijve të Ulpianës), Merkuri dhe Diana; hyjnitë që vinin nga lindja, si Mitra, Izida, Serapisi dhe Jupiter Doliheni dhe ata helenë si Nemezisi, Dionisi, Hekata apo Asklepi, Higia dhe Telesfonti. Orfeu ishte po aq prezent dhe ky, ndonëse me prejardhje trakase, ishte pjesë e vargut të hyjnive prezente gjatë periudhës romake.

Paraqitja më e shpeshtë e monumenteve të Hyjneshës Dardane nga shekujt II-III duhet të lidhet më mëtimet për kthim të traditave të mëhershme. Kjo dukuri ishte prezente në gjithë perandorinë romake, e krijuar nga kriza e përgjithshme dhe nevojat për reforma. Në Dardani lidhet edhe me bashkëngjitjen administrative të saj me Provincën e Mezisë në shekullin I, rezistencën dardane ndaj sundimit romak dhe të nevojës për sforcimin e identitetit dardan, në prag të krijimit të Provincës së Dardanisë.

Fuqia e dardanëve bëri që perandoria romake të dërgonte katër legjione romake për ta pushtuar definitivisht Dardaninë. Sipas burimeve antike, një legjion refuzoi të nisej nga Durrësi për në Dardani *i frikësuar nga dardanët*.

Dardanët i rezistuan administrimit romak edhe rreth tre shekuj pasi që u gjetën nën administrimin romak, sidomos përmes latronëve dardanë (latrones dardanici). Si rezultat, romakët u detyruan që ta krijonin Provincën e Dardanisë, tre shekuj pas pushtimeve romake.

Rezistenca dardane ndaj sundimit romak është e ndërlidhur me ekzistimin e shtetit të fuqishëm të Dardanisë gjatë shekujve IV - I

²⁴⁹ Tradita e ruajtur nxit që të mos duket plotësisht e rastit që nga Dardania dolën perandorë të njohur romak dhe bizantin, si Mark Aurel Klaudi (268 - 270), Konstantini i Madh (306 - 337), Justini (518 - 527) dhe Justiniani (527 - 565).

p.e.r., të përvojave luftarake të ushtrisë së saj dhe të krijimit të një identiteti të qëndrueshëm. Si pjesë e patjetërsueshme e identitetit dardan ishte edhe Hyjnesha Dardane dhe besimi në fuqitë hyjnore të saja. Këto u kultivuan më parë dhe u sforcuan sidomos kur kishte nevojë për traditat e mëparshme identitare.

Pjesë të identitetit shpreh dhe shtatorja e Medianës (Monum. 6. Fot. 16), e cila përmban koncept ikonografik të ngjashëm me atë të Romula Malvës (Monum. 2. Fot. 9) dhe të Brantiqit të Poshtëm (Monum. 7. Fot. 17) dhe që nuk është pjesë e konceptit ikonografik romak. Kjo tregon se është fjala për një koncept të standardizuar dhe të njohur për dardanët, jashtë traditës romake.

Analiza e dedikuesve të monumenteve që i janë përkushtuar Hyjneshës Dardane shtron pyetjen se a ishin këta dardanë apo kishin prejardhje të huaj. Këto aspekte kërkojnë analiza më të thella, por me këtë rast do të përkujtohet ndarja e të drejtës qytetare romake e dhënë përmes *Constitutio Antoniana* (viti 212), që është një akt i rëndësishëm historik, pa të cilin mund të nxirren përfundime të gabuara lidhur me prejardhjen e dedikuesve. Në këtë drejtim duhet pasur parasysh se ky akt ndikoi në zbehjen e antroponimisë vendëse dhe zëvendësimin e saj me atë latine. D. Rendić-Miočević me të drejtë thekson se kështu:

...u zhdrukën dallimet formale midis peregrinëve dhe qytetarëve të mëhershëm romakë të perandorisë, gjë që ndikoi dhe në onomastikë.²⁵⁰

Nëse kihen parasysh proceset e caktuara, në veçanti dhënia e të drejtës romake, atëherë edhe prejardhja e Tiberius Claudius Certusit, i cili ia përkushtoi arën e Kaçanikut hyjnisë Andin, si edhe të tjerëve, mund të jetë edhe vendëse. Por, perjardhje të sigurtë dardane, ndonëse larg vendlindjes, kanë tre dedikantët nga Romula Malva, të cilët i përkushtuan monumente hyjneshës së tyre të çmuar, duke lënë në trashëgimi edhe përfytyrimet e rëndësishme figurative të saja.

Monumente me përfytyrime të Hyjneshës Dardane sigurisht ka pasur në territorin dardan, të ngjashme me monumentet votive të periudhës romake të punuara në mermer apo në gur, që nuk janë

²⁵⁰ Rendić-Miočević, D. (1967) p. 151.

zbuluar ende, apo dhe si monumente pararomake, gurore dhe të pazbuluara ose të punuara në dru dhe jo rezistente ndaj kohës.

Krahas kësaj hyjneshe, sipas monumenteve epigrafike, janë paraqitur dhe hyjnitë Andin apo dhe Tato e Atte. Monumente epigrafike me përkushtim ndaj hyjnisë Andin janë zbuluar deri më sot vetëm dy, një në Kaçanik²⁵¹ dhe tjetri në Vushtrri.²⁵²

Çështja e prejardhjes së hyjnisë Andin ka marrë zgjidhje me prejardhjen dardane, ndonëse kishte hezitime për përcaktimin epihorik të tij.²⁵³ Emri Andin është i përhapur tek ilirët, në Dalmaci dhe në pjesën qendrore ilire, dhe është dëshmuar si hyj vetëm te dardanët.²⁵⁴

M. Mirković mendon se Andini ka mundur të jetë hy-totem dhe se emri iu është dhënë individëve të të njëjtit klan.²⁵⁵ Mendimin se hyjnia Andin është pjesë e hyjnive epihorik dardan e kanë shprehur A. Mayer²⁵⁶ dhe W. Tomaschek, i cili etimologjinë e këtij teonimi e gjen në fjalën shqipe andje: ánde.²⁵⁷

M. Garašanin pohon se hyjnia ka karakter të padyshimtë lokal ilir dhe se mund të identifikohet me hyjninë Vidasus Magla apo me Silvanin në *interpretatio romana* të tij.²⁵⁸

Studiuesit H. Krahe dhe A. Mayer, duke folur për besimin e ilirëve në hyjninë e pëlleshmërisë dhe të vegjetacionit, pohojnë se fiset e ndryshme ilire i quanin me emra të ndryshëm dhe se *dardanët e*

²⁵¹ Evans, A. (1885) p. 74, Fig. 39; Mommsen, Th. CIL III 8184; Mirdita, Z. (1981a) f. 246, nr. 205; Mócsy, A. (1970) f. 243.; Mócsy, A. (1974) p. 254. Deo Andino/sevir[aug(ustalis?)]/sac(rum) Tib(erius)/Cl (adius) Certus/b(e)n(e)ff(iciarius) co(n)s(ularis) leg(ionis) VII Cl(audiae) v(otum) s(olvit) l(íbens) m(erito) Clem(ente) et Prisco co(n)s(ulibus).

²⁵² Evans, A. (1885) p. 74, fn. a; Papazoglu F. (1969) f. 173; Mirdita, Z. (1981) f. 246, nr. 205.

²⁵³ Patsch, C. (1900) *Die Lika in römischer Zeit*, Schriften der Balkankommission, Antiquarische Abteilung, 1. Wien, p. 66; Krahe, H. (1955) *Die Sprache der Illyrier*, Wiesbaden, p. 80, nr. 54 dhe 40, nr. 31; Marić, R. (1933) *Antički kultovi u našoj zemlji*, Zadužbina Luke Čelovića-Trebinjca, Beograd, p. 133; Čerkov, E. (1969) p. 69.

²⁵⁴ Mirdita, Z. (1981) f. 82.; Papazoglu, F. (1969) 173; Papazoglu, F. (1978) p. 226.

²⁵⁵ Mirković, M. (2002) *Anthropology and Epigraphy – the Case of Central Balkan Region*, Provinciae imperii romani inscriptionibus descriptae, Acta II, Iniversitas de Barcelona, Barcelona, p. 968.

²⁵⁶ Mayer, A. (1957) p. 45.

²⁵⁷ Tomaschek, W. (1885) *Die Wege durch die Persische Wüste*, Wien IX, p. 99.

²⁵⁸ Garašanin, M. (1967) p. 182.

quanin Andinus.²⁵⁹ A ishte ky hyj i pëlleshmërisë dhe i vegjetacionit është çështje për analiza të mëtejme, pasi që dy monumentet e zbuluara nuk ofrojnë mundësi që të përcaktohen funksionet e hyjit Andin.

Duket se i traditës më të hershme i përket dhe kulti i kalorësit. Kali, si një nga simbolet e kultit të diellit,²⁶⁰ paraqitet në trajtë të hyjnisë hero-kalorës, mbase dhe si hyj mbrojtës i kalorësisë dardane. Të tillë duhet parë hyjninë Tato, të dëshmuar nga monumenti epigrafik i Bulesovcit të Vranjës (Serbi).

Kulti i kalit dhe i kalorësve duket edhe si interpretim i hyjnive vendëse, të *Kalorësve danubianë*, të *Kalorësit trakas* dhe të hyjnisë trakase Zbeltiurdit. Monumenti i kushtuar hyjnisë Tato mundëson që heroi-kalorës të shihet dhe si hyj dardan /ilir.²⁶¹

Prezenca e hyjnive vendëse gjatë periudhës së sundimit romak dëshmon edhe mbijetesën e botës materiale dhe më shumë shpirtërore dardane pararomake. Natyrisht, prezenca e romakëve dhe e të tjerëve nga pjesët e ndryshme të perandorisë kishin ndikime dhe i përfshinë edhe dardanët në makrokozmin e llojlojshëm romak.

Në Dardani mbijetuan një kohë të gjatë besimi pagan dhe besimi i krishterë. Besimi pagan në krye me Hyjneshën Dardane ishte shprehje e traditës, e fuqisë dhe e namit të dikurshëm dardan.

Besimi në Hyjneshën Dardane ishte në lidhshmëri të ngushtë me diellin, andaj leximi i kompozicionit të labirintit rrethor të Smirës më qartë shpalos botëkuptimin dardan mbi ekzistimin e një qarku jetësor, mikrokozmetik dhe makrokozmetik, i cili kishte një qendër, rrjedhimisht një cak të mëtuar. Në qendër gjendej dielli, urtia dhe ndriçimi, pra vetë hyjnesha. Me një botëkuptim të tillë u krijuan parakushte për përqafimin e krishterimit, të personifikuar përmes Krishtit dhe të parë si Diell i pamposhtur apo *Sol Invictus*.²⁶²

²⁵⁹ Krahe, H. (1955) p. 80; Mayer, A. (1957) p. 45.

²⁶⁰ Shih: Green, M. (1991) pp. 23 - 27.

²⁶¹ Suić, M. (1961) *Ilirski Deus Patrius*, Starinar XI, Beograd, p. 94.

²⁶² Për rolin e labirintit dhe transformimet në labirinte të krishtera: Doob, P. (1990).

VI. QIELLVROJTUESIT DARDANË DHE OBSERVATORI PARAHISTORIK

Arkeo-astronomia dhe astronomia antike janë fusha të pahulumtuara në territorin dardan, madje dhe ilir e më gjerë. Si rezultat i mungesës së studimeve të veçanta, duket se pa të drejtë është mohuar dhe prezenca e kozmologjisë dhe kozmogonisë dardane. Si pasojë, këta u panë larg nivelit të zhvillimeve të qytetërimeve të hershme, madje edhe kelt apo trakas.

Me këtë rast duhet përkujtuar se qielli ishte fushë vështrimi të të gjitha grupimet njerëzore që nga parahistoria e hershme. Ndryshimi dhe errësimi i qiellit, lëvizjet e trupave qiellorë dhe të yjeve, vetëtimat dhe bubullimat ishin enigmë në vete, joshës dhe të dobishëm, por edhe frikësues. Si rrjedhim, popujt e kohëve dhe të hapësirave të ndryshme krijuan vrojtues të veçantë të qiellit, të cilët u panë si astronomë të kohës. Vrojtimit e tyre të qiellit ndihmuan edhe për krijimin e ceremonive rituale dhe religjioze²⁶³ dhe, pos të tjerash, që të zhvillohej vizioni mbi universin / kozmosin.

Studimet arkeo-astronomike, pos që kanë dëshmuar vrojtimit qiellore të popujve të lashtësisë, këto kanë sjellë edhe mënyrat sesi janë kuptuar fenomenet qiellore, si janë shfrytëzuar dhe çfarë ndikimi kishte qielli në kulturat e hershme.²⁶⁴ Në këtë drejtim, arkeo-astronomia dallon nga etno-astronomia, e cila bën studime antropologjike të qiellvrojtimit të shoqërive bashkëkohore.

Siç thotë E. Handingham, njohuritë e pashkruara parahistorike nuk kanë kontribuar në ngritjen e shkencës, por as influenca e tyre nuk ka kaluar pa asnjë gjurmë.²⁶⁵ Në këtë kontekst duhet parë edhe astronomët dardanë, vrojtimit e të cilëve lanë gjurmë në observatorin e Kokinos, si dhe, në veçanti, në labirintin rrethor të Smirës.

²⁶³ Handingham, E. (1984) *Early Man and Cosmos*, Walker and Company, New York, p. 7.

²⁶⁴ Bostwick T. W.- Bates, B. (2006) *Viewing the Sky Through Past Present Cultures*, Oxford VII International Conference on Archaeoastronomy, Museum Anthropological Papers 15, Pueblo Grande, p. 13.

²⁶⁵ Handingham, E. (1984) p. 24.

Popuj të shumtë e kanë paramenduar qiellin, më pas universin, si vendbanim të hyjnive. Aristoteli shkruan se është diçka pas trupave që janë në tokë, diç te j toke, ajri, zjarri dhe uji, e ndryshme dhe e ndarë prej tyre, dhe se fama e saj rritet me rritjen e distancës së saj nga bota jonë. Ky është *trupi primar*, eternal dhe i pandryshueshëm, në të cilin i vendos hyjnitë e pavdekshme. Këtë univers të largët e që lëviz përherë, e quan *eter*, sepse në të nuk bëhen ndryshime. Ai nuk mendon së universi apo yjet janë hyjni, por se ata janë *si* hyjni për nga virtytet e natyrës së tyre të pandryshueshme, përderisa në tokë ndryshimet gjenden kudo: të gjallët lindin, transformohen dhe vdesin, xehet shndërrohen në metale apo uji tjetërsohet.²⁶⁶

Diviniteti dhe rregullsia e lëvizjeve në qiell kanë shërbyer si fakte se këto rregullojnë ose, së paku, mund të ndikojnë në ndryshimet në tokë. Këtu shihet ndërlidhshmëria midis religjionit, astronomisë, astrologjisë dhe profetizimit, me pikëtakime të stërlashta dhe që lanë gjurmë në objekte të ndryshme.

Si shembull i ndërlidhjes së religjionit dhe astronomisë merret freska e varrit etrus të quajtur *Varri i Augurëve* (530 p.e.r.), ceremoninë e së cilës e përshkroi Z. Mayani. Në të janë paraqitur dy priftërinj që i trasojnë kufijtë e hapësirës së shenjtë në trajtë katrori, si një lloj pasqyre e gjithësisë, ndarja e së cilës përputhet më ndarjen konceptuale të qiellit. Çdo katror i brendshëm shënon një hyjni të veçantë dhe nga zona e katrorit, ku binte shenja qiellore, përcaktohej se cili hyj dërgonte shenjë. Në të hapësira e shenjtë apo tempulli ishte edhe një lloj observatori.²⁶⁷

Dëshmi të shumta ekzistojnë rreth interesimit dhe vrojttimeve të lëvizjeve të diellit e të hënës që në parahistorinë e hershme te shumë popuj. Këto lidheshin me çështjet e sigurimit të ekzistencës dhe të kulteve të ndërlidhura me diellin dhe hënën, trupa qiellore që në horizont dalin në pozicione të ndryshme.

Kështu dielli, në kuadër të një viti kalendarik, ngrihet nga pozita më jugore e horizontit në dimër (solstici dimëror, 22 dhjetor), pastaj lëviz në drejtim të veriut dhe ngrihet nga lindja (solstici veror: 21 mars) dhe vazhdon të lëvizë nga veriu dhe lind nga pika më veriore e

²⁶⁶ Aristotelis, De caelo, 269b12-16, 270b1-23.

²⁶⁷ Mayani, Z. (1961) Les Étrusques commençant parler, Arthaud, Paris, pp. 222 - 224.

horizontit (21 qershor). Pas këtyre lëvizjeve kthehet pas dhe lind sërish nga lindja (ekuinox vjeshtor: 23 shtator) dhe e kompletton ciklin e lindjes në pikën e solsticit dimëror (22 dhjetor).

Kur kihen parasysh shembujt e shumtë nëpër botë, imponohet pyetja vijuese: A kishin dardanët qiellvrotues dhe observatore? Përgjigjja do të duhej të ishte se kishin, porse studimet në këtë drejtim nuk janë zhvilluar. Një hap është bërë me zbulimin e observatorit parahistorik të Kokinos pranë Kumanovës (IRF e Maqedonisë), i cili sipas Agjensionit Amerikan të Hapësirës (NASA, 2005) u rendit si observatori megalitik parahistorik i katërti në botë.²⁶⁸

Observatori u zbulua 38 km në lindje të Kumanovës, te potezi i quajtur sot *Tatiçev Kamen*. Sipas studimeve paraprake u shfrytëzua për vrojtimin e lëvizjeve të diellit dhe të hënës që nga mijëvjeçari II p.e.r. (1900-1500).²⁶⁹

Lokaliteti arkeo-astronomik gjendet në majë të një kodre shkëmbore neo-vulkanike, në lartësi prej 1013 m. Ka dy nivele, me rreth 90 m gjatësi dhe 50 m gjerësi. Disa frone të skalitura në shkëmb dhe të drejtuara nga lindja, kanë pozitë dominuese mbi gjithë lokalitetin. Pos të tjerash, këto tregojnë se është fjala për një vend të shenjtë, në të cilin janë bërë njëkohësisht qiellvrotime dhe rituale të kultit.

Gjatë gërmimeve arkeologjike në platformën e epërme (2001) është zbuluar shtresa e epokës së bronzit, me fragmente të qeramikës, peshoja balte të pjekur, mprehëse prej guri dhe shumë eshtra shtazësh. Është me interes të ceket se në mesin e zbukurimeve të qeramikës gjenden ornamente të gërricura me paraqitjen e diellit me rreze dhe me vija të valëzuara nën të (Fot. 64).²⁷⁰

²⁶⁸ Kuzmanovska-Barandovska, O. – Stankovski, J. (2011) *The Role of Astronomical Alignments in the rituals on the peac sanctuary at Kokino, Macedonia*, Journal of Astronomical History and Heritage 14(3), Oxford, p. 222; Cenev G. (2006) *Megalithic Observatory Kokino*, astronomical Observatory 80, Belgrade, pp. 313 - 317.

²⁶⁹ U evidencua nga arkeologu Jovica Stankovski dhe astro-fizikani Gorge Cenev. Toponimi *Tatiçev Kamen* është çështje që duhet trajtuar, nëse shihet në lidhshmëri me hyjin Tato (Deo Tato) nga monumenti epigrafik i Bulesovcit të Vranjës: Suić, M. (1961) *Ilirski Deus Patrius*, Starinar XI, Beograd.

²⁷⁰ Kuzmanovska-Barandovska, O. – Stankovski J. (2011) *The Role of Astronomical Alignments in the rituals on the peac sanctuary at Kokino, Macedonia*, Journal of Astronomical History and Heritage 14(3), Oxford, pp. 221 - 229, Fig 1.




Foto 63: Observatori parahistorik i Kokinos (ICOM Makedonia)


Në observatorin e Kokinos është konstatuar shënjueti qendror prej guri dhe ato ndihmëse, të cilat kanë ndihmuar shënjimin e të gjitha pikave karakteristike të lëvizjeve të diellit dhe të hënës në horizontin e lindjes. Kështu, bëhej vrojtimi i pozitave të diellit gjatë solsticit veror dhe dimëror dhe të ekuinoksit vjeshtor dhe të atij pranveror.²⁷¹ Ky observator ka shërbyer për përcaktimin e kohës së të korrave dhe të datave të tjera, të rëndësishme për jetën e njeriut.

Observatori megalitik i Kokinos dëshmon se që në epokën e bronzit, mbase dhe më herët, janë zhvilluar qiellvrojtimet e organizuara dhe me këtë edhe dijet kozmologjike. Kjo shpreh një shkallë më të përparuar kulturore dhe të organizimit shoqëror të shfrytëzuesve të saj. Meqë Dardania përfshinte edhe Kumanovën e sotme me rrethinën e saj, nënkuptohet se bartësit kryesorë të saj ishin dardanët. Në këtë drejtim, labirinti unik rrethor i qarkut të mbyllur i Smirës mund të shihet si rezultat tejet i avancuar i dijeve të fituara dardane.

²⁷¹ Kuzmanovska-Barandovska, O.–Stankovski, J. (2011) pp. 221 - 229; Cenev, Gj. (2006) pp. 313 - 317.



*Foto 64: Fragment ene me motive të diellit, Kokino
(Kuzmanovska - Stankovski)*



*Foto 65: Perëndimi i diellit, Kokino
Foto 66: Shënjesi në Kokino (Fot. M. Kavesna)*



Foto 67: Froni në observatorin e Kokinos

VII. KOZMOLOGJIA – KOZMOGONIA DARDANE

Kozmologjia shihet si shkencë mbi origjinën dhe strukturën e universit, studim i universit fizik i konsideruar si totalitet i fenomeneve në kohë dhe hapësirë apo studim astrofizik i historisë, strukturës dhe dinamikës konstituente të universit. Kozmogonia trajton origjinën e universit ose varg idesh mbi origjinën e universit.²⁷² Ambiguiteti midis kozmologjisë dhe kozmogonisë është ende prezent, andaj argumenti kozmologjik i teologjisë për ekzistimin e Zotit lidhet teknikisht me idetë kozmogonike.

Bazë e shumë kozmogonive është ‘sakrifica kozmike’, e cila paraqet idenë se krijimi i formave dhe i çështjeve mund të realizohet vetëm me modifikimin e energjisë paramordiale dhe ky modifikim te popujt më primitivë dhe ata protohistorikë ka qenë tejet i dhembshëm. Pastaj, në kozmogoninë babilonase mori formën e vrasjes së hyjnisë Tiamat (dragua), ndërsa në Persi sakrifikohej demi përmes Ahrimanit apo Mitrës. Kështu u krijua ideja qendrore se nuk ka krijim pa sakrificë dhe as jetë pa vdekje.²⁷³

A u zhvillua apo jo kozmologjia dhe kozmogonia te Dardanët është një prej pyetjeve që detyrimisht parashtrohet para studiuesit. Një ndër burimet për njohjen e botëkuptimeve në të kaluarën janë mitet, të cilat ofrojnë edhe përfytyrimet e kohës mbi universin. Për shoqëritë para-moderne miti funksionoi dhe si proto-shkencë, duke ofruar shpjegime për fenomenet fizike, të cilat i rrethonin dhe që ndikonin dukshëm në jetët e tyre, përfshirë ndërrimet e motit dhe ciklin e jetës të shtazëve dhe të bimëve.²⁷⁴

Cilat ishin mitet e dardanëve? Cili ishte miti i krijimit? Këto dhe shumë pyetje të tjera dalin si sfida para studiuesve, aq më tepër që gjenden te të gjitha grupacionet dhe kryesisht nisin me fjalët: *Në fillim ishte...*

Duke pasur parasysh se mitet e krijimit te grekët, romakët e

²⁷² Longman (2000) *Advanced American Dictionary*, Pearson Education Limited, Harlow-Essex, pp. 315 - 316.

²⁷³ Shih: Cirlot, J. (1971) p. 64.

²⁷⁴ Campbell, J. (1965) p. 4.

popujt e tjerë të lashtësisë janë mjaft të njohura, me këtë rast përmenden vetëm disa të tjera.

Miti fenikas:

*Në fillim ishte vetëm errësirë dhe kaos...*²⁷⁵

Miti kelt:

Në fillim Kupa qiellore dhe Toka ishin kaq pranë sa nuk kishte vend për Krijim...

Miti pellazg:

*Në fillim, Eurynome, perëndesha e gjithçkaje, doli e lakuriq nga Kaosi, por nuk gjeti asgjë përposh këmbëve që të rrinte, prandaj, duke vallëzuar vetëm në dallgët e tij, ndau detin nga qielli. Ajo vallëzoi drejt jugut dhe era e vënë në lëvizje prapa saj, dukej si diç e re dhe e veçantë, me të cilën fillon një vepër e krijimit.*²⁷⁶

Përgjigje mbi mitin e krijimit dhe prezencën e kozmologjisë dardane deri më sot ende nuk janë dhënë. Wilkes mendon se ilirët, në kuadër të cilëve i përfshin edhe dardanët: *...nuk kanë zhvilluar një kozmologji uniforme... mbi të cilën është përqendruar praktika e tyre religjioze.*²⁷⁷ Qëndrimet e tilla janë të natyrshme nëse nuk disponohet

²⁷⁵ Leeming, D. (2010) p. 78, p.225.

²⁷⁶ Graves, R. (1957) pp. 17 - 18. Graves u mbështet në shënimet e Apollonius Rhodius (*Argonautika*). Pjesë të adoptuara nga përkthimi i Brikena Ismajlit nga anglishtja: Miti rrëfen sesi Eurynome kapet për erë të veriut e vallëzon për t'u ngrohur, ndërsa gjarpri Ofion i mbështillet rreth gjymtyrëve. Era e veriut Boreas e fekondon dhe kjo ngjiz një krijesë. Pastaj mori formën e pëllumbit, ngrohu vezët në dallgë dhe lëshoi Vezën Universale rreth së cilës Ofioni u rrotullua shtatë herë, lëvozhga u nda më dysh dhe dolën fëmijët, dielli, hëna, planetët, yjet, toka me malet dhe lumenjtë, pemët, barishtet dhe gjallesat. Eurynome dhe Ofion ngritën shtëpi mbi Malin Olimp, por kur ai pretendoi se ishte krijuesi i Universit ia vulosi kokën me thundër, ia nxori dhëmbët dhe e la në shpellat e errëta të nëntokës. Eurynome pastaj krijoi shtatë fuqitë planetare dhe në to vendosi nga një Titane dhe një Titan: Theia dhe Hiperion për Diellin; Febe dhe Atlas për Hënë; Dione dhe Krius për Marsin; Tetis dhe Oqeani për Venusin; Rea dhe Kronus për Saturnin. Njeriu i parë ishte Pelasgusi, i ngjizur nga balta e Arkadisë.

²⁷⁷ Wilkes, J. (1992) p. 165.

dhe nuk analizohen të gjitha burimet e mundshme, veçanërisht ato arkeologjike.

Gjatë trajtimit të zhvillimit të kozmologjisë dhe të kozmogonisë, duhet pasur parasysh studimet e C. Ruggles, i cili konstaton se *duke e kërkuar rregullin kozmik "astronomët–priftërinjtë" i vrojtonin pozitat e yjve të ndritshëm për shekuj me radhë... Yjet kishin rol thelbësor për përcjelljen e ciklit të vegjetacionit dhe për organizimin e aktiviteteve bujqësore... dhe se këto, si dhe kalendarët e hershëm, sollën zhvillimin e astronomisë...*²⁷⁸

Zhvillimet e paraqitura nga C. Ruggles pohohen dhe nga shumë studiues të tjerë, të cilët kanë arritur në përfundim se agrikultura siguronte prodhim të rregullt të bimëve me ritëm natyror vjetor, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konstante është i lidhur me kalendarin, rrjedhimisht me pozitat e trupave qiellorë.²⁷⁹ Në këtë drejtim duhet cekur se nuk ka asnjë arsye që dardanët të shihen si të pazhvilluar, të mos kishin pasur priftërinj, madje as të mos e kishin vrojtuar qiellin në mënyrë të organizuar, së paku për nevojat e tyre bujqësore.

Para se të vihen në pah të dhënat e paralajmëruara, duhet të përkujtohen edhe studimet e J. A. Belmonte, i cili shkruan:

*Interesimi i popujve të lashtë për objektet e ndryshme në qiell ishte thellë i ndikuar nga besimet e tyre religjioze, nga struktura shoqërore dhe nga nevoja për të prodhuar më shumë ushqim dhe për të pasur më shumë shëndet. Cikli i pafund i diellit, i hënës dhe i yjve krijonin ndjenjën e sigurisë dhe riparaqitja e tyre kontinuitive në të njëjtën pozitë në qiell premtonte rilindjen e ciklit të lindjes dhe të vdekjes në natyrë.*²⁸⁰

Vrojtimit e tilla të natyrës, si dhe te popujt e tjerë, gjithsesi kanë qenë pjesë e jetës së dardanëve.

Numrin e simboleve të shumta në objektet arkeologjike dardane, kur kihet parasysh mendimi i C. Ruggles se *unioni i qiellit dhe i tokës reflektohej në botën tokësore dhe hyjnore*, duhet parë si refleksion të këtyre botëve. Për këtë mbase duhet parë në aspekt më të gjerë

²⁷⁸ Ruggles, C. (2005) *Ancient Astronomy: An Encyclopedia of Cosmologies and Myths*, ABC-CLIO, Santa Barbara.

²⁷⁹ Cirlot, E. (1971) p. Xvii.

²⁸⁰ Belmonte, J. (2010) *Finding our place in the cosmos: the role of astronomy in ancient cultures*, *Journal of Cosmology* 9, 2052 – 2062.

paraqitjen e viçit në gjirin e Hyjneshës Dardane nga Mediana, sepse viçi konsiderohet si nismëtar i kozmogonisë dhe se nga gjaku i tij nis jeta e re.

Labirinti rrethor i Smirës, ndonëse i vitit 211, është shprehje e rrënjëve më të thella të qëndrimeve dardane mbi rregullin kozmik, andaj këtë duhet parë si tregues edhe të njohurive kozmologjike dardane. Kjo provohet nga prezenca e observatorit parahistorik të Kokinos, si dhe me dy monumentet e gjetura jo shumë larg territorit, Scripta e Danubit të Ballkanit (rreth vitit 3500 p.e.r.) dhe ajo e Karanovës të Bullgarisë (rreth vitit 3000 p.e.r.). Megjithëkëtë, përfytyrimin dardan të rendit kozmik duhet parë së paku nga shekulli IV p.e.r., ndonëse materializimi i tij ndeshet në labirintin rrethor të Smirës të vitit 211.

Zhvillimi i konceptit kozmologjik lidhet ngushtë me besimin në përjetësi. Ky besim shprehet përmes qasjes ndaj vdekjes, për të cilën D. Kurtz dhe J. Boardam me të drejtë thonë se është njëra ndër traditat më konservative të njeriut dhe se të gjallët i respektojnë dhe i nderojnë të vdekurit.²⁸¹

Popujt e lashtësisë kanë besuar në udhëtimin e shpirtit të vdekurit për të arritur në cak, andaj dhe shumë prej tyre krijuan dhe udhëzime për këtë rrugëtim, siç ishte *Libri i të vdekurve* në Egjipt, *Libri Acheruntia* e etrurëve apo tabelat orfike.²⁸²

Në fillim mendohej se të vdekurit shkonin në dhe (bota e nëndheshme) dhe tek më vonë u zhvillua botëkuptimi se këta shkonin në qiell.²⁸³

Udhëheqësit e mistereve orfeike ishin të parët, të cilët e ndanë botën e nëndheshme në dy pjesë: në Fushat e Eleuzinës, ku vendoseshin shpirtrat e mirë, dhe në Tartarus, ku shkonin shpirtrat e këqij.²⁸⁴ Gjykuar nga prezenca e mozaikut të Orfeut në Gllamnik, ky botëkuptim ishte prezent edhe te dardanët.

Pasi që misteret, siç ishin ato të Eleuzinës, Orfeut, Mitrës e të tjera, paramendohej se ndihmonin udhëtimin për në përjetësi, shtrohet

²⁸¹ Kurtz, D.–Boardam, J. (1971) pp. 141 - 141.

²⁸² Cummont, F. (1922) p. 149.

²⁸³ Cummont, F. (1922) p. 153.

²⁸⁴ Cummont, F. (1922) p. 171.

pyetja se çka u zhvillua dhe çka dominoi tek dardanët. Përgjigje për këtë nuk mund të merret nga burimet e shkruara, pasi që nga doket dardane është ruajtur vetëm e dhëna mbi larjen ceremoniale dardane gjatë tri ngjarjeve më të rëndësishme të jetës. Në këtë të dhënë, shpesh të keqinterpretuar, autori antik Aelianian shkruan:

*Kam dëgjuar se dardanët e Ilirisë lahen vetëm tri herë gjatë gjithë jetë së tyre... kur lindin, kur martohen dhe kur vdesin.*²⁸⁵

Përderisa për doket e lindjes dhe të martesës nuk ka të dhëna, doket e vdekjes të periudhës pararomake shfaqen te monumenti mortor i Dardanës (Fot. 76), nga mënyra e varrimit dhe të objekteve, të cilat janë vendosur në varret e periudhës pararomake. Këto dëshmojnë se dardanët i kushtonin vëmendje të veçantë jetës së tejbotshe, ngjashëm me shumë popuj të tjerë të lashtësisë.

Nga monumenti i Dardanës kuptohet se pjesë e ritualit të varrimit ka qenë vallëzimi mortor apo vallëzimi hyjnor, i realizuar nga valltaret, si dhe gjëma e meshkujve, e përcjellë me shkëlqen e flokëve. Po ashtu bëhet e njohur se në shtëpinë e përbotshe të vdekurit janë dërguar në arka të hapura, të cilat janë bartur mbi supe nga meshkujt.

Prezenca e priftëreshës në krye të kortezhit funeral në monumentin mortor të Dardanës dhe dora e saj që prek arkën e ushtarakut të vdekur, nënkuptojnë bartjen e shpirtit të të vdekurit në sferat e amshueshme, ndërsa vallëzimi mortor e mbështet edhe e lehtëson këtë bartje (Fot. 79).

Objektet e vendosura në varre janë po aq dëshmi mbi besimin dardan në përjetësi dhe se rrugëtimin e personit të vdekur në jetën e amshimit e lehtësonin objektet e caktuara të vendosura në varre e që shërbenin si pagesë për kalimin prej një sfere të jetës në tjetrën. Të tilla ishin sëpatat,²⁸⁶ si dhe në veçanti disqet si simbole të drejtpërdrejta të diellit, të cilat u gjetën në varret e Shirokës dhe të tjerat.²⁸⁷

Shufrat e gjata prej hekuri nga Tuma I e Romajës së epokës së hekurit dëshmojnë se dardanët që më parë kishin krijuar konceptin

²⁸⁵ Claudii Aeliani, *Varia historia* IV, 1; Nicolaus Damascenus, *Fragmenta*, 145, 2.

²⁸⁶ Varëse në trajtë sëpate dyteheshe, Gadimja e Epërme: Katalog arkeologjik (2013) f. 153, Fot. 202.

²⁸⁷ Emërtimi i këtyre objekteve si *pulla* është joadekuat, si dhe termi *kopse*, siç figuron tash së voni: Katalog arkeologjik (2013) f. 145, Fot. 186.

mbi jetën e tejbotshme dhe se për t'u pranuar në të e bënin pagesën me shufrat e sipërpërmendura.

Shufrat si mjet pagese janë evidencuar në varrezat e zbuluara në Slloveni, në Gjermani, në Francë dhe në Itali, në varret etrure të shekujve VIII-VII.²⁸⁸

Besimin në përjetësi e shprehin edhe kujdesi ndaj kufomave, si dhe të gjitha procedurat lidhur me të vdekurin. Madje, edhe djegia e trupave të vdekur lidhet edhe me ndarjen e shpirtit nga trupi dhe lehtësimin e udhëtimit të shpirtit në botën tjetër.

Çështjet e prezantuara nxisin mendimin mbi ekzistimin e trajtave të nivelit më të lartë të besimit të organizuar dardan dhe të organizimit në përgjithësi të shoqërisë dardane. Andaj, nuk duket i mjaftueshëm konstatimi i studuesve se xehetaria dhe gjuetia ishin degë mjaft të zhvilluara ekonomike në Dardani.²⁸⁹

Për ekzistimin e trajtave të nivelit të lartë të besimit dardan ka mjaft të dhëna, direkte dhe indirekte, por vlera të veçanta kanë monumentet vijuese:

1. Labirinti rrethor i Smirës (Kosovë)
2. Labirinti i Gamzigradit (Serbi)
3. Observatori parahistorik i Kokinos (IRF e Maqedonisë)
4. Arti parahistorik shkëmbor i Vlashnjës (Kosovë)
5. Hyjnesha në fron (Kosovë)
6. Monumenti mortor i Dardanës (Kosovë)

Vlerat e monumenteve të tilla shtohen nëse gjetjet e deritashme shihen në lidhshmëri me njëri-tjetrin dhe si rezultat i proceseve të cilat u zhvilluan në territorin dardan. Të analizuara veç e veç dhe të para në lidhshmëri me njëri-tjetrin këto mundësojnë edhe studimin dhe njohjen e arke-astronomisë së rajonit dhe të botëkuptimeve dardane mbi ciklin e jetës, përjetësinë dhe përfytyrimin e universit.

²⁸⁸ Dechelette, J. (1927) pp. 287 - 292.

²⁸⁹ Jovanović, A. (1980) pp. 53 - 60.

1. Labirinti rrethor i Smirës

Labirinti rrethor i qarkut të mbyllur i Smirës ende nuk ka analogji, andaj shtron çështjen e kuptimit që e përcjell dhe dilemat e prejardhjes së tij (Monum. 1. Fot. 5).

Labirinti rrethor, bashkë me labirintin katërkëndësh në faqen e kundërt të monumentit, si dhe labirintet e shfaqura në hapësira e kohë të ndryshme, paraqesin përfytyrimin e kozmosit / universit dhe të ciklit të përhershëm të jetës.

Që të dy labirintet e Smirës përcjellin mesazhin e njëjtë, por dallojnë për nga niveli i shprehjes së botëkuptimit. Labirinti rrethor është i një niveli më të lartë filozofiko-religjioz se ka qark të mbyllur dhe nuk ka hyrje të dukshme, ndërsa labirinti katërkëndësh ka hyrje të hapur (Fot. 51).

Labirinti rrethor është pjesë qendrore e një kompozicioni më të gjerë, i cili përfshin edhe hardhinë e rrushit, degët e lerthit dhe nyjën profilaktike. Shtigjet ndërlidhen dhe formojnë gjashtë svastika, tri përmbajnë drejtime lindje-perëndim (jeta dhe dielli) dhe tri të tjera tregojnë drejtimin perëndim-lindje (vdekja – ringjallja dhe hëna).

Labirinti ndahet në disa hapësira të mëdha dhe më të vogla (Fot. 5). Qendrën e zë gjysmësfera e theksuar, e cila është ndarë në tri hapësira të vogla përmes tri gjysmëharqeve. Cepet e skajshme të këtyre gjysmëharqeve krijojnë hyrjen deri te pika qendrore e labirintit, përkatësisht te pika ku takohen skajet e tjera të gjysmëharqeve (Fot. 7). Jashtë dhe mbi rrethin e labirintit është vendosur hardhia e rrushit, e cila ndërlidhet përmes degës së majtë me gjethet e lerthit, që gjenden në fund të fushës kompozicionale. Aty qëndron edhe nyja e theksuar, e cila e bashkon degën e djathë dhe atë të majtën, që lidhet me hardhinë e rrushit (Fot. 50). Nyja ka funksion të përforcimit të mbrojtjes së hyrjes në labirint (nyjë profilaktike, pasi që një qark i mbyllur e kaplon gjithë brendinë e labirintit).

I parë në kontekstin e gjerë, labirinti dardan sjell një qasje gjeometrike dhe numerologjike, e cila krijon fushën holografike shumëdimensionale apo *gjeometrinë e shenjtë*, përmes së cilës reflektohet rregulli i paramenduar kozmik.

Ndërlidhja midis caktit të mbretërisë së vetëdijes më të lartë apo ndritshmërisë dhe botës materiale shprehet përmes hardhisë së rrushit dhe degëve të lerthit, të vendosur në hapësirën e poshtme. Hardhia e rrushit përbëhet nga kalaveshi i rrushit, në anën e djathtë, dhe gjethi i hardhisë në të majtën (Fot. 44).

Çfarë mesazhi përcjell i gjithë kompozicioni i ndërlikuar i labirintit rrethor të Smirës – i labirintit dardan nuk është edhe lehtë të definohet. Është e qartë se përmes tij shprehet kompleksiteti teogonik, filozofik, kozmologjik dhe kozmogonik dardan. Por, çështje për analizë paraqet zberthimi i tij i plotë. Me këtë rast mund të konstatohet se është fjala për një paraqitje dualistike vijuese:

1. Cikli i jetës

(shprehet përmes hardhisë së rrushit, degëve të lerthit, nyjës dhe labirintit rrethor)

2. Universi

(shprehet përmes labirintit rrethor).

Trajtat e labirintit mund të jenë përcaktuese të prejardhjes së tyre. Kështu, nëse kihet parasysh se labirintet trojane dhe etrurë kanë trajtë rrethi, ndërsa ato greke trajtë katërkëndëshi, labirinti rrethor i Smirës del i përafërt me labirintet trojane dhe ato etrurë. Këtu nuk duhet harruar se labirintet më të hershme kanë më shumë, në përgjithësi, trajtë rrethi, si imitime të formës së mitrës (Fot. 68 - 70) dhe si hapësirë e nismës së çdo krijimi. Duket se edhe ky element e dëshmon hershmërinë e konceptit dardan dhe të lidhjeve në territore shumë më të gjera. Me trajtë rrethi është dhe labirinti *Truia* nga

Tragiatella Vase (Itali) e vitit 620 p.e.r. (Fot. 70).²⁹⁰ Vazoja prezanton aktin ritual të respektimit të heroit të rënë nga ana e ushtarëve të rinj, duke bërë që labirinti *Troia* të jetë objekt i komemoracionit funeral dhe hapësirë e iniciacionit apo e sprovave të kalimit të të rinjve në moshë të pjekurisë.²⁹¹

Labirinti dardan, ndonëse për nga trajta iu gjason labirinteve parahistorike dhe atyre trojane dhe etruce, me kompleksitetin që përmban e bën të jetë mjaft i veçantë dhe, njëkohësisht, të jetë shprehje e një niveli mjaft të lartë të zhvillimit të mendimit filozofiko-religjioz.

Mungesa e analogjive për labirintin dardan të Smirës bën që ky të shihet si rezultat i zhvillimeve dhe i arritjeve të vetë dardanëve, përkatësisht të qiellvrotuesëve dardanë, të cilët i vrojtonin lëvizjet e trupave qiellorë dhe të yjeve, i shënonin dhe krijojnë perceptcionin e tyre për kozmosin. Ekzistenca e tyre si udhëheqës shpirtërorë e “shkencëtarë” të kohës, si edhe tek popujt e qytetërimeve të hershme, është çështje që nuk mund të mohohet, por që duhet studiuar më tej.

Meditimet e kohës mbi çështjet transhendentale, sado prezente në simbolet e tjera, manifestohet më së qarti përmes simbolit të labirintit dardan të Smirës. Si labirint me qark të mbyllur dhe jo me hyrje të dukshme, ky del si rezultat i zhvillimeve të shumëkohshme dhe i arritjes së njohurive, që dukshëm i tejkalon simboli i labirintit me hyrje të dukshme. Duke pasur parasysh se në kohët moderne J. Campbell e quajti *realitet transhendent* misterin absolut të jetës,²⁹² i gjithë kompozicioni me labirintin rrethor të Smirës përcjell mesazhe të shumta që reflektojnë nivelin e lartë të njohurive kozmologjike dardane, jo aq lehtë të kuptueshme dhe të zbërthyeshme edhe sot.

²⁹⁰ Jaskolsky, H. (1977) p. 114.

²⁹¹ Wright, C. (2001) p. 11; Doob, P. (1990) p. 29.

²⁹² Campbell, J. (1969) Lectures II.1.1: The Function of Myth, The Esalen Institute.



Foto 68: Labirinti në Pontevedra (Spanjë. Rreth vitit 2000 p.e.r.)



Foto 69: Labirintet nga Valcamonica (Itali. Rreth vitit 750 p.e.r.)



Foto 70: Labirinti Truia: Tragliatella Vase
(Itali. 620 p.e.r.: Jaskolsky 1977)

2. Labirinti i Gamzigradit

Në territorin dardan është zbuluar edhe një labirint tjetër, i cili gjendet në lokalitetin e periudhës romake të Gamzigradit (Felix Romuliana, Serbi. Fot. 71). Është fjala për mozaik të dyshemesë, i cili është vendosur në pallatin e perandorit romak Galerius-it (hapësira D).²⁹³

Labirinti ka trajtë të heksagramit, në skajet e të cilit gjenden gjashtë kulla trajtash të ndryshme, tri prej tyre kanë nga një derë dhe tri të tjera nga dy.

Në pjesët anësore dhe jashtë labirintit gjenden dy imela (mburoja nyjore) dhe dy amfora elegante, nga baza e të cilave dalin degë me gjethe. Degët dhe imela edhe në këtë rast, si tek popujt e tjerë të lashtësisë, paraqiten si ndërlidhje midis botës tokësore dhe asaj të nëndheshme.

Imela duket si bimë e shenjtë në mitologjinë greke dhe besohet se ishte degë e artë e Eneut, paraardhësit të romakëve, me të cilën, siç shkruan Virgjili në veprën *Eneida*, i ka hapur dyert e nëndheshme. Imelën si bimë me fuqi magjike e kanë respektuar edhe druidët, priftërinj keltë, të cilën e kanë prerë me kosë të artë në mënyrë rituale, ndërsa vikingët besonin se mund t'i ringjallte të vdekurit.

Mozaiku paraqet kozmosin dhe ndërlidhet me tetrarkinë tokësore romake, si një pasqyrim i mëtitimit romak për sundimin e botës (orbis terrarum). Vetë Romuliana është paramenduar të ketë plan urbanistik të rregullt dhe konform me drejtimet e qëndrueshme astronomike, lloj i kozmogonisë tetrarkike, siç e ka paramenduar perandori Galerius në vitin 305. Mozaik i ngjashëm është zbuluar dhe në Selanik (tetrarpilon), por ky në qendër ka perandorin.

Labirinti i Gamzigradit ka vlera arkeo-astronomike, ndaj edhe kuptim transhental, pos atij tetrarkik tokësor, dhe mund të jetë rezultat i paraardhësit të tij të Smirës. Edhe ky labirint e përcjell konceptin e treshit: hapësira e brendshme ndahet në tri pjesë dhe i ka

²⁹³ Bogdanović, B. (1976) *Urbs i Logos: ogleđi iz simbologije grada*, Gradina, Niš, pp.47-48; Gamzigrad-Romuliana (5.7.2014): whc.unesco.org/archive/advisory_body_evaluation/1253.pdf.

gjashtë kulla, tri kanë nga një derë dhe tri të tjera nga dy (Fot. 74). Sado që krijohet përshtypja se ekzistojnë tri hyrje të mundshme nga tri kulla, ekziston vetëm një hyrje e cila shpie në qendër të labirintit. Kjo hyrje gjendet te kulla me një derë, e cila është e vetmja që është bërë me tesera me ngjyrë të bardhë (Fot. 74 1).

Në rastin e Gamzigradit shihet se është fjala për një tërësi të planifikuar tematike të strukturave mozaike, të vendosura në struktura të veçanta arkitekturore. Siç ka vërejtur me të drejtë D. Srejoviq, në këtë koncept bëjnë pjesë mozaiku me labirint (hapësira A), mozaiku me skenë nga gjuetia (hapësira D) dhe ai që paraqet Dionisin në banket (hapësira G). Këto hapësira së bashku “flasin” për *kërkimin e rrugës së drejtë dhe për vështirësitë që dalin në këtë rrugë, si dhe për shpërblimin e madh për të tillët që janë këmbëngulës, të mençur dhe të guximshëm*.²⁹⁴

Duke i trajtuar mozaikët e sipërpërmendur si një tërësi tematike, D. Srejoviq i sheh dy amforat e skajeve të kundërta të katrorit me të cilin përfshihet labirinti, si rrugë për ta arritur shpërblimin te kantarosi në duart e Dionisit në panelin mozaikor të hapësirës tjetër.²⁹⁵ Mendoj se ky drejtim ka qenë i kundërt dhe se ky shpinte nga kantarosi në duart e Dionisit dhe hynte përmes amforave jashtë labirintit në vetë labirint. Me këtë dëshmohet se caku ishte qendra e labirintit dhe jo kantarosi. Gjithsesi, analiza e detajuar e këtij mozaiku, si dhe i të tjerëve, ofron mundësi të shumta për të arritur sa më afër botëkuptimeve dardane mbi ciklin e jetës dhe mbi kozmogoninë. Natyrisht, në këtë rrugë jo aq të lehtë duhet të bëhet diferencimi i elementeve vendëse nga ndikimet e jashtme.

Labirinti i Gamzigradit meriton një studim të veçantë, andaj me këtë rast do të theksohet se vetë trajta e tij ka ruajtur gati trajtën rrethore, si dhe parimin e treshit. Si i tillë, ai është dhe refleksion i botëkuptimeve të shprehura në labirintin rrethor të Smirës, një modeli të krijuar më se 100 vjet më parë.

²⁹⁴ Srejović, D. (1983) p. 71.

²⁹⁵ D. Srejović shkruan se janë kanatarosë, por kjo nuk qëndron se kantaros mban Dionisi në mozaikun e hollit tjetër: Srejović, D. (1983) p. 71.



Foto 71: Labirinti i Gamzigradit (Serbi. D. Srejović 1983)



Foto 72: Felix Romuliana (Serbi. unesco.org/en/list/1253)



Foto 73: Imela dhe amfora nga mozaiku i Gamzigradit



Foto 74: Kullat 1-6 në mozaikun e Gamzigradit



Foto 75: Labirinti i Gamzigradit dhe i Smirës

3. Monumenti mortor i Dardanës

Prezencën e kozmogonisë dardane e provon në mënyrë më direkte relievi mortor i Dardanës (Kamenicës), i cili në mënyrë figurative paraqet ritin mortor. Monumenti guror u zbulua bashkë me tri të tjera tek *Ura e Çemerëve* apo *Ura e Kollarëve*, në rrëzat juglindore të kështjellës së antikës së vonë *Kulina*, 1km në juglindje të Dardanës / Kamenicës (Fot. 76).²⁹⁶

Monumenti ka trajtë katërkëndëshi, me pjesë të epërme gjysmëharkore (0.82 x 1.27 x 0.13 m) dhe është punuar në gur, në teknikë relativisht të thellë relievi. I mungon ana e majtë dhe skaji i poshtëm i djathtë, ndërsa pjesa e ruajtur është ndarë në tri pjesë. Përkundër dëmtimeve, monumenti ka ruajtur gati të gjitha elementet kompozicionale dhe monumentalitetin e tij.

Kompozicioni figurativ është vendosur në korniza të theksuara dhe pa zbukurime. Pjesa që vazhdon nën kornizën e poshtme bën të supozohet se kjo pjesë ka qenë e vendosur në dhe, duke e mbajtur relievin në pozitë vertikale.

Në relief janë paraqitur femra që i paraprin funeralit, i ndjeri i vendosur në arkë dhe katër dadoforë, tri valltare mortore, tre gjëmëtarë dhe dy shtazë. Është ky monument i parë figurativ i këtij lloji i zbuluar dhe pa analogji të deritashme në rajon, si dhe labirinti dardan i Smirës. Në të është paraqitur varrimi i komandantit dhe rituali përcjellës. Përmbajtja e monumentit është shprehur me gjuhë figurative përmes trajtimit skematik dydimensional dhe në të nuk ka tekst të shkruar.

I gjithë kompozicioni ndahet në tri horizonte domethënëse. Në Horizontin I, nga e majta në të djathtë, gjendet figura e femrës që i paraprin funeralit, i ndjeri i vendosur në arkë dhe dy valltare. Në Horizontin II gjenden katër dadoforë që mbajnë arkën mbi trarë (Fot. 77), një valltare dhe një gjëmëtar, ndërsa në horizontin III dy shtazë (Fot. 78) dhe dy valltarë (Fot. 76).

²⁹⁶ Monumenti është evidencuar në vitin 1994, siç shihet nga skica e mbetur në Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, pasi që regjimi serb e ka marrë gjithë dokumentacionin (1999). Duke mos ia njohur rëndësinë, monumenti është lënë në harresë. Në vitin 2000 autorja e bëri autopsinë, e inicioi vendosjen e tij në ndërtesën e Kuvendit Komunal në Dardanë dhe, më pas, bartjen në Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës. Sot gjendet në Muzeun e Kosovës.

Mesazhi religjioz-filozofik në aspektin semantik është shprehur përmes pesë tërësive:

1. Femra që prek arkën
2. I ndjeri në arkë dhe katër doriforë
3. Tri valltare mortore
4. Tre gjëmëtarë
5. Dy shtazë

Figura e të ndjerit dhe arka kanë pozitë horizontale, ndërsa figurat e tjera janë vendosur në pozitë vertikale. I ndjeri ka veshur pantallona, si edhe doriforët dhe gjëmëtarët. I ndjeri dhe doriforët mbajnë përkrenare ilire. Prezenca e përkrenares ilire dëshmon se është fjala për varrimin e një luftëtari udhëheqës dhe të një përfaqësuesi të lartë të shoqërisë dardane, të denjë për ngritjen e një monumenti të tillë guror.



Foto 76: Monumenti mortor nga Dardana (Kamenica)



Foto 77: Dadoforët ushtarakë me përkrenare ilire, Dardanë

Përderisa përmes figurave të tjera sheshohet rituali mortor, figura e femrës para arkës prek nivele të tjera. Vendosja e saj në drejtim të kundërt nga të gjitha figurat dhe në drejtim të njëjtë si i ndjeri, paralajmëron rolin e veçantë të saj në ritual (Fot. 79). Pasi që ajo i paraprin ritualit mortor dhe kortezhit funeral, duket se është fjala për një femër me profesion të caktuar (mbase dhe ndonjë nimfë), aq më tepër që ajo prek arkën e të ndjerit, me një elegancë dinjitoze dhe gati hyjnore.

Analizat sjellin në përfundim se figura e femrës prezanton priftëreshën e kultit mortor, nëse jo ndonjë nimfë të caktuar. Pasi që figura nuk dallon nga figurat e valltareve, për nga dimensionet apo me ndonjë element tjetër diferencues, mund të thuhet se është fjala për një priftëreshë, si ndërlidhje me sunduesin apo sunduesen e botës së të vdekurve dhe se përmes prekjes së arkës ndihmon bartjen e shpirtit në botën tjetër. Duke pasur parasysh rolin e Hyjneshës Dardane si hijerofont iniciastik dhe bartëse e shpirtit në sferat e amshueshme, mendoj se figura paraqet njërën nga priftëreshat e saja, ndonjë nimfë, nëse jo vetë atë.

Personazhet e tjera të ritualit mortor janë figurat e femrave që hedhin vallen mortore. Rëndësinë në ritual e shprehin edhe dimensionet e tyre, identike me dimensionet e femrës që prek arkën dhe dy herë më të mëdha se ato të meshkujve gjëmëtarë.

Valltaret mbajnë dorën e majtë te brezi dhe të djathtën te koka (Fot. 80), ndryshe nga ato të meshkujve gjëmëtarë, të cilët i kanë duart e vendosura mbi kokë (Fot. 81).



Foto 78: Figurat e dy shtazëve, Dardanë



Foto 79: Komandanti në arkë dhe femra që e prek arkën, Dardanë



*Foto 80: Tri valltare mortore,
Dardanë*



*Foto 81: Tre gjëmëtarët që
shkulin flokët, Dardanë*

Çështje për të diskutuar është pyetja se çfarë paraqesin femrat, të cilat e hedhin vallen mortore? Këto sugjerojnë se Horizonti I i relievit lidhet më shumë me sferat qiellore apo është në një ndërlidhje me to, andaj dhe figurat e femrave në kompozicion mund të shihen edhe si priftëresha apo, më shumë, si nimfa.

Kompozicioni mban frymë të artit naiv dhe teknika e skalitjes në të është imitim në gur të traditës së drugdhendjes.²⁹⁷ Trajtimi figurativ ka një gjuhë të qartë, por konturat janë relativisht të vrazhda dhe mungon dekorimi.

Trajtësimi figurativ është realizuar gati në trajtë gjeometrike dhe i ngjason frymës së stilit gjeometrik të artit grek të shekujve VII-VI p.e.r.. Analogji e largët për këtë gjendet te vazoja e Dipilonit, e cila është një prej kryeveprave të fazës gjeometrike të artit arkaik grek. Edhe në të, pos të tjerash, i ndjeri është paraqitur në të njëjtën pozitë si në këtë reliev.

Përkundër analogjive të mundshme, ndryshimi me traditën greke shprehet me figurat e meshkujve gjëmëtarë që shkulin flokët në relievin e Dardanës, ndërsa tek grekët e vjetër femrat i shkulin flokët.²⁹⁸ Përderisa janë dhënë mendime se tradita e shkuljes së flokëve në Greqinë antike nis në periudhën arkaike,²⁹⁹ duket se tradita ka rrënjë paleobalkanike dhe ky është ruajtur deri vonë në të gjitha trojet shqiptare. Mihal Apostoli e krahason këtë traditë me ato kretase, pasi që e sheh ceremonialin e vitit 1467 në Shkodër. Misionari Rodin shkruan në vitin 1637 se tradita e shqiptarëve ishte më e fortë se vajtimet për patriarkun Jakob në Hanaan.³⁰⁰

Përmbajtja e tërësishme ikonografike e relievit të Dardanës mban frymë autoktone dhe është shprehje e botës së popullatës indogjene, ashtu si shprehet kjo botë në urnat e japodëve, dhe është punuar me gjuhën e njohur artistike për popullatën vendëse. Pra, monumenti është vepër e një mjeshtri artist vendor, i cili veproi në një fazë transitore të shoqërisë dardane. Është fjala për kalimin nga faza gjeometrike e shprehjes artistike të një shoqërie blegtorale - bujqësore

²⁹⁷ Mbi traditën e hershme ilire të drugdhendjes dhe përcjelljen e teknikës së njëjtë tek ilirët: Rendic-Miočević, D. (1989).

²⁹⁸ Kurtz, D. - Boardman, J. (1971) p. 122.

²⁹⁹ Ferguson, J. (1989) p. 128.

³⁰⁰ Pjetër Budi i kritikon si zakone pagane në *Rituali roman* të vitit 1621. Për të gjitha këto shih: Tirtja, M. (2004) f. 323, ff. 325 - 326.

dardane në fazën e trajtimit antropomorf real të shoqërisë urbane dardane.

Përcaktimi kohor i ngritjes së monumentit është i ndërlikuar, aq më tepër se analogji për të nuk ka. Element i rëndësishëm për këtë dhe për përcaktimin e nivelit artistik dhe mjeshtëror të relievit është mosnjohja e paraqitjes së tridimensionalitetit apo të perspektivës, që është karakteristikë e fazave të hershme të zhvillimit të artit të gjitha qytetërimet e lashta.

Sipas teknikës së krijimit relievi është përcjellje e traditës së drugdhendjes në përpunimin e gurit. Nëse kësaj i shtohet mungesa e njohurive për paraqitjen e perspektivës dhe analogjitë me vallet mortore nga urnat japode, mund të konstatohet se relievi është krijuar gjatë periudhës pararomake. Paraqitja e përkrenareve ilire, prodhimi i të cilave limitohet deri në shek. IV p.e.r., e vendos këtë në shekujt VI - IV apo dhe pak më pas.³⁰¹

Është konstatuar se ritualet religjioze krijuan bazë për zhvillimin e artit skeniko-muzikor dhe vizual. Relikte parahistorike të këtyre ritualeve janë maskat neolitike, ndërsa dëshmi e kohës bëhet vallëzimi mortor, rrjedhimisht vallëzimi hyjnor. Këto janë formë e krijimit të relacioneve të ndërsjella midis tokës dhe qiellit. Kështu, vallja fetare dhe kozmike u bë ritual i identifikimit me krijuesin dhe krijimin. Lëvizjet, që u liheshin në shërbim nxitjeve hyjnore, përbënin gjuhën që vrujonte nga thellësitë e nëndijes, ndërsa me ekstazën e arritur ndjehej prezenca e brendshme e hyjnisë. Prototip i valles kozmike budiste është e ashtuquajtura *tandava Shiva-nataraje*, që aplikohet në rrethin e zjarrtë, ndërsa *Vallja e Uzumës*, që bëhet para shpellës dhe që ndillte daljen e hyjneshës së diellit, Amaterasës, është prototipi i të gjitha valleve të shenjta japoneze. Edhe në Kinën e lashtë zhvilloheshin vallet e vajtimit, të cilat evokonin kthimin e shpirtit të të vdekurit në burimin hyjnor.

Në kulturat antike mesdhetare, duke pasur si bazë simbolizmin kozmologjik dhe iniciastik, ndeshet edhe vallja e lidhur me metalurgjinë, si dhe vallja që luhej pas daljes nga labirinti i Kretës.³⁰²

³⁰¹ Duhet vendosur më herët datimin e mëparmë në shekujt III - II: Shukriu, E. (2004) ff. 84 - 85.

³⁰² Lavedan, P. (1931) Dictionnaire illustre de la Mithologie et des Antiquites grecques et romaines, Librairie Hachette, Paris, pp. 317 - 318; Devambez, P. (1966) Dictionnaire de la Civilisation grecque, Fernand Hazan, Paris, p. 142.

Në këtë kuptim, në hapësira të ndryshme është konstatuar edhe lidhja midis lëvizjeve të valltarëve dhe lëvizjes së yjeve dhe të sferave planetare, sa në antikën greke aq edhe në *Vallen e diellit* tek indianët Sijuks apo te dervishët. Valle rituale realizoi edhe Arianda, e bija e mbretit kretas Minosit, valle kjo që kishte koreografi labirintine.³⁰³

Vallet mortore janë prezente edhe në monumentet ilire, siç janë urnat japode. Këto i gjejmë në monumentin e Karakishicës te Sinji, në relievin e Silvanit me nimfa nga Klisi te Spliti, në monumentin e Gradunit në Cetinë (Tiluriumi antik)³⁰⁴ apo në arën nga Ribiqi pranë Bijaçit.³⁰⁵

Relievi i Dardanës përbën konceptin e treshit, si edhe labirinti rrethor i Smirës dhe mozaiku i Gamzigradit. Simbolika e numrit tre përcillet përmes ndarjes së kompozicionit në tri horizonte, në tri valltare mortore dhe në tre gjëmëtarë.

Bartja e shpirtit përmes prekjes së arkës të të ndjerit, vallja mortore si dhe të gjitha veprimet e tjera përcjellëse dhe simbolet zënë sferat transhendentale dhe përcjellin qasjet kozmogonike dardane.



*Foto 82: Valltarja dhe valltari: Varri Trinclinium, Tarkuini
(Itali. Rr. v. 470 p.e.r.)*

³⁰³ Wright, C. (2001) p. 9.

³⁰⁴ Rendić-Miočević, D. (1989) T. LXXXIV 1; T. LXXXV 1.

³⁰⁵ Stipčević, A. (1981) p. 200.

4. Arti parahistorik shkëmbor i Vlashnjës

Arti parahistorik shkëmbor është zbuluar te *Mrizi i Kobajës*, pranë Vlashnjës (Prizren, Kosovë), në vitin 2005 (Fot. 83 - 88).³⁰⁶ Ky lloj i artit nuk ishte i njohur në Europën juglindore, pos atij në Tren (Shqipëri) dhe në Lipci (Mali i Zi).

Lokaliteti me pikturim parahistorik gjendet në anën e djathtë të Lumëbardhit dhe derdhjes së tij në Drinin e Bardhë. Ky përbëhet nga grupimi i përsëritur skematik i shtatëmbëdhjetë (17) spiraleve të dukshme dhe të një dreri (Fot. 85, 87). Pikturimi është bërë me ngjyrë të kuqe, mbi një sfond të bardhë, jo aq të ruajtur dhe kryesisht të mbuluar me kalcit.

Spiralet si simbole duken shumë herët, andaj dhe paraqitjen e tyre në Vlashnjë duhet parë si vazhdim të traditës së mëhershme. Kështu, vetëm në territorin e Kosovës ato gjenden në enët neolitike të Runikut,³⁰⁷ Bardhoshit,³⁰⁸ Tjerrtores,³⁰⁹ në enën dyshe të neolitit të vonë,³¹⁰ kantarosin eneolitik të Gadimes së Epërme,³¹¹ kapakun nga Glladnica³¹² dhe gjilpërat me dy spirale nga varret e epokës së bronzit të Gllarevës.³¹³

Pikturimet dhe shenjat e njeriut parahistorik, siç janë pikturat e *Mrizit të Kobajës*, janë një gjuhë dhe “shkrim” i parë, që duhet të mësohen dhe të deshifrohen. Kur kihet parasysh se spiralet dhe dreri lidhen me botëkuptimet mbi ciklin e jetës, spiralet e Vlashnjës dëshmojnë zhvillimin e këtyre botëkuptimeve edhe në trojet dardane.

³⁰⁶ Shukriu, E. (2010) ff. 59 - 62.

³⁰⁷ Katalog arkeologjik (2013) f. 25, Fot. 16 (mijëvj. VII-VI).

³⁰⁸ Katalog arkeologjik (2013) f. 57, Fot. 60.

³⁰⁹ Galović, R. (1959) Predionica, Muzej Kosova i Metohije, Priština, T. 66 3, 5, 6; T. 67 1; T. 68 1, 4.

³¹⁰ Katalog arkeologjik (2013) f. 55, Fot. 58.

³¹¹ Katalog arkeologjik (2013) f. 83, Fot. 96.

³¹² Katalog arkeologjik (2013) f. 88, Fot. 106.

³¹³ Djurić, N. (1984) *Bronzanodopski nalaz iz Iglareva*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije XII-XIV, Priština.

Këto spirale janë pikturuar në dy hapësira të tavanit të hijerores (Tavani I, II) dhe në dy horizonte të pikturimit mural (Horizonti I, II. Fot. 85).

Vendosja e simboleve të shumta në hapësira të ndryshme dhe të veçanta përcjell mesazh të rëndësishëm që duhet të kuptohet dhe në këtë drejtim mendoj se spiralet e tavanit të hijerores tregojnë ndërlidhshmërinë me qiellin, ndërsa pikturimi i tyre mural në dy horizonte lidhet me botën e nëndheshme, të cilën e sforcon prezenca e drerit në krye të Horizontit I të pikturimit mural (Fot. 85, 87).

Grupimi i caktuar i spiraleve me kahe të ndryshme del mjaft i paramenduar, sidomos në ato të tavanit të hijerores dhe mund të supozohet se këto ofrojnë edhe kalendarin e kohës.

Hapësira e Mrizit të Kobajës dhe rreth saj, bashkë me hijeroren, kanionin e Drinit dhe Lumbardhin kanë qenë edhe hapësirë iniciacioni, i cili mundësonte kalimin i të rinjve në moshën e pjekurisë dhe pranimin e tyre si anëtarë të plotë të bashkësisë. Ky lloj i ‘labirintit’ jetësor niste në shoqëritë fisnore me ndarjen e djemve nga familja dhe ballafaqimin e tyre me sprovat e natyrës, madje edhe me vdekjen. Sprovat e iniciacionit zhvilloheshin nën përkujdesjen e “mësuesit” dhe si një sprovë e tillë shihet dhe ajo e Tezeut, me hyrjen e tij në labirintin e Minotaurit të Kretës.³¹⁴

I parë në aspektin e përgjithshëm, arti parahistorik shkëmbor i Vlashnjës bën pjesë në mesin e dëshmimeve për zhvillimin e botëkuptimeve mbi ciklin e jetës dhe të ndarjes së sferave jetësore, përkatësisht të botës tokësore, të botës së nëndheshme dhe të asaj qiellore.

³¹⁴ Jaskolsky H. (1997) p. 58.



Foto 83: Hijerorja dhe derdhja e Lumëbardhit në Drinin e Bardhë



Foto 84: Mrizi i Kobajës dhe hijerorja, Vlashnjë

Pikturimi shkëmbor
Vlashnjë, 2005






Foto 85: Arti parahistorik shkëmbor, Vlashnjë



Foto 86: Spiralja dyshe në tavan, Vlashnjë



Foto 87: Imazhi i dredit (Horizonti I), Vlashnjë




Foto 88: Lokalitetet arkeologjike rreth Vlashnjës

5. Hyjnesha në fron

Hyjnesha në fron është idhull terrakote, i zbuluar në lokalitetin *Tjerrtorja* në Prishtinë (Kosovë). Ka gjatësi prej 18,5 cm dhe i takon epokës së eneolitit (kultura e Vinçës).

Deri më sot nuk është bërë ndonjë studim i veçantë për *Hyjneshën në fron* dhe as për analizën më të hollësishme të të gjithë idhujve të zbuluar në Kosovë, së paku për t'i kuptuar mesazhet që i përcjellin. Kjo mungesë ka bërë që të mos dalë sheshit labirinti i gërricur në barkun e *Hyjneshës në fron* (Fot. 89). Kjo është pasojë e trajtimeve sipërfaqësore, madje edhe për faktin se “hyjnesha” nuk ka gjinj të dukshëm, ashtu siç i kanë shumë figura të tjera, përfshirë dhe idhullin e njohur *Lady of Vinca* nga lokaliteti i Vinçës (Serbi. Fot. 90). Gjithsesi, këta idhuj janë ende shprehje e figurës së Magna Mater, të quajtur matriarkat të epokës së neolitit dhe të dualizmit gjinor, i cili lindi nga epoka e eneolitit të hershëm, para dyndjeve indo-europiane.

Po aq vëmendje meriton qaforja e hyjneshës, e cila e ka si varëse një medaljon të rrumbullakët, dhe me të drejtë interpretohet si simbol solar. Ky lloj i qafores gjendet në barelievin që paraqet hyjninë Baal të Lindjes së Afërme.³¹⁵ Duke mos u larguar nga territori i Kosovës, duhet theksuar se i njëjti medaljon gjendet edhe tek idhujt e ulur të Barilevës,³¹⁶ Fafosit të Mitrovicës,³¹⁷ Bardhoshit³¹⁸ apo medaljoni me lokalitet të panjohur dhe i kthyer nga Gjermania,³¹⁹ si dhe medaljonet e Vinçës. Figurinat e tilla sjellin në përfundim se qaforet me simbol solar duken vetëm te hyjnitë e ulura, të tillat që kishin pozitë dominante mbi hyjnitë e tjera (Fot. 89 - 91). Me këtë rast duhet përkujtuar se shumë kohë më pas e njëjta qafore me simbol solar gjendet në monumentet e Hyjneshës Dardane, të Banjës së Kllokotitit dhe të Therandës / Suharekës (Fot. 32).

Paraqitja identike e qafores me medaljon solar sugjeron mendimin se nuk është fjala për rastësi, por për një vijimësi identifikimi ndër mijëvjeçarë. Duke e rivendosur këtë lidhje, mendoj se medaljoni solar është një element qendror dhe i pandryshueshëm ikonografik, i

³¹⁵ Encyclopedie de la mythology (2004) Direct. Arthur Cotterell, Parragon, Paris, p. 37.

³¹⁶ Katalog arkeologjik (2013) f. 41, Fot. 38 (a).

³¹⁷ Katalog arkeologjik (2013) f. 41, Fot. 38 (b); 45, Fot. 44a, 44d

³¹⁸ Katalog arkeologjik (2013) f. 47, Fot. 46 (b).

³¹⁹ Katalog arkeologjik (2013) f. 40, Fot. 38.

rëndësishëm për studime më të detajzuara. Për këtë nuk duhet të jetë pengesë fakti se struktura ikonografike e idhujve parahistorikë ndryshon nga ikonografia e Hyjneshës Dardane të shekujve II - III. Është e kuptueshme se medaljonin solar duhet parë dhe si simbol identifikues të kultit, i cili shpreh fuqinë kozmogonike të diellit.

Dukja e *Hyjneshës në fron* paraqet dilemën se mos ndoshta është fjala për një hyj mashkull? Labirinti i gërricur në barkun paksa të fryrë e mënjanon këtë dilemë dhe, njëkohësisht, shtron çështjen e paraqitjes së dualizmit gjinor, si një fazë më e avancuar dhe që shfaqet me nismën e veprimtarive xehetare. Ky labirint po ashtu simbolizon mitrën, si qendër e krijimit të jetës, gjithnjë në ndërlidhje me diellin e plotfuqishëm, që duket si simbol në qafore.




Foto 89: *Hyjneshë në fron, Tjerrtorë (Kosovë)*



Foto 90: *Laydy of Vinca, Vinçë (Serbi)*



Foto 91: *Idhull nga Vinça (Serbi)*

ÇËSHITJE PËR HULUMTIM TË MËTEJTMË

Çështje për hulumentim të mëtejtmë paraqet labirinti rrethor i Smirës (labirinti dardan) dhe zbërthimi më i detajuar i çdo elementi, i cili paraqitet në të. Andaj publikimi i tanishëm duhet parë vetëm si nismë për zbërthimin e enigmave që e lanë trashëgimi dardanët. Në këtë kuadër vend të veçantë duhet të zënë botëkuptimet dardane për ciklin e jetës dhe universin, bazë e të cilave ishin vrojtimet e natyrës, si edhe te popujt e tjerë parahistorikë dhe antikë.

Shikuar në këtë prizëm, vëmendje të veçantë tërheq simboli më qendror i labirintit rrethor, që është hemisfera apo sfera e ndarë në tresh (Fot. 7). Lidhur me këtë shtrohen pyetjet: Pse janë shtigjet aq të ndërlikuara për të arritur deri në qendër? Pse gjysmësfera e zë vendin qendror? Pse gjysmësfera i ka tri harqe dhe, mbi të gjitha, pse hapësira është e ndarë në tri pjesë? Ku u gjet inspirimi për paraqitjen e hemisferës apo, më saktë, çfarë gjendej në natyrë që u bë bazë për t'u marrë si model?

Një përgjigje për modelin e natyrës, që gjithherë ka dhënë baza për krijimin e simboleve, mendoj se qëndron te zemra, përkatësisht në faktin se valvula trikuspe e zemrës³²⁰ merr trajtë identike me gjysmësferën e paraqitur në labirint (Fot. 92). Mbase roli i rëndësishëm i kësaj valvule për rrjedhën e gjakut, pa të cilin nuk ka jetë, ka bërë që kjo trajtë të shihet si mbajtëse dhe vazhdimësi e jetës.

Është me shumë interes të theksohet se motivi identik i gjysmësferës, i cili është ndarë në tresh dhe gjendet në pjesën qendrore të labirintit rrethor të Smirës (Monum. 1. Fot. 92), gjendet në monumentet mbivarrore dardane (stela. Fot. 93).

Simboli është vendosur vetëm në katër skajet anësore të pjesës së poshtme e të lartë të ornamentimit rreth fushës mbishkrimore. Kështu, në monumentin e Pejës është i vendosur mbi dy spirale drejtimesh të kundërta, të cilat dalin drejtpërdrejt nga amfora në fund të monumentit, përkatësisht nga toka. Ky simbol, i rrethuar nga degët e hardhisë së rrushit apo të lerthit, e përforcon lidhjen midis botës së të vdekurve dhe botës qiellore apo hyjnore.³²¹

³²⁰ Mbi valvulën trikuspe të aortës së zemrës: Bellhouse, B. (1970) p. 996; Bellhouse, B. (1970) 996; Bellhouse, B. – Bellhouse, H. (1968) pp. 86 - 87; Shaqiri, G. (1994) f. 237, Fig. b.

³²¹ Ky simbol nuk është shënuar nga asnjë studiues deri më sot, andaj bëhet i domosdoshëm studimi i detajuar i të gjitha monumenteve mbivarrore, të njohura si *stela dardane*.

1. Koncepti i treshit

Vrojtimi i dukurive në natyrë ka ndikuar, pa dyshim, në krijimin e konceptit të treshit edhe te dardanët. Një botëkuptim i tillë, duke mos lënë anash as ndikimet nga jashtë, është ndërtuar me shekuj. Proven mbi konceptin e zhvilluar të treshit e sjellin mjaft monumente, që përkojnë me kulturën dardane dhe në mesin e të tillave janë:

1. Monumenti mortor i Dardanës, me tri horizonte kompozicionale, tri valltare, tre gjëmëtarë (Fot. 76),
2. Labirinti rrethor i Smirës, me kompozicionin e ndarë në tri horizonte, me nga tri svastika drejtimesh të kundërta dhe me tri hapësira të sferës qendrore (Fot. 3),
3. Labirinti i Gamzigradit, me hapësirë të brendshme të ndarë në tri pjesë dhe me gjashtë kulla (2 x 3. Fot. 71) dhe
4. Dorëza e patelës nga Branetiçi i Poshtëm, me tri zona (1. hyjnesha, 2. shtaza, 3. sëpata dhe altari (Fot. 17).

Sipas të dhënave të parashtruara dhe në kuadër të përfytyrimit kozmik të dardanëve, duket qartë se mbisundon koncepti kozmologjik i treshit, që përbëhet nga *soma*, *psyhe* dhe *nous*. Këto janë mbështetur në tri sferat astrale: diellin, hënën dhe tokën. Në kontekstin filozofik-religjioz dardan mendoj se tokën duhet parë si vendbanim i trupit të vdekshëm, mbase hënën si vendbanim të shpirtit të përjetshëm dhe diellin si synim dhe qendër, vendbanim të urtisë sublimë dhe iluminacion.

